Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron, dhe promovon të drejtat dhe interesat grave dhe të vajzave

Raport për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Botimi i dytë

Prishtinë, Kosovë
2009

Raport për monitorimin e zbatimit
të Rezolutës 1325
të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Botimi i dytë

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë
2009

Raport për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

©2009 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë

In Memoriam
Lynne Alice
(1951 – 2009)

MIRËNJOHJET 1
SHKURTESAT 2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
II. PREZANTIM I ZBATIMIT TË REZOLUTËS 1325 NË KOSOVË 8
1. Institucionet dhe Organizatat Ndërkombëtare 10
1.1 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar *12*
1.2 Prania Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR-i) *13*
1.3 EULEX Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit *15*
1.4 Zyra e Përfaqësuesit Special e Bashkimit Evropian *17*
1.5 Komponenti Policor në Kosovë i Misionit EULEX *17*
1.6 Zyra për Çështje Gjinore (ZÇGJ) e UNMIK-ut *19*
1.7 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) *19*
1.8 Programi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) *21*
1.9 Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM) *21*
1.10 Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA) *23*
1.11 Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) *24*
1.12 Zyra e Komisarit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) *24*
2. Institucionet dhe Mekanizmat Vendore Përgjegjëse për Fuqizimin dhe Promovimin e të Drejtave të Grave 26
2.1 Kuvendi i Republikës së Kosovës *26*
2.2 Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës *27*
2.3 Qeveria e Republikës së Kosovës *27*
2.4 Komunat *28*
2.5 Agjencia për Barazi Gjinore *29*
2.6 Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (Zyra për Qeverisje të Mirë-ZQM) *30*
2.7 Këshilli Ndërministror për Barazi Gjinore *30*
2.8 Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) *31*
2.9 Policia e Kosovës *32*
2.10 Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës *33*
2.11 Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) *33*
2.12 Dogana e Kosovës *34*
2.13 Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) *34*
2.14 Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) *35*
2.15 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) *36*

2.16 Njësitë për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ) 36
2.17 Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJDNJK) 37
2.18 Avokati i Popullit - Institucioni i Ombudspersonit 38
2.19 Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut 39
2.20 Ndihma Juridike Falas 40
3. Ligjet dhe Politikat me Qëllim të Fuqizimit dhe Promovimit të të Drejtave të Grave 43
3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës 43
3.2 Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) 44
3.3 Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) 45
3.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM) 46
3.5 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) (2008-2013) 47
3.6 Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (2009-2011) 48
4. Shoqëria Civile në Kosovë 50
4.1 Të arriturat e diskutuara në tryezën e rrumbullakët (korrik 2007): 55
4.2 Rekomandimet nga tryeza e rrumbullakët (korrik 2007) 56
III. OBLIGIMET E REZOLUTËS 1325 57
1. Përfshirja e Perspektivës Gjinore në të Gjitha Nivelet e Vendimmarrjes 57
2. Perspektiva Gjinore në Trajnime të Personelit Policor dhe Ushtarak: Rendi dhe Ligji 66
3. Mbrojtja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave 67
3.1 Prona private 69
3.2 Privatizimi 70
3.3 Dhuna në familje 71
3.4 Arsimimi 76
3.5 Trafikimi dhe dhuna në baza gjinore 78
3.6 Të drejtat e pakicave 82
4. Përfshirja e Perspektivës Gjinore në Raportimet e KB-së 85
5. Përmbledhje 87
REKOMANDIME 88
SHTOJCA 1. REZOLUTA 1244 89
SHTOJCA 2. UNSCR1325 96
SHTOJCA 3. INICIATIVAT DREJT ZBATIMIT TË REZOLUTËS 1325 NË KOSOVË 100
SHTOJCA 3. PROJEKTPLANI I PUNËS PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE PËR REZOLUTËN 1325 104

MIRËNJOHJET

Raporti për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë u mundësua falë financimit nga UNDEF dhe UNIFEM dhe kohës që na u kushtua pa kompensim nga shumë individë të cilët u pajtuan që të intervistohen gjatë viteve 2006, 2007 dhe në fillim të vitit 2009.

Ekipi përgjegjës hulumtues i RRGGK-së që hulumtoi dhe intervistoi respondentët përbëhej nga Dafina Beqiri (e cila udhëhoqi edhe intervistat e bëra për raportin e përditësuar), Ali Misimi, Albana Lumi dhe Elizabeth Carolan. Sa i përket kodifikimit të intervistave ndihmesë profesionale ka dhënë Nicole Farnsworth.

Raporti fillestar u përpilua nga Lynne Alice, konsulente ndërkombëtare e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, që ka ligjëruar të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare në Universitetin *Deakin (Deakin University)* në Australi.

Besim M. Kajtazi - ekspert ligjor, përpiloi këtë Raport për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 në Kosovë.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
GND	Grupi Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën
ICRC	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KFOR	Prania Ushtarake në Kosovë
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LKD	Ligji Kundër Diskriminimit
LRG	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi Kalimtare në Evropën Juglindore
NATO	Traktati Veriatlantik
NJDNJ	Njësitë për të Drejtat e Njeriut
NJDNJK	Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Komuna
NMNV	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave
OJQ	Organizatë Joqeveritare
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut
OHCHR	Zyra e Komisarit të Lartë për Drejta të Njeriut
OSBE	(OSCE) Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OMIK	Misioni i OSBE-së në Kosovë
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PUN	Prania Ushtarake Ndërkombëtare
PSSP	(SRSG) Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
PK	Policia e Kosovës
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
QKSGJ	(KGSC) Qendra Kosovare për Studime Gjinore
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
REZOLUTA 1325	(UNSCR1325) Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNDAF	Korniza për Asistencë Zhvillimore e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNESCO	Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisionari i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
ZÇGJ	Zyra për Çështje Gjinore e UNMIK-ut

ZKBGj	Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore
WHO	(OBSH) Organizata Botërore për Shëndetësi

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Kosovë, shoqëria civile ka shfrytëzuar mundësitë që ofrohen nga Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Rezoluta 1325) si mjet avokimi për të inkurajuar, promovuar dhe lobuar për pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e jetës publike. Kësisoj, organizatat e grave kosovare kanë kontribuar drejtpërdrejtë edhe në zbatimin e Rezolutës 1325.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka zbatuar projektin e monitorimit të zbatimit të Rezolutës 1325 në Kosovë. Raporti monitorues është rezultat i një pune të vazhdueshme që nga viti 2005 dhe ofron një vlerësim sa i përket shkallës së zbatimit të Rezolutës 1325 në Kosovë, duke pasur për qëllim që të sigurohet avokim i vazhdueshëm dhe i suksesshëm në nivel të Kosovës sa i përket çështjeve gjinore. Kjo punë është përkrahur nga UNIFEM (Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë) dhe UNDEF (Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Demokraci).

Ky raport përcjell strukturën e njëjtë me raportin e vitit 2007 dhe analizon zbulimet kyçe në fushat të cilat Rezoluta 1325 i definon si fusha obliguese:

1. Përfshirjen e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes;
2. Përfshirjen e perspektivës gjinore dhe trajnimeve gjegjëse për ndërgjegjësimin e personelit në sektorin e sigurisë;
3. Mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave; dhe
4. Përfshirjen e perspektivës gjinore në raportet e OKB-së.

Në Kosovë, trashëgimia e turbulencës politike e viteve të nëntëdhjeta dhe periudhës së pas luftës vazhdon të mospërfill pjesëmarrjen e grave në jetën publike, veçanërisht në politikë dhe ekonomi.

Deklarimi i Pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 9 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, sollën realitet të ri në Kosovë.

Gratë në Kosovë mbajnë 29% të ulëseve në parlament, dhe 22% deri në 28% në Kuvendet Komunale (falë kuotës së përcaktuar prej 30%), dhe 34.02% të të punësuarve në institucionet e Shërbimit Civil të Kosovës, megjithatë pozitat vendimmarrëse janë të dominuara nga burrat.

Disa politikanë kosovarë janë bërë gjithnjë e më aktivë në përkrahjen publike të organizatave të grave dhe duket se e pranojnë rëndësinë e themelimit të legjislacionit të të drejtave gjinore.

Aktivistet vendore kanë luajtur një rol të madh në ndihmën e ofruar për politikanët për t'u bërë më të vetëdijshëm për barazinë gjinore dhe në avokimin e suksesshëm për legjislacion që përkrah barazinë gjinore si e drejtë e njeriut.

Republika e Kosovës është duke ndërtuar një infrastrukturë të re ligjore e cila synon të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe evropiane mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Në Kosovë, barazia gjinore nuk është diçka e sajuar nga dëshira, por e sanksionuar në një varg aktesh të ndryshme ligjore. Në këtë drejtim, në Republikën e Kosovës janë nxjerrë një varg ligjesh dhe politika të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së femrave dhe meshkujve në shoqëri dhe mënjanimit të pabarazisë gjinore ekzistuese, por, "legjislacioni, nuk duhet në këtë drejtim të ofrojë thjeshtë të drejta të barabarta (në kuptim ligjor të konceptit) por

garanci për të mos cenuar të drejtat themelore". Megjithatë, për tu arritur mbrojtja efektive e të drejtave njerëzore të grave kërkohet edhe zbatimi i duhur i legjislacionit në fuqi si dhe i zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore janë krijuar në të gjitha nivelet e qeverisjes, por artikulimi në politika dhe rregulla administrative mbetet i ngadalshëm për shkak të përkufizimeve financiare dhe mungesës së vullnetit të zyrtarëve në nivelet më të larta të vendimmarrjes.

Sa u përket mekanizmave për barazi gjinore, Kosova radhitet në vendin e parë në rajon, mirëpo ekziston një zbrazëti e madhe në zbatimin e këtyre ligjeve dhe në funksionalizimin e mekanizmave për barazi gjinore. Këta mekanizma kanë mungesë të resurseve financiare dhe njerëzore. Nuk mjafton të miratohen ligjet dhe të themelohen mekanizmat. E gjithë kjo aparaturë ka nevojë të funksionojë, të njihet dhe të përkrahet.

Pas luftës, të drejtat e grave u riformuluan me konceptet demokratike dhe parimet e të drejtave të njeriut, respektimi i plotë i tyre kufizohet jo vetëm nga mentaliteti patriarkal, por edhe nga vështirësitë në zbatimin e ligjeve. Por, megjithë ekzistencën e një kuadri të mirë ligjorë, vështirësitë në zbatimin e ligjeve, mungesat në strukturat zbatuese dhe fondet e pamjaftueshme, po vonojnë arritjen e synimeve për barazi gjinore.

Përderisa mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore ekzistojnë në nivel legjislativ, shumë meshkuj dhe femra në Kosovë nuk janë në dijeni për të drejtat e tyre dhe mënyrën për t'iu qasur mbrojtjeve të ofruara nga ato ligje. Shumica e meshkujve dhe femrave në Kosovë mbesin të painformuara për të drejtat e tyre. Në këtë mënyrë, zbatimi gjithëpërfshirës i parimeve ligjore mbetet të realizohet në tërësi.

Shumë familje në Kosovë jetojnë në kushte shumë të vështira. Papunësia është zvogëluar që nga viti 2002, por në vitin 2005 akoma raportohej se 33 për qind meshkuj dhe 60 për qind femra të fuqisë punëtore ishin të papunë.

Në Kosovën e pasluftës, dhuna dhe ngacmimi seksual ndaj femrave është rritur duke pasqyruar ndikimet e situatës së rëndë ekonomike dhe traumës së pasluftës. Anëtaret e RrGGK-së janë aktive në fushatat publike për ngritjen e vetëdijes mbi dhunën ndaj gruas dhe në informimin e grave për të drejtat e tyre. Fushata e vitit 2005 përfshinte tregime personale në shfaqjet teatrale dhe adresoi një varg shembujsh të dhunës në baza gjinore, përfshirë atë të kryer edhe nga ndërkombëtarët. Përderisa krimet e dhunshme kanë pësuar zbritje të vazhdueshme që nga themelimi i CIVPOL/ShPK, dhuna në familje vazhdon të jetë në shkallë brengosëse. Ndonëse viktimat janë duke raportuar më shumë raste para sistemit të drejtësisë dhe se kanë treguar zhvillime pozitive në ligj dhe polici, gjykatat e Kosovës janë duke dështuar në zbatimin adekuat të Rregullores kundër dhunës në familje.

Në Kosovë, gratë përbëjnë audiencën më të madhe televizive. Nevoja për një fokus gjinor në programet televizive për të arsimuar dhe ndikuar në qëndrimet stereotipe gjinore të shoqërisë dhe për të siguruar pasqyrë pozitive gjinore dhe prezantim të barabartë të meshkujve dhe femrave në media është e madhe. Iniciativa për të prodhuar një film dokumentar që avokon dhe shpjegon Rezolutën 1325 nga RTV21 kishte synim arsimues, jo për të edukuar vetëm aktivistet femra por gratë në të gjitha pjesët e shoqërisë, si dhe për të debatuar për mënyrën se si duhet edukuar komunitetin, dhe se çka mund të arrijmë me Rezolutën 1325.

Në sektorin e sigurisë vërehen ndryshime të ngadalshme por pozitive për sa i përket përfshirjes së çështjeve gjinore, përkundër insistimit në stereotipizimin e çështjeve gjinore dhe mosbesimit në baraspeshën gjinore.

Në përgjithësi, monitorimi ka zbuluar se institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile në Kosovë përshkohen me shkallë të ndryshme të përkrahjes dhe promovimit të Rezolutës 1325. Rrjedhimisht, zbatimi i Rezolutës 1325 varet nga udhëheqësit individualë.

Përfshirja e grave në vendimmarrje

Përfshirja e grave në jetën publike është dukshëm nën nivel, posaçërisht në politikë dhe ekonomi. Gratë janë më të prekura nga papunësia, varfëria dhe mungesa e qasjes në arsim. Sa i përket politikës, gratë mbajnë 29% të ulëseve në parlament, dy kryetare të komisioneve parlamentare nga 13 komisione gjithsejtë, ndërsa pjesëmarrja e femrës në Kuvende Komunale sillet nga 22% deri në 28%. Fakti që përqindja e grave në kuvendet komunale (22% deri 28%) dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës (29%) është ndër më të lartat në rajon, e edhe më e lartë se në shumë vende euro-perëndimore, nuk do të thotë që gratë kosovare mbajnë postet kyçe në udhëheqje. Në Qeverinë e tanishme (2008) gratë mbajnë dy poste të ministres nga 17 ministri gjithsej dhe tri poste të zëvendës ministreve. Në institucionet e Shërbimit Civil të Kosovës (gjendja shtator 2008), 34.02% të të punësuarve janë gra (24.748) që në krahasim me gjendjen e vitit 2007 ku ishin 33.22% të të punësuarve (24.341), është një ngritje e vogël. Megjithatë, në strukturat politike qeveritare, shoqëri civile dhe institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, shumica e pozitave vendimmarrëse mbahen nga burrat.

Mungesa e konsultimit me gratë gjatë negociatave për “statusin final” dhe mos nominimi i asnjë gruaje si e ngarkuar me punë në ambasadat e Republikës së Kosovës, paraqet një shembull emblematik të dështimit sa i përket sigurimit të qasjes së grave dhe prezencës së tyre në nivelet më të larta të vendimmarrjes.

Shumë prej përfaqësuesve qeveritarë kanë njohuri themelore mbi Rezolutën 1325, po ashtu mekanizmat gjegjës si dhe korniza legjislative për arritjen e barazisë gjinore janë vendosur në të gjitha nivelet, megjithatë artikulimi i tyre në politika dhe rregullativë administrative mbetet i ngadalshëm për shkak të përkufizimeve financiare, dialogut të limituar ndërqeveritar dhe mungesës së vullnetit politik.

Perspektiva gjinore në sektorin e sigurisë

Gratë janë të përfaqësuara në numër të vogël si punonjëse të institucioneve të ndryshme të sigurisë në Kosovë. Megjithatë, nga disa prej këtyre institucioneve janë ndërmarrë hapa drejt ofrimit të trajnimit mbi çështjet gjinore. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), tani Policia e Kosovës (PK) në mënyrë efektive e ka integruar Rezolutën 1325 gjatë përmbushjes së rolit dhe obligimeve të veta si në nivel administrativ ashtu edhe në atë operativ. Pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) janë trajnuar sa i përket çështjeve gjinore, duke shpresuar që edhe pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) (që janë në formim e sipër) do t’u ofrohen trajnime mbi çështjet gjinore ndërsa Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), dhe Doganat e Kosovës (DK) duhet të jenë trajnuar në vazhdimësi sa i përket çështjeve gjinore, si dhe të përfshijnë Rezolutën 1325 gjatë trajnimeve të stafit të tyre.

Në sektorin e sigurisë vërehen ndryshime të ngadalshme por pozitive për sa i përket përfshirjes së çështjeve gjinore, përkundër insistimit në stereotipizimin e çështjeve gjinore dhe mosbesimit në baraspeshën gjinore.

Të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave
Miratimi i kornizës relevante legjislative, që përfshin: Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin Kundër Diskriminimit, Ligjin për Familjen, Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2008-2013) dhe Strategjinë për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2009-2011), paraqet një rezultat të theksuar në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në mënyrë më gjithëpërfshirëse në Kosovë. Megjithatë, për t'u arritur mbrojtja efektive e të drejtave njerëzore të grave kërkohet edhe zbatimi i duhur i legjislacionit ne fuqi si dhe i zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Në fakt, dhuna dhe ngacmimet seksuale ndaj grave kanë shënuar rritje, fakt ky që reflekton situatën e vështirë ekonomike dhe traumat e pasluftës. Dhuna në familje vazhdon të paraqitet me shifra alarmante. Gjithashtu, Kosova është vend destinimi për shumë gra dhe vajza të trafikuara që janë detyruar të ushtrojnë prostitucion. Në përgjithësi, masat vazhdojnë të jenë joadekuate, për shkak të mungesës së politikave adekuate si nga vendorët ashtu edhe nga ndërkombëtarët.

Gratë në Kosovë janë të margjinalizuara në shumë aspekte, mirëpo një e mirë është që pas vitit 1999, diskutohet hapur për këto çështje dhe aktivitetet për përmirësimin e pozitës së gruas kanë filluar të japin rezultate.

Perspektiva gjinore në raportimin në OKB
Shumë të intervistuar ndërkombëtarë që punojnë në Kosovë zbuluan se kanë vetëm dijeni sipërfaqësore lidhur me Rezolutën 1325 dhe përfshirjen e çështjeve gjinore në organizata ndërkombëtare. Keqkuptimi më i shpeshtë është barazimi i "çështjeve gjinore" për gratë dhe jo me vlerësimin e ndryshëm për gratë dhe burrat në shoqëri.

Pas shpalljes së Rezolutës 1325, Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë -UNMIK-u themeloi Zyrën për Çështje Gjinore (ZÇGJ), por mungesa e angazhimit solid me shoqërinë civile dhe mungesa e komunikimit me institucionet, shpesh shpinin deri tek dyfishimi i punëve në projekte që kanë të bëjnë me çështjet gjinore.

Përfshirja e çështjeve gjinore në mekanizmat institucionalë dhe artikulimi i Rezolutës 1325 në përgjithësi has në vështirësi për shkak të mungesës së përkushtimit praktik dhe pengesës deri në një masë të caktuar nga qëndrimet negative të punonjësve ndërkombëtarë në Kosovë. Në praktikë, prioritetet tjera politike gllabërojnë fokusin nga çështjet gjinore, kështu që ato shpesh margjinalizohen. Kësisoj në Kosovë është i domosdoshëm edukimi lidhur me Rezolutën 1325 dhe lidhur me relevancën e saj për proceset paqeruajtëse në Kosovë.

Në përgjithësi, monitorimi ka zbuluar se institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile në Kosovë përshkohen me shkallë të ndryshme të përkrahjes dhe promovimit të Rezolutës 1325. Niveli i angazhimit të tyre në fushat e mbuluara nga Rezoluta 1325 dhe traktatet gjegjëse të të drejtave të njeriut gjithashtu dallon dukshëm. Përderisa në parim UNMIK u përmbahej parimeve të përfshirjes gjinore në operacionet e veta, punët dhe partneritetet e politikat, performansa dhe ndikimi që ushtron sa i përket promovimit të përfshirjes së çështjeve gjinore si element kyç të ndërtimit të paqes në nivel lokal janë tejet jokonsistente. Mbetet sfida e Pranisë Civile Ndërkombëtare në Kosovë që t'u përmbahet parimeve të përfshirjes gjinore dhe të përkrahë dhe promovon Rezolutën 1325.

II. PREZANTIM I ZBATIMIT TË REZOLUTËS 1325 NË KOSOVË

"Ne nuk guxojmë të minimizojmë apo injorojmë më tej kontributet e grave dhe vajzave në të gjitha etapat e zgjidhjes së konflikteve, si dhe në proceset e krijimit të paqes, ndërtimit të paqes, paqeruajtës dhe rindërtimit. Paqja e qëndrueshme nuk do të arrihet pa pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave"

– Kofi Annan, ish Sekretar i Përgjithshëm

Rezoluta 1325 thekson rëndësinë e përfshirjes së perspektivave gjinore në operacionet paqeruajtëse dhe të ndërtimit të paqes. Sipas Rezolutës 1325 Sekretari i Përgjithshëm (SP) i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) është i obliguar t'i ofrojë shteteve anëtare udhëzime dhe materiale për trajnim mbi mbrojtjen, të drejtat dhe në veçanti nevojat e grave në paqeruajtje dhe ndërtim të paqes. Më tej, SP duhet të sigurojë që personeli ushtarak dhe civil që do të dërgohet në këto misione të jetë i trajnuar mbi këto çështje nga vetë shtetet anëtare.

Rezoluta 1325 paraqet njohje dhe garanci efektive për angazhimet institucionale praktike për përfshirjen e grave në të gjitha aspektet dhe nivelet e paqeruajtës dhe rindërtimit. Të kuptuarit e ndikimit specifik të konfliktit ushtarak dhe agresionit në gratë dhe vajzat do të kontribuojë gjatë vlerësimit të vetë konfliktit; do të ofrojnë një qasje më të detajuar dhe të saktë drejt zgjidhjes së konfliktit si dhe do të ndihmojë në rindërtimin e drejtë të shoqërisë së thyer për shkak të urrejtjeve të manipuluara politikisht. Arsyeja është që cenueshmëria e posaçme e grave gjatë konflikteve thellohet dhe më tej dhe stimulohet skajshmërisht në momente të paligjshmërisë, prezencës së armëve, dhe dezintegrimit ekonomik dhe social, por gjithashtu për shkak të pabarazisë materiale të vetë popullatës përfshirë edhe pabarazinë në aspekt gjinor. Për këtë arsye, paraqitet nevoja urgjente për ofrimin e trajnimit të specializuar për të gjithë pjesëmarrësit në paqeruajtje sa i përket mbrojtjes, nevojave speciale dhe të drejtave njerëzore të grave dhe fëmijëve në situata të konfliktit, si dhe për t'u siguruar se janë krijuar dhe janë të qëndrueshëm mekanizmat përkatës për këtë.

Përfshirja e çështjeve gjinore, një koncept themelor në Rezolutën 1325, definohet si "strategji për t'i bërë brengat dhe përvojat e grave dhe burrave dimension integral në dizajnimin, zbatimin, monitorimin dhe evoluimin e politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, ashtu që gratë dhe burrat të mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të mos ekzistojë pabarazia. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore".[1]

Rëndësia e Rezolutës 1325 si mjet avokimi është që fokusi që i bën ajo relacioneve gjinore, i përforcuar më tej përmes akteve ndërkombëtare, t'i japë lëvizjeve të grave legjitimitet dhe t'u sigurojë një platformë potenciale për bashkëpunim ndërkombëtar në sferën e zgjidhjes së konfliktit dhe arritjes së paqes së qëndrueshme. ..."Suksesi qëndron në vetë procesin, në krijimin e lëvizjes rajonale,...ne arritëm të ulemi aty dhe shtymë veten që të diskutojmë mbi çështjet e ndryshme, të prezantojmë problemet dhe për atë që ne mendojmë lidhur me to; pjesa e avokimit qëndron në vetë këtë proces".[2]

Edhe pse Rezoluta 1325 ka relevancë të veçantë për zonat e luftës, të gjitha shtetet anëtare të OKB-së janë të obliguara të zbatojnë rekomandimet e saj, që mbulojnë katër fusha të ndërvarura të cilat janë edhe në fokus të këtij raporti.

[1] Gender Mainstreaming: An Overview; UNIFEM 2002.
[2] Intervistë me Luljeta Vuniqin, korrik 2007.

Një definicion shumë shpesh i cituar i Rickard Strickland dhe Nata Duvvury[3] përshkruan fokusin kyç të Rezolutës 1325: Rezoluta 1325, që efektivisht paraqet një akt ligjor ndërkombëtar, shtjellon katër fushat e ndërvarura të cilat kërkojnë vëmendjen e të gjitha palëve (OKB-së, shteteve, akterëve joshtetërorë, shoqërisë civile) të përfshira në çështjet e paqes dhe sigurisë: pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe procese paqësore; përfshirjen e perspektivës gjinore dhe trajnimeve mbi proceset paqeruajtëse; mbrojtjen e grave; dhe përfshirjen e çështjeve gjinore në sistemet raportuese të OKB-së dhe në zbatimin e programeve të tyre.

Akterët joshtetërorë, forcat shtetërore të sigurisë, agjencitë humanitare dhe shoqëria civile bartin përgjegjësi për të kontribuar në artikulimin e Rezolutës 1325 dhe traktateve gjegjëse të të drejtave të njeriut në legjislacionin, politikat dhe praktikat vendore. Është me rëndësi fakti që Neni 17 i Rezolutës 1325 gjithashtu përcakton se Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Këshillit të Sigurimit, atje ku është e përshtatshme, që të përfshijë në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit "përparimin në drejtimet bazë gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse dhe në të gjitha aspektet e tjera që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat". Ky nen është shndërruar në shtyllë bartëse të të gjitha përpjekjeve lobuese nga grupet e shoqërisë civile të cilat kërkojnë përgjegjësi nga ndërkombëtarët gjatë punëve rindërtuese që realizohen pas intervenimeve të armatosura humanitare.

Duke njohur edhe raportet e mëparshme te monitorimet të zbatimit të Rezolutës 1325 në Kosovë, ky raport i monitorimit, ka anketuar të gjitha sektorët që bartin përgjegjësi specifike sa i përket zbatimit të Rezolutës 1325: organizatat ndërkombëtare, institucionet qeveritare të të gjitha niveleve dhe shoqërinë civile. Ky raport është i ndarë në dy pjesë: së pari i anketon akterët përgjegjës për zbatimin e Rezolutës 1325 dhe së dyti i shtjellon rezultatet e monitorimit sipas neneve të definuar nga Rezoluta 1325 si zona kyçe obliguese.

[3] Qendra Ndërkombëtare për Hulumtime mbi Gratë (Internacional Centre for Research on Women (ICRW)), "Barazia Gjinore dhe Ndërtimi i Paqes, nga retorika në realitet: Gjetja e shtegut. Dokument Pune, 2003: http://www.icrw.org/docs/gender_peace_report_0303.pdf (Shqyrtuar me 23 tetor të vitit, 2007).

PJESA E PARË: RESPODENTËT E MONITORIMIT

1. Institucionet dhe Organizatat Ndërkombëtare

Deklarimi i Pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 9 prill 2008, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, sollën realitet të ri ne Kosovë.[4] Në raportin e tij të muajit qershor (2008) para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka pranuar se Deklarata e Pavarësisë dhe hyrja në fuqi e Kushtetutës ka krijuar një realitet të ri në Kosovë. Ky realitet ka paraqitur sfida domethënëse për mundësinë e UNMIK-ut për të ushtruar autoritetin e tij administrativ dhe për të kryer shumicën e detyrave të tij, duke paraqitur nevojën për rikonfigurim të pranisë civile ndërkombëtare në Kosovë. Në korrik 2008, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka instruktuar UNMIK-un të bashkëpunojë me BE-në me qëllim që BE të pranojë një rol operativ të zgjeruar në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit në kuadër të Kombeve të Bashkuara.[5]

Në nëntor 2005, filluan negociatat për një marrëveshje finale dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara emëroi të dërguarin e posaçëm për statusin e ardhshëm të Kosovës-ish presidentin finlandez z. Martti Ahtisaari, i cili drejtoi ekipin e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNOSEK) në Vjenë (Austri) dhe u angazhua në bisedime të gjera me dy palët kryesore – ekipet negociuese nga Beogradi dhe Prishtina – dhe me partnerët ndërkombëtarë. Në vitin 2006, kanë filluar bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë rreth statusit të Kosovës, nën përkujdesjen e të Dërguarit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara, presidentit Martti Ahtisaari dhe në vëzhgimin e Grupit të Kontaktit, BE-së dhe NATO-s. Kjo ka rezultuar me përgatitjen e Raportit të të dërguarit special të sekretarit të përgjithshëm për zgjidhjen e statusit të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, e njohur me emrin "Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës" apo "Pakoja e Ahtisaarit".[6]

---

[4] "Është synim i Kosovës që të jetë shtet funksional, demokratik dhe i ndërtuar mbi bazën e kritereve të anëtarësimit në Bashkim Evropian dhe të jemi shtet konkurrues dhe meritor për t'u anëtarësuar", Kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi. /Telegrafi/http://www.shekulli.com.al/news/248/article/35515/2008-11-06.html.
Çdo hap i tentuar i Kosovës drejt Bashkimit Evropian, do të jetë i dështuar pa respektimin e të drejtave të grave në shkollim, në punësim, në pjesëmarrje efektive në politikë, në trashëgimi, në ndalim të ushtrimit të dhunës, në luftim të trafikimit. Patjetër duhet të ndryshojë mentaliteti i shoqërisë, kur dihet se çështjet e grave, qoftë në familje, qoftë në shoqërinë kosovare, ende konsiderohen si çështje të dorës së dytë. Respektimi I të drejtave të grave dhe barazia gjinore është një ndër standardet kryesore në Bashkimin Evropian, të cilit i kushtohet vëmendje e posaçme.-Blerina Gashi-Arritja dhe qëndrueshmëria e paqes në Evropë-Revista Teuta, shtator 2008, fq. 11.

[5] Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip.
Procesit të para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, nder te tjera i ka parapri edhe Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovën i cili ka definuar objektivat dhe veprimet e politikat që duhet ndërmarrë nga strukturat e IPVQ-ve, dhe institucionet tjera, në drejtim të arritjes së standardeve të të drejtave të njeriut, me qëllim të krijimit të një "një Kosove multietnike, stabile dhe demokratike që i afrohet standardeve Evropiane."5 UNMIK-u ishte përgjegjës për sundimin e ligjit, megjithatë të gjitha standardet duhet të arrihen në bashkëpunim mes IPVQ-ve dhe UNMIK-ut. Objektivat përqendroheshin në: Institucionet demokratike funksionale, Sundimin e ligjit, Lirinë e lëvizjes, Kthimin e qëndrueshëm dhe të drejtat e bashkësive dhe të anëtareve të tyre, ekonominë, të drejtat pronësore dhe trashëgiminë kulturore, Dialogun me Beogradin dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Shih - Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën, 2004
http://www.unmikonline.org/pub/misc/ksip_eng.pdf.

[6] Shih-Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (26 mars 2007).

Më 26 mars 2007, i të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës Presidenti Ahtisaari prezantoi paketën e tij gjithëpërfshirëse (Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës si dhe Raportin e tij) në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.[7]

Në gusht të vitit 2007, në mungesë të marrëveshjes në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, miraton një nismë të re për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Ai propozoi negociata të drejtpërdrejta, të ndërmjetësuara nga një treshe BE-ShBA-Rusi. Bisedimet e drejtpërdrejta mes Prishtinës dhe Beogradit filluan në Nju Jork në shtator të vitit 2007. Më 10 dhjetor 2007, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dërgoi raportin e treshes në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke konfirmuar se dy palët nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë marrëveshje. Raporti konfirmonte se procesi i negociatave është shterur. [8]

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (26 mars 2007) në Nenin përcakton: Një Grup Drejtues Ndërkombëtar (GND), i cili do të përbëhet nga akterët kyç ndërkombëtarë, do të emërojë Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) dhe do të kërkojnë nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratimin e emërimit. PCN-ja dhe Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE), i emëruar nga Këshilli i Bashkimit Evropian do të jenë i njëjti person.[9]

Deklarata e pavarësisë së Kosovës e datës 17 shkurt 2008, shprehimisht bën ftesë për një prani civile ndërkombëtare, ashtu siç parashihet në Propozimin Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës të hartuar nga i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën. Me datën 4 prill 2007, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka pranuar Propozimin Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës duke u zotuar që zbatimi i saj do të jetë obligim ligjor.
Në këtë drejtim, dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës tani janë të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe në ligjet vendore pasardhëse. Kjo Kushtetutë është certifikuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar me datën 2 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi me datën 15 qershor 2008.[10]

[7] http://www.ico-kos.org/.
[8] Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip.
[9] Shih Nenin12 (Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar) Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (26 mars 2007).
[10] Në Nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet:
1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.

1.1 Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar

Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN-ja) është emëruar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN)[11] më 28 shkurt 2008. GDN-ja ka ngarkuar PCN-në, me detyrën specifike që të garantojë se Qeveria e Kosovës zbaton Propozimin Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes së Statusit. Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) ndihmon Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) në përmbushjen e mandatit të tij. Grupi Drejtues Ndërkombëtar ka mandatuar Pieter Feith, ish zyrtar i lartë i NATO-s dhe i Sekretariatit të Këshillit të Bashkimit Evropian, si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar më 28 shkurt 2008 në Vjenë. Pieter Feith mban në të njëjtën kohë edhe mandatin e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë. Zyra e Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ofron mbështetje ndërkombëtare për të ardhmen Evropiane të Kosovës. [12]

Paraprakisht, Kosova, nga viti 1999, ishte një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, ku marrëdhëniet institucionale në Kosovë ishin të udhëhequra në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 1244 (Rezoluta 1244) të miratuar më 10 qershor 1999, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Rezoluta 1244 siguron kornizën ligjore ndërkombëtare për Kosovën. Ajo siguron vendosjen e pranisë ndërkombëtare civile, e njohur me pas me emrin Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe pranisë ushtarake në Kosovë e njohur me pas me emrin KFOR, nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara. Rezoluta 1244 autorizon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së me ndihmën e organizatave përkatëse ndërkombëtare, për të vendosur një prani ndërkombëtare civile në Kosovë, me qëllim të sigurimit të një administrimi të përkohshëm në Kosovë në bazë të mandatit të përcaktuar me Rezolutën 1244.

Sipas Rezolutës 1244, gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, i vishej UNMIK-ut dhe ushtrohej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).[13]

Që nga viti 2001,[14] UNMIK-u ka filluar të ndajë përgjegjësitë e veta me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) ndërsa në vitin 2003 i ka transferuar pjesën më të madhe të autorizimeve të veta tek ministritë e IPVQ-ve.[15] Nga 20 qershori i vitit 2008, UNMIK-u

---

[11] Grupi Drejtues Ndërkombëtar përbëhet nga shtetet të cilat përkrahin zbatimin e plotë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Shtetet anëtare të GDN-së janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Republika e Çekisë, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Sllovenia, Zvicra, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. http://www.ico-kos.org/

[12] http://www.ico-kos.org/

[13] Shih Rregullore e UNMIK-ut nr. 1999/1 (25 qershor 1999), për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë.

[14] Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), në bazë të kompetencave që i janë dhënë, me qëllim të krijimit të një vetëqeverisjeje kuptimplotë në Kosovë, deri në zgjidhjen përfundimtare, në vitin 2001, ka krijuar Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në fushat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore përmes pjesëmarrjes së popullit të Kosovës në zgjedhje të lira dhe të drejta.
Më 15 maj 2001, është aprovuar Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, (Korniza Kushtetuese), duke krijuar mundësitë e krijimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ve): Kuvendi i Kosovës, që zgjedh Kryetarin e Kosovës, Qeveria e udhëhequr nga Kryeministri që nominohej nga Presidenti, gjykatat, që emërohen gjykatësit nga PSSP në bazë të një liste të miratuar nga Kuvendi sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial dhe organet e institucionet e tjera, të parapara në Kornizën Kushtetuese.

[15] Country profiles: Web-faqja e UNIFEM-it
http://www.unifem.sk/index.cfm?modulewwwproject&pagewwwcountry&CountryISOwwwKS

kryesohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Lamberto Zannier (Italy).[16]

Gradualisht UNMIK-u ka kaluar nga roli ekzekutiv në rolin monitorues dhe ndihmës për institucionet kosovare. UNMIK-u, me prezencën e sotme që ka, është në fazën finale të përmbylljes.[17] Ne këtë drejtim, komuniteti ndërkombëtar ka bartur përgjegjësi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë, në pajtueshmëri me Rezolutën 1244. Me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, gjërat filluan të ndërrohen në këtë drejtim, dhe institucionet vendore filluan te marrin përgjegjësi edhe në sektorin e sigurisë, edhe pse Prania Civile Ndërkombëtare dhe Prania Ushtarake Ndërkombëtare akoma bartin përgjegjësi në sektorin e sigurisë dhe të sundimit të ligjit.[18]

1.2 Prania Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR-i)

Prania Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR-i), e udhëhequr nga NATO-ja, vazhdon të jetë përgjegjës për sigurinë e përgjithshme. Mandati i Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare në Kosovë-KFOR-it rrjedhë nga Rezoluta 1244 dhe nga "Marrëveshja ushtarake-teknike mes NATO-s dhe Republikës Federative te Jugosllavisë dhe Serbisë"[19], pas një fushate 78-ditësh të sulmeve ajrore të lansuara nga Aleanca në mars të vitit 1999[20] për ta ndalur agresionin e Millosheviqit kundër popullatës civile dhe për të detyruar tërheqjen e Ushtrisë Jugosllave nga Kosova.

KFOR-i fillimisht numëronte 50.000 ushtarë nga 35 vende të NATO-s, shtete partnere dhe shtete që nuk ishin pjesëtare të NATO-s, nën komandën dhe kontrollin e unifikuar. Ne fillim të vitit 2002, KFOR-i është reduktuar në rreth 39.000 trupa, ndërsa në fund të vitit 2003, me krijimin e ambientit të sigurt ky numër u zvogëlua ne 17.500. Sot KFOR-i numëron 15.000 pjesëtarë që janë të sistemuar në katër zona shumëkombëshe. Që nga viti 2005, mandati i KFOR-it ka kaluar nga fokusi primar në mbrojtje dhe demilitarizim në përkrahje të rindërtimit të institucioneve sociale dhe të komuniteteve anembanë Kosovës. Pas shpalljes së Pavarësisë më 17 Shkurt 2008, Aleanca ripohoi se KFOR-i do të qëndrojë në Kosovë në bazë të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, përveç nëse Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara vendos ndryshe. Në Qershor të vitit 2008, NATO u pajtua që të marrë përsipër detyra të reja në Kosovë për të mbështetur zhvillimin e strukturave profesionale, demokratike dhe multi-etnike të sigurisë.

Më 12 qershor 2008, NATO u pajtua që të fillojë zbatimin e detyrave të saj të reja në Kosovë, duke përfshirë shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe strukturave civile përgjegjëse për mbikëqyrjen e FSK. Këto detyra janë zbatuar në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim të vazhdueshëm me organet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Në takimin e tyre më 2-3 dhjetor 2008, Ministrat e Jashtëm të NATO-s ripohuan se prania e KFOR-it e udhëhequr nga NATO dhe me mandatin e

---

[16] Web-faqja e UNMIK-ut, http://www.unmikonline.org/intro.htm.

[17] Në muajin janar të vitit 2008 Stafi i UNMIK-ut, duke mos përfshirë policinë, ishte si në vijim: 462 ndërkombëtar, 1892 vendor, 125 Vullnetar të Kombeve të Bashkuara (UNV's). Ndërsa, OSBE në vitin 2007 kishte stafin prej 999 nga të cilët: 283 ndërkombëtar dhe 716 staf lokal. Shih ne http://www.unmikonline.org/.

[18] Shih Nenin 9 Sektori i sigurisë-Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (26 mars 2007), dhe Nenin 125 të Kushtetutës.

[19] Ueb-faqja e Kosovo Force (KFOR) NATO: http://www.nato.int/issues/kfor/index.html
Shih Military-Technical Agreement (MTA) between NATO and the Federal Republic of Yugoslavia and Serbia.

[20] Si evoluam? Web-faqja e NATO-s: http://www.nato.int/issues/kfor/index.html.

dhënë nga KB, do të vazhdojë në Kosovë në bazë të Rezolutës së KB 1244. Ata theksuan shtrirja e menjëhershme e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) në tërë territorin e Kosovën është prioritet urgjent dhe në këtë kontekst vunë në dukje miratimin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së të një deklarate presidenciale në mbështetje të rikonfigurimit të UNMIK-ut. Ata gjithashtu ripohuan se NATO do të vazhdojë angazhimin e saj për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në bazë të fondeve vullnetare të mirëbesimit të NATO's.[21] Në mandatin e tij aktual janë edhe ofrimi i përkrahjes për institucionet civile, rendin dhe ligjin, sistemin gjyqësor dhe penal, proceset elektorale dhe aspektet tjera të jetës politike, ekonomike dhe sociale. Qartë, kjo bën që edhe KFOR-i të jetë i afërt me dispozitat e Rezolutës 1325, megjithatë, ngjashëm me të gjitha institucionet tjera të OKB-së apo NATO-s, KFOR-i nuk i jep përgjegjësi qytetarëve të Kosovës, kështu që mbetet në përgjegjësinë e shteteve që i delegojnë trupat në KFOR që t'i trajnojnë ata sa i përket mirësjelljes gjinore dhe të inkorporojnë përfshirjen e perspektivave gjinore në strukturat e trupave të tyre. Statistikat gjinore për personelin e KFOR-it nuk janë në dispozicion. Sidoqoftë, artikujt nga femrat që shërbejnë në KFOR apo ata të shkruar lidhur me to, tregojnë se shumë nga femrat në KFOR shërbimin ushtarak e vlerësojnë thjeshtë si një etapë të karrierave të tyre dhe përkundër faktit që zakonisht kanë qëndrime pozitive lidhur me kolegët që kryesisht janë meshkuj, ato shërbejnë të izoluara nga gratë tjera.[22]

Sipas Pauline Menthonex, ushtarakët ndërkombëtarë nuk janë shumë të entuziazmuar me termin barazi gjinore dhe ata qeshin me ne qe merremi me këtë çështje. Kur erdhi për rekrutim të pjesëtareve të forcës së re mendova se do të ishte mirë të dërgoja një emal lidhur me zbatimin e ligjit për barazi gjinore gjatë rekrutimit dhe pyeta për planet e tyre rreth aplikimit të kuotës gjinore dhe përgjigja ishte me një të qeshur nga një oficer i lartë në NATO. Kështu që nuk duhet të fajësojmë vetëm qeverinë mirëpo duhet të gjejmë një zgjedhje se si të bëjmë të ndryshojë kjo gjendje.[23]

Personeli i Pranisë Civile Ndërkombëtare dhe Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare janë të mbrojtur nga përndjekja në Kosovë, përmes imunitetit që u garantohet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr 2000/47 dhe me Ligjin nr. 03/l-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj.[24]

Edhe pse as Rezoluta 1244 e as Marrëveshja e Rambujesë nuk përmendin apo adresojnë në mënyrë eksplicite marrëdhëniet gjinore, duke marrë parasysh se konfliktet moderne ushtrojnë ndikim joproporcional tek civilët, e në veçanti tek gratë e fëmijët, është e qartë se sa relevante janë dispozitat e Rezolutës 1325 për përgjegjësitë e ndërtimit të paqes që i bartë UNMIK-u, të

[21] http://www.nato.int/issues/kfor/index.html.

[22] KFOR CIS, "Gratë kanë shërbyer në armata anembanë botës për shumë vite" Kronika e KFOR-it, 11 mars 2002.
Tara Buonaiuto, "Suksesi total i OJQ-ve!!!" Kronika e KFOR-t, 29 shtator 2004, http://www.nato.int/kfor/chronicle/2004/chronicle_09/07.htm.

[23] Intervistë me Pauline Menthonex, shkurt 2009.

[24] Shih Nenin 2.1 Rregullore e UNMIK-ut nr.2000/47 (18 gusht 2000), për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të personelit të tyre, dhe Ligjin nr. 03/l-033 rregullon Statusin, Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore dhe personelin në Republikën e Kosovës dhe Praninë Ndërkombëtare Ushtarake si dhe personelin e saj. Neni 10 (Statusi, imunitetet dhe privilegjet e pranisë ndërkombëtare ushtarake (PNU)).

definuara më lartë.[25] Shumica e përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar që i kemi intervistuar[26] besojnë që përgjegjësinë për zbatimin e Rezolutës 1325 duhet ta bartin organet më të larta të vendimmarrjes.

Përfshirja e çështjeve gjinore në mekanizmat institucionalë, sipas përcaktimeve të Rezolutës 1325 dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare gjegjëse të të drejtave të njeriut, siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) e vitit 1979, nuk realizohet kryesisht për shkak të mungesës së përkushtimit praktik, dhe rrjedhimisht mbetet një formulim retorik që varet në masë të gjerë nga niveli i njohurive paraprake të individëve të cilët zakonisht janë të angazhuar me kontrata afatshkurtra. Në nivelet më të larta vendimmarrëse të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë janë të angazhuara një numër relativisht i vogël i grave. Ironia është që Qeveria e Kosovës duhet t'i përmbahet parametrave gjinorë që nuk zbatohen në vetë strukturat e mekanizmave ndërkombëtar të pranishme në Kosovë.

Megjithatë, margjinalizimi i grave dhe përfshirja e çështjeve gjinore si fokus operativ i institucioneve ndërkombëtare janë përmendur shpesh në intervista dhe i janë atribuar ose kulturës maskuline të institucioneve ndërkombëtare ose mungesës së pashpjegueshme të trajnimit brenda institucioneve ndërkombëtare sa i përket çështjeve gjinore.

Siç theksonte ish PSSP, Soren Jessen-Petersen: Rezoluta 1325 kërkon pjesëmarrjen e grave në të gjitha proceset politike dhe shoqërore, etj. Por për fat të keq, ajo nuk garanton zbatimin e kësaj, ngase kjo nuk varet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Në rastin e Kosovës, kjo përgjegjësi bie mbi ata që bartin autoritetet. Ne mund të kërkojmë, insistojmë dhe punojmë por nuk mund të garantojmë që liderët vendor do ti kyçin gratë për pjesëmarrje.[27]

Sidoqoftë, sipas Rezolutës 1325, UNMIK-u dhe EULEX-i kanë përgjegjësi eksplicite për zbatimin e dispozitave të kësaj Rezolute, siç parashihet me nenet 5-9, përfshirë edhe kushtëzimet e ndikimit të ndryshueshëm të procesit të rindërtimit pas konfliktit për gratë dhe në relacionet gjinore.

Në këtë raport kemi marrë në shqyrtim vetëm akterët më të rëndësishëm ndërkombëtar që kanë qenë dhe janë të pranishëm në Kosovë dhe që operojnë në lidhje me institucionet kosovare.

1.3 EULEX Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit

Në shkurt të vitit 2008, Këshilli për Çështje të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme është pajtuar për një Aksion të Përbashkët për të vendosur një mision për sundimin e ligjit në Kosovë, të njohur si "EULEX". Detyra kryesore e misionit është mentorimi, monitorimi dhe këshillimi.[28] EULEX ka po ashtu edhe disa funksione ekzekutive. Këshilli, po ashtu, është pajtuar në Aksionin e Përbashkët[29] për të caktuar një Përfaqësues Special të BE-së në Kosovë (PSBE). PSBE këshillon dhe mbështet procesin politik dhe siguron konsistencën e veprimit të BE-së në

[25] Shih për shembull Joan Chittister, "Vlerësimi i Konceptit të Sfidës së Viktimave Civile në Luftërat e Drejta", Washington Post, 10 janar 2007, http://newsweek.washingtonpost.com/onfaith/joan_chittister/2007/01/just_cause_or_just_ëar.html

[26] Nga intervistat e ndërmarra nga hulumtuesit e RRGGK.

[27] Tek "Siguria e kujt?" Film dokumentar i Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Gjinore. Regjia: Antoneta Kastrati dhe Casey Cooper Johnson, 2006.

[28] Veprimi i Këshillit të Përbashkët 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008 për Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË.

[29] Veprimi i Këshillit të Përbashkët 2008/123/CFSP i 4 shkurtit 2008 për caktimin e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë.

Kosovë. Në rolin tjetër, ai mbikëqyr implementimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen e Statusit të Kosovës. PSBE raporton te Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Si PCN, ai raporton te GND për Kosovën, i cili përbëhet prej 25 vendeve që kanë njohur Pavarësinë e Kosovës.

Dispozitat kalimtare të Kushtetutës konfirmojnë rregullimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, të paraparë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. EULEX është misioni më i madh civil deri më tani i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP). Synimi kryesor i tij është t'i ndihmojë dhe mbështesë autoritetet kosovare në fushën e sundimit të ligjit, posaçërisht në fushën e policisë, gjyqësisë dhe doganave. Qëllimi i misionit nuk është të sundojë apo të administrojë në Kosovë. Ky është një mision teknik i cili do të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë përderisa do të mbajë një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive. EULEX vepron në një kuadër të përgjithshëm të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe ka një zinxhir të njësuar komandues në Bruksel.[30]

Me 28 Shkurt 2008, Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova, deputetja në parlamentin e Kosovës Edita Tahiri dhe Udhëheqësja e Zyrës se UNIFEM-it në Kosovë Flora Macula në Komisionin për Barazi Gjinore në Parlamentin Evropian në Bruksel, informuan për pozitën e gruas dhe kërkuan njëzëri aplikimin e zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë. Rogova u shprehu mirëseardhje në Kosovë Misionit Evropian (EULEX) dhe theksoi se ata duhet të mësojnë nga gabimet e bëra të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në pajtim me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ata duhet të involvojnë gratë në të gjitha programet planifikuese, përpilimin e politikave dhe ndërtimin e paqes. UNMIK-u ka dështuar në këtë pikë, shtoi ajo.[31] Zonja Macula ngriti Çështjen e veprimit të misionit të EULEX-it në Kosovë dhe përgjegjësinë/llogaridhënien me pyetjen "Kush do të monitorojë monitoruesit" pasi që nuk ekziston mekanizëm i veçantë në BE që kontrollon veprimet e shteteve anëtare në lidhje me shkeljen e drejtave të njeriut apo të drejtave të grave.

Më datën 10 tetor 2008, Presidenca Franceze e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Zyra e UNIFEM-it në Bruksel, në bashkëpunim me Komisionin Evropian, organizuan konferencë të nivelit të lartë lidhur me "Zbatimin e Rezolutës 1325 dhe Rezolutës 1820 në misionet e BE-së: Përmirësimi i sigurisë së menjëhershme dhe afat-gjatë për gratë". Në këtë Konferencë pjesëmarrës ishin edhe gratë aktiviste, institucionet qeveritare dhe përfaqësuesit e sektorit të sigurisë nga Kosova. Kosova ishte e përfshirë si rast studimor.

Në këtë Konferencë u paraqiten edhe Igballe Rogova dhe Gjeneral Atifete Jahjaga, e cila foli për të arriturat e Policisë së Kosovës, ne rrafshin e barazisë gjinore, dhe të drejtat e grave dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës.

Duke dëshmuar se UNMIK-u nuk e ka zbatuar Rezolutën 1325, para ardhjes së EULEX-it ne kemi lobuar edhe në Bruksel, Strasburg, përmes Lobit Rajonal të Grave dhe Koalicionit të Grave për Paqe edhe përmes RRGGK-se ne kemi ngrit zërin duke treguar gabimet të cilat i ka bërë UNMIK-u dhe duke i informuar më herët që të mos përsëriten më të njëjtat gabime edhe nga EULEX-i. Mund të them se ka pas një jehonë, pasi që ditën e parë, që ka ardhë EULEX-i, kanë kërkuar një takim dhe janë diskutuar gjërat dhe kanë hapë Zyrën për Çështje Gjinore brenda EULEX-i. Mirëpo, hapja e kësaj zyre nuk do të thotë se ata do ta zbatojnë, por ne ju

[30] http://www.ico-kos.org/
[31] Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 1 dhjetor 2007 - shkurt 2008, www.Womensnetwork.org

thamë përfaqësuesve të EULEX-it, se ne do ju monitorojmë juve se sa do ta zbatoni Rezolutën 1325, thekson Igballe Rogova.[32]

Shqipe Krasniqi, u.d Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore në Qeverinë e Republikës së Kosovës, thekson se "...mendoj se EULEX mund të jetë pjesë e bashkëpunimit tonë dhe mund të na ofrojë konsulenca të ndryshme..." [33] EULEX që tani ka në vete Zyrën për Çështje Gjinore dhe mundohet që të shtojë numrin e femrave që punojnë në polici dhe të futen femra në pozitat senior.[34]

Sipas Maria Fihl-Vetting, "EULEX-i ka program shumë ambicioz lidhur me Rezolutën 1325 dhe mendoj se e kanë të kyçur një pjesë të Rezolutës ne Kodin e Etikës së misionit. Pjesëmarrja e grave në këtë mision është me shumë e avancuar dhe i tërë ekipi janë shumë më të përgatitur sa i përket qasjes në barazi gjinore ndoshta kjo ndodhë sepse EULEX-i mundohet t'i thyej paragjykimet dhe është në drejtim më të mirë të punës se sa UNMIK-u, në polici dhe gjykatë ata kanë komponentin gjinor shumë të theksuar dhe të qëndrueshëm."[35]

Ne, si EULEX, thekson Susanne Backstedt, jemi këtu njëherit vetëm për 2 vite prandaj ...mendoj se jeni në rrugë të mirë të luftoni për të drejtat tuaja dhe EULEX është këtu vetëm për të këshilluar asgjë tjetër duhet të jeni shumë të pavarur në punën tuaj jeni një grup shumë i fortë.[36]

1.4 Zyra e Përfaqësuesit Special e Bashkimit Evropian

Zyra e PSBE-së është themeluar përmes Veprimit të Përbashkët të Këshillit, të datës 04 shkurt 2008. PSBE-ja i raporton Këshillit të Bashkimit Evropian[37], një organ ndër-qeveritar i cili përfaqëson 27 shtetet anëtare të BE-së, përmes Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, Javier Solana. PSBE këshillon dhe mbështet Qeverinë e Kosovës në procesin e saj politik drejt integrimit evropian; ofron koordinim të përgjithshëm mbi pranitë e BE-së në Kosovë; dhe kontribuon në zhvillimin dhe konsolidimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në Kosovë.[38]

1.5 Komponenti Policor në Kosovë i Misionit EULEX

Është pjesë e mbështetjes së përgjithshme të EULEX-it për autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. Ka për qëllim të ndihmojë Policinë e Kosovës (PK) për t'u zhvilluar drejt një policie shumë-etnike e cila duhet të jetë pa ndikime politike dhe që i shërben popullit të Kosovës.

Komponenti i Policisë së EULEX-it do të ketë një fuqi të përgjithshme prej 1.400 zyrtarëve policor ndërkombëtar, të paraparë të shpërndahen në tërë Kosovën. Personeli është i strukturuar sipas detyrave të tyre përkatëse në tri departamente: Departamenti fuqizues, Departamenti i Policisë Ekzekutive, dhe Departamenti i Policisë Speciale. [39]

---

[32] Intervistë me Igballe Rogova, shkurt 2009.
[33] Intervistë me Shqipe Krasniqin, shkurt 2009.
[34] Intervistë me Theodora Krumova, shkurt 2009.
[35] Intervistë me Maria Fihl-Vetting, shkurt 2009.
[36] Intervistë me Susanne Backstedt, shkurt 2009.
[37] Duhet cekur qe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian-funksionon në Kosovë që nga viti 2004. Kjo zyrë ndihmon në shtyrjen e reformave përmes dialogut të rregullt politik dhe teknik. Ofron fonde të rëndësishme për projekte për përforcimin e institucioneve, zhvillon ekonominë dhe realizon standardet evropiane; mbështetë procesin e Stabilizim Asociimit.
[38] http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?idwww2
[39] http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?idwww9

Sipas Rainer Kuehn Shef i Policisë së Misionit EULEX, thekson: Ne synojmë ta bëjmë këtë duke monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar SHPK-në. Kështu që, zyrtarët policor të EULEX-it do të vendosen bashkë me homologët e tyre të SHPK-së. Duke qenë se ne e respektojmë parimin e pronësisë vendore, zyrtarët policor të EULEX-it kryesisht do të veprojnë në rol mbështetës. SHPK-ja, jo EULEX-i, do të udhëheqin. Mandati jonë po ashtu na jep mundësi për të përdorur kompetencat korrigjuese. Do të na duhet të intervenojmë posaçërisht në rast se autoritetet e Kosovës dështojnë ta ndalojnë dhunën ndaj komuniteteve jo shumicë apo në raste të ndërhyrjeve politike të cilat rrezikojnë sundimin e ligjit. Megjithatë, shpresojmë se përdorimi i kompetencave korrigjuese do të jetë i nevojshëm vetëm në raste të jashtëzakonshme.[40]

Programi i Policisë Ndërkombëtare Civile (CIVPOL) i krijuar nga UNMIK-u, ka qenë vendimtar për zhvillimin e një force policore të paanshme dhe të pavarur lokale, të quajtur Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK). CIVPOL dhe SHPK paraqesin një shembull të mirëfilltë si për institucionet vendore ashtu edhe për ato ndërkombëtare, sa i përket zbatimit të Rezolutës 1325 dhe përkushtimit drejt integrimit të barazisë gjinore në të gjitha aspektet e fushëveprimit dhe obligimeve të kanë. Në parim, CIVPOL ishte i përkushtuar drejt arritjes së barazisë gjinore në radhët e veta. Trajnimet lidhur me çështjet "gjinore" duket se ndikoheshin nga buxheti joadekuat. Megjithatë, përkundër njohjes zyrtare të Rezolutës 1325 dhe mekanizmave relevantë ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, shumica e komisarëve, eprorëve dhe pjesëtarëve të policisë ndërkombëtare ishin në masë të gjerë të painformuar lidhur me Rezolutën 1325.

Mes pjesëtarëve të CIVPOL-it kishte dyzetë e gjashtë kultura shumë të ndryshme, kështu që mënyra se si i shihnin ata çështjet gjinore ndryshonte në thelb[41]. Kësisoj ishte shumë e vështirë që të kërkohej një zë dhe një botëkuptim i vetëm sa i përket çështjeve gjinore. Shumë njerëz thonin që kjo është çështje e grave, por kjo nuk është çështje grash por çështje e grave dhe burrave, dhe ky kuptim është i domosdoshëm për policinë, për arritjen e një policie profesionale, që do të mbron dhe siguron komunitetin, dhe që rrjedhimisht duhet të ketë njohuri nga më të ndryshmet. Për këtë duhet të punojnë burrat dhe gratë. Balanca gjinor është një çështje e vogël, por njohja e grupeve specifike në komunitet në mënyrë që policia të dijë se si tu qaset atyre, p.sh. homoseksualët apo grupet e ndryshme etnike dhe prania e këtyre grupeve në vetë forcën policore do të paraqiste një shumëllojshmëri të duhur.

Në vitet 2005-2006 në Kosovë ishin angazhuar rreth 81 zyrtare të policisë, nga një mision që numëron gjithsejtë 4468 pjesëtarë.[42] Intervista me Këshilltarin e Lartë për Çështje Gjinore të CIVPOL-it, zbuloi megjithatë se ekzistonin pengesa financiare ndaj punësimit të specialistëve, ofrimit të trajnimeve dhe adresimit efektiv të mungesës së vetëdijes gjinore në të dyja forcat policore, vendore dhe ndërkombëtare, për shembull: Për çështjet gjinore gjatë kryerjes së detyrës së policit, ata menjëherë mund të kenë në mend dhunën në familje, keqtrajtimin e fëmijëve apo trafikimin dhe t'i trajtojnë këto si çështje të grave, gjë që nuk janë... dhe më pas mund të flasim lidhur me "inteligjencën"..."Inteligjencën? Çfarë kanë të bëjnë çështjet gjinore me inteligjencën?" "Më falni por 50 përqind e popullatës suaj është e gjinisë femërore, dhe ato nuk flasin me meshkujt ngase femrat flasin vetëm me femrat. Nëse dëshironi të arrini deri te ndonjë informatë, ju duhet të keni femra në njësitin e inteligjencës." Nëse dy meshkuj, për shembull, e marrin në pyetje një femër të traumatizuar në një rast të vrasjes apo dhunimit mund të paraqesë

[40] http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?idwww9 Rainer Kuehn: Komponenti Policor i Misionit EULEX Kosova.
[41] Shih UNMIK Police Awareness of UN Resolution 1325, fq. 11: "Zyrtaret femra punojnë në njësinë time. Personalisht unë nuk kam pasur përvojë pune me gjini të kundërt deri tani në mision"-Deklaratë e Policit Pakistanez pjesëtar i Policisë së UNMIK-ut.
[42] Ueb-faqja e CIVPOL: http://www.civpol.org/unmik/

një problem të sigurisë, ngase edhe *nëse* femra flet (ndërsa mund edhe të mos dojë të flas me meshkuj për këtë punë) mund të ndodhë që ajo të ripërjetojë tërë ngjarjen e në fund të hetimit të thotë që prapë është dhunuar – por nëse ekipi hetues përbëhet edhe nga meshkujt edhe nga femrat, kjo rrallë herë mund të ngjajë.

Policia e UNMIK-ut, për mendimin tim, shprehet një nga respodentët, nuk kanë sjell ndonjë përvojë të mirë në fushën e barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, kjo dihet ngase kemi pas pjesëtarë të policisë edhe nga vendet ku asnjëherë nuk kanë bërë ndonjë gjë ne respektimin e të drejtave të njeriut. E vetmja gjë e mirë qe kanë arrit të bëjnë ka qenë një këshilltare e komisarit, e cila ishte nga Holanda, dhe e cila krijoi një strukturë të oficerëve të cilët merren me çështje gjinore. Në aspektin teorik mendoj se na kanë sjell mjaftë... mirëpo OKB dhe OSBE nuk kanë sjell praktika të mira, përvoja të mira brenda organizatave të tyre se po të shikosh administratat e tyre mund të konkludojmë se në Policinë e UNMIK-ut ka pas 2 deri në 3% femra kurse në Policinë e Kosovës kemi 17% femra që shkonte drejt ngritjes, që do të thotë se praktika nuk ka qenë motivuese për ne.[43]

1.6 Zyra për Çështje Gjinore (ZÇGJ) e UNMIK-ut

ZÇGJ është themeluar pas shpalljes së Rezolutës 1325 në vitin 2000. UNMIK-u ka riorganizuar ZÇGJ si zyrë këshillëdhënëse politike e PSSP-së në vitin 2004. ZÇGJ ishte themeluar për të mbuluar një "mandat gjithëpërfshirës"[44] për të përfshirë dhe siguruar konsistencë lidhur me mënyrën se si çështjet gjinore integrohen përbrenda shtyllave të ndryshme të UNMIK-ut dhe zyrave përmbajtjesore dhe për të monitoruar dispozitat e barazisë gjinore gjatë zbatimit të Standardeve për Kosovën, Planit për Zbatimin e Standardeve dhe Prioriteteve të Partneritetit Evropian. ZÇGJ gjithashtu ka bartë përgjegjësi për rifuqizimin e kapaciteteve të IPVQ-ve për të adresuar çështjet gjinore në nivel qendror dhe komunal. Një funksion i rëndësishëm i ZÇGJ ishte roli që bartë sa i përket punës që kryen me institucione për përkrahjen e organizatave të grave dhe grave minoritare në qasjen ndaj niveleve më të larta të qeverisë dhe autoriteteve të OKB-së. Në UNMIK, zërat e grave thjeshtë margjinalizohen. Nuk ekzistonte ndonjë përkushtim i vërtetë për atë që angazhohej Rezoluta 1325.

1.7 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK) ka detyrë të veçantë të sigurohet se të gjitha komunitetet kanë qasje të barabartë ndaj "të gjitha dispozitave të garantuara me institutet e ndryshme" të institucioneve kosovare. Kjo do të thotë se OMIK duhet të ndihmojë në bartjen e përgjegjësive tek Institucionet Kosovare në mënyra që garantojnë respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, në këtë drejtim OMIK është i obliguar që të funksionojë në pajtueshmëri me dispozitat e Rezolutës 1325.[45]

OSBE ka qenë përgjegjëse për hartimin e shumë Rregulloreve të UNMIK-ut që kanë të bëjnë me çështjet gjinore. Stafi i OSBE-së është gjithashtu i përfshirë në fushatat kundër trafikimit dhe dhunës në baza gjinore, si dhe në këshillimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit. Sidoqoftë, Rezoluta 1325 nuk është publikuar apo përdorur strategjikisht si kornizë për veprim në OSBE.

[43] Intervistë me Behar Selimin, janar 2009.
[44] Ueb-faqja e ZÇGJ në UNMIK, http://officeofgenderaffairs.unmikonline.org/.
[45] Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë: Shtylla III (OSBE) Prioritetet Programatike për vitin 2004, Prishtinë, 08 Janar, 2004
http://www.osce.org/documents/mik/2004/01/2219_en.pdf.

Megjithatë, mekanizma institucionalë dhe ligje të shumta të përgatitura nga OSBE kanë për qëllim përfshirjen e çështjeve gjinore në operacionet e veta dhe ofrimin e ndihmës për përpjekjet e qeverisë vendore drejt arritjes së barazisë gjinore. Për shembull:

1. Plani i Veprimit për Promovimin e Barazisë Gjinore, i OSBE-së, nga viti 2004[46] promovon parandalimin e diskriminimit gjinor në fushat politike, ushtarake, ekonomike, mjedisore dhe njerëzore të qeverisjes. Ky plan ka për qëllim të arrijë këtë cak përmes krijimit të një kornize për organizimin dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve, të cilat shqyrtohen nga Sekretariati i OSBE-së.

2. Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së Numër 14/05[47], miratuar më 6 dhjetor 2005, krijon lidhje të drejtpërdrejt mes barazisë gjinore dhe sigurisë, ngjashëm me Rezolutën 1325. Ajo i jep prioritet pjesëmarrjes së grave në "parandalim të konfliktit, menaxhim të krizave dhe rehabilitim pas konfliktit". Vendimi i bën referencë Planit të Veprimit të OSBE-së të vitit 2004, dhe inkurajon bashkëpunimin mes shteteve pjesëmarrëse, shtimin e grave të punësuara në Sekretariat, administratë publike dhe operacione në terren. Vendimi në mënyrë specifike kërkon nga PSSP që të raportojë mbi zbatimin e Planit të Veprimit në relacion me dispozitat e Rezolutës 1325.

3. Vendimi Ministror i OSBE-së Numër 15/05[48], miratuar më 6 dhjetor të vitit 2005 riafirmon Deklaratën e OKB-së mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, dhe Deklaratën e Platformën Vepruese të Pekinit. I bën referencë dispozitave të Rezolutës 1325 për mbrojtjen e plotë të të drejtave të grave dhe vajzave në situata të konfliktit dhe paskonfliktit, si dhe zotohet të përkushtohet ndaj Protokollit të OKB-së për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, posaçërisht të Grave dhe Fëmijëve. Ky vendim kërkon përmirësimin e nivelit të pavarësisë ekonomike të grave dhe kriminalizimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave e vajzave, si dhe ofron një dispozitë për ndihmë dhe mbrojtje të viktimave të krimeve të dhunës në baza gjinore.

Brenda Divizionit për të Drejtat e Njeriut dhe atij për Sundim të Ligjit, puna mbi çështjet gjinore fokusohej kryesisht në përkrahjen e zhvillimit praktik të legjislacionit dhe mekanizmave për zbatimin e tij. Përmes Sektorit për Avokim dhe Përkrahje të Viktimave, ky departament vazhdonte të ishte pikë qendrore e misionit sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me anti-trafikimin, dhunën në baza gjinore, përkrahjes legjislative dhe politike të institucioneve qeveritare përgjegjëse për çështje gjinore dhe ndihmë të viktimave. Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (NMNV) ishte krijuar në Divizionin për Zhvillim Gjyqësor në vitin 2002 për të adresuar nevojat e viktimave të krimit, në veçanti ato të viktimave të dhunës seksuale dhe asaj në familje dhe të trafikimit, për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në fazat e përndjekjes dhe procese gjyqësore.

"Tani edhe viktimat më të cenuara gëzojnë ndihmë institucionale. Ato nuk do të ndihen më të vetmuara, të pambrojtura, të stigmatizuara apo frikësuara në paraqitjet para gjyqit" deklaronte Vjosa Muhaxheri, Koordinatore Kosovare për Përkrahjen e Viktimave në NMNV.[49]

[46] Vendimi Nr. 14/04, Plani i Veprimit i OSBE-së për Promovimin e Barazisë Gjinore, 2004, Këshilli i Ministrave, OSBE, Sofje, dhjetor 2004, http://www.osce.org/documents/mcs/2004/12/3917_en.pdf
[47] Këshilli i Ministrave, OSBE, Lubjanë 2005, http://www.osce.org/documents/mcs/2005/12/17432_en.pdf
[48] Këshilli i Ministrave, OSBE, Lubjanë 2005 http://www.osce.org/documents/mcs/2005/12/17433_en.pdf
[49] Shih Mumbi Njau, "Mbrojtja e viktimave, sigurimi i drejtësisë për viktimat,"Focus Kosovo", shkurt 2003.

1.8 Programi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP)

UNDP ka qenë i pranishëm në Kosovë që nga "faza emergjente" e vitit 1999. Mandati i vet përfshin ndërtimin e kapaciteteve në komunitetin e ekspertëve dhe institucioneve vendore, në mënyrë që edhe më tej të zhvillojë shkathtësitë në hartimin e politikave në Kosovë. Një fokus i rëndësishëm i tij është rrjetëzimi në çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin njerëzor mes vendimmarrësve kosovarë, medieve, shoqërisë civile dhe opinionit publik.

Pauline Menthonex, "ne kemi qenë shumë fatlum sepse Kosova është një rast i veçantë në shumë aspekte, pritet të kemi për tërë regjionin Ekspert të Lartë të çështjeve gjinore në zyret e Kosovës të UNDP-së, ...ky ndryshim i ri do të sjellë problemet esenciale ku do të sigurojë me shumë koordinim brenda UNDP-së dhe do të shkojë drejt zbatimit të Rezolutës 1325...unë kam një shpresë të madhe se do të ndryshojnë gjerat në aspektin e politikave gjinore me ardhjen e personit që do të përfaqësojë këtë zyrë për çështje gjinore ...mendoj se do të jetë një prej mekanizmave që do të ndihmojë zbatimin e Rezolutës 1325".[50]

1.9 Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM)

UNIFEM "Ofron ndihmë financiare dhe teknike për programet dhe strategjitë inovative, përmes të cilave nxitet fuqizimi i grave dhe barazia gjinore"[51] UNIFEM-i ka qenë i pranishëm në Kosovë që nga gushti i vitit 1999. UNIFEM-i në Kosovë është i përqendruar në ofrimin e "ndihmës financiare apo teknike për iniciativat programatike inovative të cilat promovojnë të drejtat e grave dhe fushat kryesore të pjesëmarrjes politike të grave, të drejtat e sigurisë ekonomike, dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave"[52] Sikur UNDP dhe UNHCR, UNIFEM punon si një organizatë ndërqeveritare e OKB-së, që ndërlidhet dhe bashkëpunon me qeverinë dhe shoqërinë civile "...punon me agjencitë tjera të OKB-së ngase mandati jonë është të përfshijmë çështjet gjinore brenda agjencive tjera të OKB-së".[53] UNIFEM ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e qeverisë dhe shoqërisë civile në negocimin dhe sajimin e Planit të Veprimit për Avancimin e Barazisë Gjinore, të miratuar nga qeveria në vitin 2004. Pas krijimit të Zyrës për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Zyrën e Kryeministrit, UNIFEM ka vazhduar të përkrahë në forma të ndryshme ZBGJ-në , sidomos Drejtorinë Ligjore të ZBGJ-së dhe ka kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve të stafit edhe pas riemërtimit të ZBGJ-së në Agjenci për Barazi Gjinore (ABGJ). Në vitin 2008, UNIFEM-i ka ndihmuar ABGJ-në në përgatitjen e raportit zyrtar për Konventën e Eliminimit e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (CEDAË), i cili do të dërgohet dhe mbrohet para Komitetit të Konventës në Gjenevë.

Duke iu qasur specifikisht Rezolutës 1325, Flora Macula, Udhëheqëse e Zyrës së UNIFEM-it në Kosovë, komenton: …ne punojmë në dy drejtime, i pari ka të bëjë me përkrahjen e aktiviteteve/ veprimeve të shoqërisë civile lidhur me avokimin ky si partner kryesor që nga viti 2003 e kemi Rrjetin e Grave të Kosovës, me të cilin bashkëpunojmë ngushtë në të gjitha fushat, në veçanti do të thellojë përkrahjen sa i përket zbatimit dhe monitorimit të Rezolutës 1325, dhe në anën tjetër me përkrahjen e institucioneve qeveritare dhe/ose sektorëve tjerë të sigurisë në zbatimin e Rezolutës 1325, kështu që jemi duke e përdorur Rezolutën 1325 si mjet gjatë avokimit për ngritjen e pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së grave. Ndërtimi i paqes është një proces kompleks dhe kërkon angazhimin e çdo individi, pa anashkaluar përfaqësimin e grave, 50% të popullatës, në proceset vendimmarrëse gjatë ndërtimit apo ruajtjes së paqes ne vend dhe rajon. Kontributi i Rrjetit të Grave të Kosovës në ngritjen e rëndësisë të zbatimit të rezolutës 1325 i kalon kufijtë e

[50] Intervista me Pauline Menthonex, shkurt 2009.
[51] Shih http://www.unifem.org/
[52] Intervista me Flora Maculën, korrik 2007.
[53] Po aty.

Kosovës. Rrjeti ka ndihmuar edhe organizatat e grave nga vendet e rajonit në përpjekjet e tyre sa i përket zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të Rezolutës 1325.

UNIFEM vazhdon të financojë dhe përkrah trajnimet për profesionistët ligjor në çështjet gjinore dhe për ndërtimin në përgjithësi të kapaciteteve në sektorin profesional, specifikisht lidhur me harmonizimin e ligjeve ekzistuese dhe ligjeve të reja me perspektivën gjinore të OKB-së dhe me normat ndërkombëtare. Vlen të përmendën; trajnimet për zyrtaret/ët për të drejta të njeriut të ministrive në fushën e të drejtave njerëzore të grave, përkrahjen e UNIFEM-it që iu ofrua Zyrës për Qeverisje të Mirë në hartimin e Strategjisë për të Drejtat e Njeriut dhe përkrahjen e Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës në lidhje me pjesëmarrjen e grave ne sistemin gjyqësor.

Flora Macula, lidhur me punën në vazhdimësi të UNIFEM-it ndër të tjera thekson: Kemi iniciuar formimin e një grupi qe thirret "Grupi për siguri dhe çështje gjinore", ku janë pjesëmarrës anëtaret e Agjencioneve të Kombeve të Bashkuara, të, EULEX- it, ICO- së, OSBE- së, dhe Qeverisë, me qëllim që te koordinohet puna në rrafshin e sigurisë së grave, dhe që të përkrahen iniciativat e qeverisë në përmbushjen e të drejtave njerëzore të grave, me shpresë se do të ndërtohet një mekanizëm që raporton dhe monitoron integrimin e çështjeve gjinore në fushën e sigurisë.

UNIFEM, po ashtu, punon edhe me Policinë e Kosovës, që katër vite, dhe me TMK-në, në këtë cilësi ...dhe kemi arritur që të kontribuojmë në inkorporimin e barazisë gjinore në këto dy institucione. Me përkrahjen e UNIFEM-it, TMK ka themeluar Bordin për Barazi Gjinore dhe ka zhvilluar rregulloren për funksionimin e këtij Bordi. Një varg trajnimesh janë ofruar për ngritjen e kapaciteteve si të Bordit ashtu edhe të oficierve të lartë të TMK-së. Projekti u përmbyll me një vizitë studimore në Suedi. Kemi informacione që Bordi për Barazi Gjinore do të bartet në FSK.[54] Ishte kjo një përvojë fantastike dhe e veçantë për mua, TMK-ja ishte një ndër partneret më të organizuar dhe të përkushtuar që ne kemi bashkëpunuar ndonjëherë. Me këtë rast do të falënderoj të gjithë Bordin për punë të shkëlqyeshme, sidomos Hadije Binakun e cila ka qenë promotore e kësaj iniciative, thekson Flora Macula.

Në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarin për barazi gjinore të policisë dhe Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim/ sektorit të trajnimit, pas një serie te trajnimeve për trajner në fushën e barazisë gjinore dhe sigurisë u përgatiten dy module për trajnime të cilat janë pjesë e trajnimeve në këtë qendër.

UNIFEM-i, gjithashtu, përkrahë Rrjetin e Grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane përmes Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ). Njëherit, UNIFEM-i ndihmoi QKSGJ-në në përgatitjen e Raportit "nën hije" për zbatimin e Konventës për Eliminimin të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (CEDAW) në Kosovë. [55]

Me qëllim që të kontribuojë në përpjekjet e integrimit të komuniteti serb në shoqërinë kosovare, UNIFEM-i, në partneritet të ngushtë me Shoqatën e Juristeve NORMA, Lobin Rajonal të Grave për Paqe, siguri dhe drejtësi, dhe me gratë parlamentare, ka përkrahur një seri veprimesh siç janë: dialogun ndëretnik mes OJQ-ve të grave serbe dhe shqiptare, dhe ka përkrahur më shumë se 12 OJQ të grave serbe në përpjekjet e tyre në fushën e të drejtave të grave, rrjetëzimit dhe dialogut ndëretnik. Vlen të përmendet përkrahja e themelimit të Rrjetit të Grave Serbe i cili përkrahet nga UNIFEM-i dhe nga Rrjeti i Grave të Kosovës. Në aktivitetet për dialogun ndëretnik janë involvue edhe mekanizmat rajonal që janë themeluar me përkrahjen e

[54] Intervistë me Flora Macula, shkurt 2009.
[55] Intervistë me Flora Macula, shkurt 2009.

UNIFEM-it siç janë; Koalicioni i Grave për Paqe (i përbërë nga RRGGK dhe Gratë në të Zeza nga Serbia), Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi.

Për të përforcuar përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe dialogut ndëretnik, UNIFEM-i me Lobin Rajonal të Grave organizoi konferencë në Prishtinë (2008), ku morën pjesë gratë si nga politika ashtu edhe nga shoqëria civile nga të gjitha shtetet e rajonit. Ky aktivitet u përshëndet edhe nga Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu. Dita e tretë e konferencës u përmbyll me vizitën në dy vende ku jetojnë pjesëtarët e minoritetit serb, ku u zhvilluan takime me gratë serbe nga rajoni i Prishtinës. Nevojat dhe brengat e grave serbe u morën parasysh dhe do të integrohen në aktivitetet e mëtutjeshme.

1.10 Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

UNFPA në Kosovë është themeluar në korrik të vitit 1999. Mandati i tij ishte të "restaurojë kushtet themelore dhe të sigurta për gratë dhe foshnjat e porsalindura"[56] si pjesë e reagimit fillestar emergjent. Megjithatë, në vitin 2000, UNFPA mori mandat që të jetë "agjenci udhëheqëse për shëndetin reproduktiv në Kosovë". UNFPA punon për përmirësimin e qasjes ndaj shërbimeve të shëndetit reproduktiv dhe ndërtimit të kapaciteteve institucionale për të mbledhur, analizuar dhe shfrytëzuar të dhënat nga hulumtimet e popullatës.

Duke raportuar mbi aktivitetet e UNFPA, ish kreu i UNFPA Karl Kulessa theksonte: ...Në fillim ishim të përqendruar më shumë në rehabilitimin dhe përkrahjen emergjente për gratë dhe burrat... Ne rehabilituam dy pavijone të maternitetit në regjione. Jemi posaçërisht krenar me punën që kemi bërë në Prizren ngase ai është bërë pavijoni më i rëndësishëm i maternitetit. Kjo nuk është e tëra meritë e jona, ngase është e jashtëzakonshme mënyra si e kanë mirëmbajtur atë... nuk dallon nga cilido spital tjetër në Evropë, jo vetëm që është teknikisht i përgatitur por gjithashtu menaxhohet shumë mirë. Tani jemi duke u fokusuar në shërbime cilësore të shëndetit reproduktiv të cilat duhet të ofrohen në Kosovë. Në përgjithësi, ne punojmë si organizatë e OKB-së përmes Qeverisë, ngase kështu qëndron në mandatin tonë, ndërsa partneri ynë primar është Ministria e Shëndetësisë... Një çështje tjetër, me të cilën angazhohemi, është mënyra e menaxhimit të aborteve... Kryesisht ne përqendrohemi në shëndetin e grave, por edhe burrat duhet involvuar sepse janë pjesë e shoqërisë dhe puna jonë kërkon partneritet. Ne promovojmë kontraceptivët (dhe këtë e bëjmë) përmes OJQ-ve lokale.

UNFPA vlerëson se ka qenë "shumë aktive në promovimin e projektligjit dhe ligjit për shtatzëni në një mënyrë që mbron interesat e grave". Kreu i programit na sqaroi se përderisa vendimmarrësit "kanë dëshirë të flasin lidhur me politikat e mëdha siç janë mundësitë e barabarta, ne fokusohemi në diçka më themelore, siç është planifikimi familjar, që ka shkaktuar revolucion në Evropën Perëndimore, që nga prodhimi i barërave kontraceptive në vitet e 60-ta. Që atëherë gratë munden, më lehtë, të angazhohen në punësim dhe të negociojnë për ndryshime në marrëdhëniet seksuale.[57]

Qasja në shërbimet shëndetësore, edhe pse ekzistojnë institucionet shëndetësore është ende e zbehtë, thekson Visare Mujku-Nimani, sepse prapë kthehemi tek problemet ekonomike, ku edhe për të vizituar mjekun duhet të merret leja prej burrave të tyre kjo e kufizon qasjen e saj për të aplikuar këto shërbime... UNFPA vazhdimisht punon me komponent të barazisë gjinore, edhe pse jemi të fokusuar në promovimin e barazisë gjinore, ende ne si shoqëri priremi drejt asaj që

[56] Shih http://www.unfpakos.org/
[57] Intervista me Karl Kulessa, nëntor 2007

të kemi një djalë në familje, nganjëherë në shtatëzani të hershme shikohet gjinia dhe nëse nuk është i gjinisë mashkullore përfundon edhe me abort.[58]

1.11 Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)

UNICEF punon në Kosovë që nga viti 1999. Pas fazës emergjente, ka iniciuar një program të ri të bashkëpunimit me institucionet vendore, në vitin 2005. Fokusi kryesor i UNICEF-it është të "ngritë njohurinë dhe vetëdijen në nivel qeveritar mbi të drejtat e njeriut në përgjithësi, dhe të përmirësojë shërbimet që u ofrohen fëmijëve dhe grave në veçanti."[59]

UNICEF-i punon në partneritet me grupet e shoqërisë civile, përfshirë grupet rinore dhe rrjetet e grave. Ajo gjithashtu ndërlidhet me Zyrën e Kryeministrit, Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Departamentin e Drejtësisë, dhe Institucionin e Ombudspersonit.

Mandati i UNICEF-it në Kosovë është të përkrahë qeverinë e Kosovës në përpjekjet e saj që të krijojë një shoqëri tolerante që respekton të drejtat njerëzore, që respekton shumëllojshmërinë, dhe tejkalon qëndrimet aktuale që çojnë drejt përjashtimit social, margjinalizimit dhe diskriminimit dhe që shpreh zërat e atyre që bartin brenga.[60]

Respodenti nga UNICEF-i theksoi se, "për UNICEF-in, të drejtat e grave janë të rëndësisë primare. Ne konsiderojmë se nuk është e mundshme që të realizohen të drejtat e fëmijëve pa të drejtat e grave. Ne e dimë se gratë janë një faktor i rëndësishëm për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në një shoqëri të caktuar."[61] Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe CEDAW paraqesin bazën e ligjeve ndërkombëtare për punën e UNICEF-it në Kosovë.

1.12 Zyra e Komisarit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR)

UNHCR ka funksionuar në Kosovë që nga viti 1999 dhe ka në mandat adresimin e mbrojtjes, strehimit, ndihmës emergjente, arsimimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat e zhvendosur dhe refugjatët. UNHCR është në fakt një trup koordinues që operon sipas kërkesave të qeverive apo nën autoritetin e OKB-së në çështjet që kanë bëjnë me kthimin apo zhvendosjen e refugjatëve.[62] UNHCR ka punuar për së afërmi me Zyrën për Kthim dhe Komunitete të UNMIK-ut, dhe institucionet kosovare.

Lidhjet eksplicite me Rezolutën 1325 mungojnë në punën publike të UNHCR-së në Kosovë, përkundër relevancës që kjo rezolutë ka për punën që e kryen, siç parashihet me Preambulën e Rezolutës 1325, dhe nenet 8, 9, 10, 11 dhe 12. ...Ne duhet të kemi regjistrim të grave – ne e pamë çka ngjau në terren gjatë punës sonë, burrat shkojnë e regjistrohen edhe për gratë e tyre si kryefamiljarë. Komisari i lartë ... kërkon që të gjithë njerëzit e në veçanti gratë të regjistrohen me emrat e tyre ashtu që të kenë qasje ndaj ndihmës. Ata nuk mund të përfitojnë asistencë përmes përfaqësuesve të tyre mashkullorë. Ne i kushtojmë kujdes të posaçëm "personave me brenga", posaçërisht grave të cilat janë viktima të dhunës në baza gjinore, dhe gjithashtu të sigurohemi që gratë të përfshihen në shpërndarjen e ushqimit dhe që ushqimi t'i ofrohet drejtpërdrejt femrave e jo të afërmve të tyre të gjinisë mashkullore. Shpesh ndodh që mashkulli

[58] Intervista me Visare Mujku-Nimani, shkurt 2009.
[59] Shih http://www.unicef.org/kosovo/Overviw.html
[60] Po aty.
[61] Intervista me Arbena Kuriun, nëntor 2007.
[62] Shih Gil Loescher. UNHCR dhe Politika Botërore: Një rrugë e rrezikshme, Oxford University Press. 2002.

të merr ushqimin për tërë familjen dhe ta shes atë për para, kështu që familja mbetet pa ushqim. Një gjë tjetër që kërkohet nga UNHCR që tu sigurojnë grave qasje ndaj materialeve sanitare që janë specifike për femra; këto janë pika speciale të veprimit të cilave u referohet si "mbrojtje gjinore"...[63]

Siç thekson Shpend Halili, "UNHCR aktualisht fokus primar, që pjesërisht ndërlidhet edhe me Rezolutën 1325, ka avokimin për mbrojtje juridike për personat nën kujdes. Duke mos lënë anash edhe grupe të tjera, UNHCR ka një fokus të veçantë për personat e zhvendosur brenda vendit, të kthyerit në Kosovë, refugjatët, azil-kërkuesit, personat që janë në rrezik të mbetjes pa shtetësi, dhe grupe të tjera të veçanta sociale. Në kuadër të aktiviteteve aktuale të UNHCR-së, që lidhen me prioritetet; gratë dhe çështjet gjinore, paraqet një aspekt me fokus të veçantë të angazhimit. Veç kësaj, katër prioritete të tjera të punës janë edhe grupet: fëmijët dhe adoleshentët; të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara; mbrojtja e ambientit dhe ruajtja; dhe luftimi i HIV/ AIDS."[64]

Komuniteti ndërkombëtar qe është në Kosovë, sipas Pauline Menthonex, ka një prapavijë përparimtare kur është ne pyetje çështja gjinore për atë arsye tash do të kemi edhe ekspertin tonë për çështje gjinore, mirëpo ju nuk duhet te pritni qe çdo pjesëtar i komunitetit ndërkombëtar qe punon në Kosovë të paktën të dijë se çka do të thotë barazi gjinore ose të drejtat njerëzore.[65]

[63] Intervista me Tamara Jerman dhe Vjollca Gjonbalaj, nëntor 2007.
[64] Intervista me Shpend Halili, shkurt 2009.
[65] Intervistë me Pauline Menthonex, shkurt 2009.

2. Institucionet dhe Mekanizmat Vendore Përgjegjëse për Fuqizimin dhe Promovimin e të Drejtave të Grave

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 2008 ka krijuar Institucionet e Republikës duke u bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, duke përfshirë Kuvendin, Presidentin, Qeverinë, Gjykatat dhe organet tjera gjegjëse. Në këtë raport kemi marrë në shqyrtim vetëm Institucionet dhe mekanizmat kryesore vendore përgjegjëse për fuqizimin dhe promovimin e të drejtave të grave në Republikën e Kosovës.

2.1 Kuvendi i Republikës së Kosovës

Sipas dispozitave kushtetuese, është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.[66] Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.[67] Kuvendi[68] (Legjislatura e tretë) është themeluar pas zgjedhjeve të përgjithshme të nëntorit 2007, të cilat janë mbajtur në një frymë fer dhe efektive. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka fituar 34% të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë 23% të votave, Aleanca Kosova e Re (AKR) 12% dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) kanë fituar nga 10%, Partia Reformiste (ORA) 4% dhe Partia e Drejtësisë (PD) 2%. Të trembëdhjetë partitë minoritare kanë fituar gjithsej 5% të votave.[69]

Ndërsa Neni 71.2. i Kushtetutës përcakton: Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektojë parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuara në pajtim me parimet ndërkombëtare.[70] Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit. Po ashtu, Kuvendi, mund të caktojë komisione për një çështje të veçantë. Janë dy Komisione të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilët mund dhe duhet të promovojnë dhe të ndihmojnë në realizimin e barazisë gjinore, në këtë drejtim edhe zbatimin e Rezolutës 1325. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri. Sidomos, duhet marre parasysh kompetencat e Komisionit për punë të brendshme dhe siguri, i cili ka përgjegjësi në angazhimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e politikave dhe strategjive për sigurinë e brendshme. Po ashtu, ky Komision ka përgjegjësi për Inicimin dhe miratimin e legjislacionit në fushat e veprimit të tij, pastaj për mbikëqyrjen, ngritjen dhe strukturimin e arkitekturës së sigurisë në Kosovë, në veçanti përfundimin e mandatit të TMK-së, ngritjen e Forcës së Sigurisë dhe Shërbimit Inteligjent të Kosovës, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të standardeve të sigurisë së përgjithshme duke përfshirë edhe atë të

---

[66] Funksioni i Kuvendit rregullohet me Kapitullin IV (Kuvendi i Republikës së Kosovës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

[67] Neni 64 (Struktura e Kuvendit)-Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (Ekzistojnë 120 vende në Kuvendin e Kosovës dhe ato ndahen sipas formulës: 100 vende për të gjitha subjektet politike në Kosovë, 10 vende të ruajtura për përfaqësuesit e komunitetit serb, 10 vende të ruajtura për përfaqësuesit e komuniteteve tjera, 4 vende për komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve (RAE), 3 vende për komunitetin boshnjak, 2 vende për komunitetin turk dhe 1 vend për komunitetin goran.

[68] Shih http://www.kuvendikosoves.org/ Periudha e parë Legjislative përfshinte kohën prej: 17.11.2001 deri më 23.11.2004, ndërsa Periudha e dytë Legjislative përfshinte kohën prej: 23.11.2004 deri me 12.12.2007.

[69] Shih Ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës http://www.kuvendikosoves.org/.
Shih: Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 9.

[70] Neni 71 (Kualifikimet dhe Barazia Gjinore) -Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

minoriteteve, inicimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, mbikëqyrë menaxhimin dhe dhënien e dokumentacionit personal dhe të dokumentacionit të udhëtimit si dhe do të monitorojë bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Komisioni për punë të brendshme dhe siguri është përgjegjës për shkëmbimin e përvojave me shtetet tjera dhe zhvillimin e programeve trajnuese me shtetet tjera në fushën e sigurisë. Në këtë drejtim, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri duhet të përkujdeset për Përfshirjen e perspektivës gjinore dhe trajnimeve gjegjëse për ndërgjegjësimin e personelit policor dhe ushtarak në Kosovë. [71]

2.2 Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës

Sipas dispozitave Kushtetuese, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës.[72] Ndërsa, sipas Ligjit për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka misionin në vijim: ka rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e tij për stabilitetin rajonal, rekomandon politika dhe strategji për sigurinë dhe duhet të ofrojë informata dhe vlerësime të gjendjes së sigurisë në Kosovë, që t'i mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me çështjet e sigurisë. [73]

Një nga kompetencat e Këshillit të Sigurisë së Kosovës,[74] është përgatitja dhe shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës, e cila miratohet nga Qeveria dhe i dorëzohet Kuvendit të Kosovës për miratim përfundimtar. Në këtë drejtim, duke marrë parasysh që KSK është në formim e sipër, me rastin e përgatitjes së Strategjisë së Sigurisë së Kosovës përfshirja e çështjeve gjinore dhe referimi ne Rezolutën 1325 janë një domosdoshmëri e cila do të kontribuonte në përmirësimin e pozitës së femrave në sektorin e sigurisë.

2.3 Qeveria e Republikës së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës[75] është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.[76] Ligji për Barazi Gjinore ne Nenin 4.7

---

[71] Nga 13 Komisionet e Kuvendit te Republikës se Kosovës 2 (dy) prej tyre kryesohen nga femrat. Shih http://www.kuvendikosoves.org/ .

[72] Neni 127 (Këshilli i Sigurisë i Kosovës), Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

[73] Shih Neni 1, Ligji nr. 03/l-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 26 / 2 qershor 2008. Shih Po aty Nenin 3.1 Këshilli i Sigurisë së Kosovës përbëhet prej anëtarëve të mëposhtëm në cilësinë e anëtarëve të përhershëm me autoritet ekzekutiv: a) Kryeministri; b) Zëvendës Kryeministri(at); c) Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ose në mungesë të tij apo saj, Zëvendës Ministri(at); d) Ministri i Punëve të Jashtme, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri; e) Ministri i Punëve të Brendshme, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri; f) Ministri i Drejtësisë, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri; g) Ministri i Ekonomisë dhe Financave, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri; h) Ministri për Kthim dhe Komunitete, ose në mungesë të tij apo saj Zëvendës Ministri.

[74] Shih Neni 2, Ligji nr. 03/l-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 26 / 2 qershor 2008.

[75] Kompetencat e Qeverisë rregullohen me Kapitullin VI (Qeveria e Republikës së Kosovës)të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Më 9 janar 2008 është formuar koalicioni qeveritar mes Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës me kryeministër Hashim Thaçin. Qeveria përbehet nga Kryeministri dy zëvendëskryeministra dhe 17 ministra.

[76] Neni 4.4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

përcakton: “Detyrë dhe përgjegjësi e qeverisë dhe ministrive në fushën e barazisë gjinore është edhe promovimi dhe garantimi i të drejtave të barabarta gjinore”.

Në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës (2008 – 201), sa i përket barazisë gjinore është përcaktuar: Duke u nisur nga përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin institucional të perspektivës gjinore, duke u nisur nga përcaktimi për krijimin dhe implementimin e legjislacionit, politikave, mekanizmave dhe masave për avancimin e pozitës së gruas dhe, duke u nisur nga implementimi i tërë këtij procesi në të gjitha fushat e jetës politike dhe shoqërore, duhet të promovohet barazia gjinore, si parakusht për funksionimin e institucioneve demokratike dhe si kusht për proceset integruese evropiane dhe tejatlantike.

2.4 Komunat

Në Republikën e Kosovës, njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë komunat. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.[77] Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.[78]

Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale.[79] Ndërsa, sipas Ligjit për kufijtë administrativ të komunave ekzistojnë tridhjetë e tetë komuna. Autoritetet lokale funksionojnë brenda Asociacionit të Komunave, sipas nenit 10 të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale të Këshillit të Evropës.[80] Sipas përkufizimit ligjor, të gjitha organet e komunës duhet të kujdesen që qytetarët e komunës t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim gjinie, apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.[81] Ndërsa, në nenin 4.14., të LBGJ-së, përcaktohet se organet e qeverisjes lokale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe për meshkuj.

Në nivelin komunal, pozitat e Zyrtarëve Komunal për Çështje Gjinore konsideroheshin nga disa të intervistuar si ilustrim i miratimit të limituar të mekanizmave për barazi gjinore dhe i mungesës së përgjithshme të vetëdijes lidhur me çështjet gjinore në nivel komunal. Përkufizimet financiare kufizojnë aktivitetin në këtë sferë dhe atë jo vetëm të zyrtarëve komunal për barazi gjinore por edhe përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse në nivel komunal.

---

[77] Neni 124 -Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

[78] Neni 4 Ligji nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 28 / 4 qershor 2008

[79] Ligji nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 28 / 4 qershor 2008

[80] Ligji nr. 03/l-041 për kufijtë administrativ të komunave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 26 / 2 qershor 2008. Me këtë ligj rregullohet, organizimi territorial i vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, themelohen komunat e reja, përcaktohet territori i komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, përcaktohen kufijtë administrative komunal, emrat dhe selitë e komunave të reja, vendosen rregullimet kalimtare në mes të komunave ekzistuese dhe komunave të reja të themeluara me këtë ligj, si dhe definohen procedurat për ndryshimin e kufijve administrative të komunave.

[81] Shih Neni 4.2. Ligji nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 28 / 4 qershor 2008

2.5 Agjencia për Barazi Gjinore

Fillimisht, Zyra për Barazi Gjinore, është themeluar, nga Qeveria e Kosovës, më 1 shkurt 2005, në përputhshmëri me nenin 5.1 të Ligjit për barazi gjinore[82], në të cilin thuhet se Qeveria e Kosovës themelon Zyrën për Barazi Gjinore si institucion të veçantë qeveritar. Më 10 maj 2005 (me Vendimin nr. 3/146), është aprovuar Rregullorja e Qeverisë së Kosovës nr. 2/2005 për themelimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës për Barazi Gjinore është përcaktuar mënyra e punës dhe organizimi i brendshëm i kësaj zyreje.

Ndërsa, me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/3 themelohet Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) si agjenci ekzekutive që në aspektin organizativ do t'i bashkëngjitet Zyrës së Kryeministrit. [83]Që nga kjo kohë Zyra për barazi Gjinore do të funksionojë me emërtimin: Agjencia për Barazi Gjinore.[84]

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), drejtohet nga kryeshefi ekzekutiv[85] dhe ka tri drejtori (divizione): Drejtorinë për legjislacion, Drejtorinë për bashkëpunim dhe Drejtorinë për monitorim dhe raportim. ABGJ financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe sipas rastit mund të plotësohet me mjete të tjera financiare. Agjencia është përgjegjëse për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore si faktor i rëndësishëm i funksionimit të institucioneve demokratike. Kjo nuk ndikon në përgjegjësitë dhe mandatet sektoriale të ministrive individuale për promovimin e barazisë gjinore.[86]

Gjatë intervistës u kuptua se ABGJ përballet me probleme të shumta, përkundër qartësisë sa i përket objektivave të tyre operative.Pengesa e parë është numri i vogël i punonjësve të kësaj zyre... ne jemi vetëm tetë zyrtarë, përfshirë këtu edhe menaxherin. Ne përballemi me mungesë të kapaciteteve dhe mungesë të trajnimeve specifike (për shembull për Rezolutën 1325), theksojnë respodentët.

Shqipe Krasniqi, u.d. Kryeshefe Ekzekutive e ABGJ-së, thekson: "…Kemi bërë vitin e kaluar monitorimin e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore ku 87% e njerëzve e dijnë që ekziston Ligji për barazi gjinore po ashtu e dijnë që ekziston Agjencia për Barazi Gjinore… ABGJ duhet të trasojë rrugën për gratë dhe burrat drejt barazisë gjinore. [87]

Disa nga të intervistuarit komentonin se të gjitha iniciativat që kanë të bëjnë me Rezolutën 1325 mund të dështojnë, përkundër faktit që ABGJ i ka "duart e lira të zbatojë çkado që ka të bëjë me barazinë gjinore."

Sipas, Pauline Menthonex, "hapat e mëdhenj, si krijimi i ABGJ-së, janë realizuar d.m.th kur është në pyetje vullneti politik, dhe mendoj se është e vendosur në një vend strategjik siç është Zyra e Kryeministrit, mendoj se ABGJ-ja ka nevojë për një numër më të madh të punonjësve dhe buxhet me të lartë sepse UNDP përkrah financiarisht shumë aktivitete të ABGJ-së", Virgjina

[82] Shih Ligji nr. 2004/2 për barazi gjinore, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: viti II / nr.14 / 1 korrik 2007

[83] Urdhëresë Administrative e UNMIK-ut nr. 2007/3 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes

[84] Ueb faqja e ABGJ http://www.ks-gov.net/abgj

[85] Duhet cekur se që nga themelimi i Zyrës për Barazi Gjinore e deri me tani gjithmonë kjo zyrë/agjenci është udhëhequr nga ushtruese e detyrës.

[86] Shih Neni 2, Urdhëresë Administrative e UNMIK-ut nr. 2007/3 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes

[87] Intervistë me Shqipe Krasniqin, shkurt 2009.

Dumnica, mendon se mungon një bashkëpunim mes zyrtareve të ABGJ-së dhe zyrtareve për barazi gjinore në komunat e tjera sepse ju mungojnë pikat e referimit-qasjes ndaj një problemi që mendoj se është problemi te koordinimi i punës me zyrat tjera që janë themeluar nga ABGJ-ja.[88]

Siç përcaktohet në Ligjin për Barazi Gjinore, Zyra për Barazi Gjinore (lexo ABGJ) gjatë kryerjes së detyrave të saj lidhur me çështjet gjinore i bashkërendon aktivitetet e saj me Zyrën këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, për të drejta të njeriut, për mundësi të barabarta dhe gjini.[89]

2.6 Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (Zyra për Qeverisje të Mirë-ZQM)

ZQM funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që nga muaji mars i vitit 2002 dhe ka kompetenca të mbikëqyr dhe këshillon ministrat në sferat e qeverisjes së mirë, në të drejtat e njeriut, në mundësitë e barabarta dhe në çështjet gjinore. [90]

Zyra për Qeverisje të Mirë shërben si sekretariat dhe trup koordinues për mekanizma të ndryshëm qeveritar, si: Komitetin ndërministror për të drejtat e fëmijëve; Këshillin Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara; Grupin punues ndërministror kundër-korrupsionit si dhe udhëheq koordinimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në të gjitha ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka arritur të krijojë një rrjet të gjerë të bashkëpunimit me aktorët dhe faktorët më të rëndësishëm vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e të drejtave të njeriut si me OSBE, UNDP, UNICEF, UNIFEM, IOM, KFOS, OHCHR, Këshillin e Evropës etj. të cilat kane përkrahur dhe vazhdojnë t'i përkrahin iniciativat dhe projektet e Qeverisë së Kosovës, në forma të ndryshme, përfshirë edhe vendosjen e stafit të tyre në kuadër të ZQM, duke ofruar në këtë mënyrë ndihmesë dhe konsulencë shumë të rëndësishme për institucionet e Qeverisë së Kosovës.

2.7 Këshilli Ndërministror për Barazi Gjinore

Neni 4.9. i LBGJ-së përcakton: Qeveria formon Këshillin ndërministror,[91] anëtarë të të cilit janë Zyrtarët për Barazi Gjinore të ministrive. Me vendim nr.05/157 të Qeverisë së Kosovës aprovohet Rregullorja nr.01/2006 për Themelimin Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Ndërministror për Barazi Gjinore. Me këtë rregullore përcaktohen kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Ndërministror për Barazi Gjinore. Këshillin Ndërministror për Barazi Gjinore, e përbëjnë të gjitha zyrtaret për barazi gjinore në ministritë e Qeverisë së Kosovës dhe zyrtari për barazi gjinore në Zyrën për Qeverisje të Mirë të Kryeministrit.

Kryeshefi Ekzekutiv i Agjensionit për Barazi Gjinore udhëheqë me Këshillin me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe bashkërenditjes në fushën e barazisë gjinore. Sidoqoftë,

---

[88] Intervistë me Pauline Menthonex dhe Virgjina Dumnica shkurt 2009.

[89] Shih Neni 5.2 (o) Ligji nr. 2004/2 për barazi gjinore, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti II / nr.14 / 1 korrik 2007.

[90] Shtojca I/E (Kabineti i Kryeministrit) Rregullore e UNMIK-ut Nr.2001/19 (e ndryshuar), e datës 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

[91] Këshillit Ndërministror për Barazi Gjinore i ka parapri Grupi ndërministror për arritjen e barazisë gjinore i themeluar nga Qeveria në prill të vitit 2003 me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të institucioneve për çështje të barazisë gjinore dhe përfshinte përfaqësues të ZQM-së, të të gjitha ministrive, OJQ-ve dhe përfaqësuesve të agjencive që punojnë në sferën e çështjeve gjinore.

rezultatet e kësaj nuk janë të dukshme. Aktualisht, gratë nuk kanë arritur nivelet më të larta të vendimmarrjes qeveritare dhe as në negociatat për statusin final nuk ka pasur gra të pranishme. ZQM ka bashkëpunuar për së afërmi me RRGGK dhe UNIFEM-in lidhur me Planin Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore (PKV), por nuk i është dhënë kujdes i shtuar Rezolutës 1325, ndërsa arsyet që jepen zakonisht e identifikojnë mungesën e vëmendjes së UNMIK-ut në këtë aspekt.

2.8 Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK)

Sipas dispozitave kushtetuese, Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.[92] Në këtë drejtim FSK juridikisht në të ardhmen e afërt mund të dërgojë personelin e saj ushtarak dhe civil në operacionet paqeruajtëse dhe të ndërtimit të paqes.

Duke marre parasysh që, Rezoluta 1325 thekson rëndësinë e përfshirjes së perspektivave gjinore në operacionet paqeruajtëse dhe të ndërtimit të paqes, duhet pasur parasysh edhe obligimin e Rezolutës 1325 që personeli ushtarak dhe civil që do të dërgohet në këto misione të jetë i trajnuar mbi këto çështje nga vetë shtetet anëtare.

FSK është force e re e cila është në formim e sipër, ku gjatë fund vitit 2008 ka filluar procesi i krijimit dhe rekrutimit të pjesëtarëve të kësaj force. Procesi i shpërbërjes[93] së Trupave Mbrojtëse të Kosovës[94] dhe themelimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i paraparë me Kushtetutë, ka filluar në muajin qershor 2008. FSK duhet të përbëhet nga një personel prej diku 2,500 vetash të armatosur lehtë, detyra e parë e të cilëve do të jetë përgjigja ndaj krizave, çmontim i eksplozivit dhe mbrojtja civile. Procesi realizohet nën kontrollin e NATO-s dhe në koordinim të ngushtë me faktorët tjerë ndërkombëtarë.

---

[92] Neni 126 (Forca e Sigurisë e Kosovës)- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
Neni 2, I Ligjit nr. 03/l-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përcakton: 2.1 Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të autorizuar të shërbejnë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe dërgohen jashtë vendit në operacione vetëm kur t'u jepet mandati nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe në marrëveshje me shtetin pranues, në bazë të ftesës së një organizate ndërkombëtare në të cilën Republika e Kosovës është anëtare ose aspiron të jetë, apo në bazë të një Rezolute të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

[93] Sipas Neni 154 të Kushtetutës është përcaktuar: Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

[94] Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) u krijuan me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut Nr 1999/8 (20 shtator 1999) për themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Trupat Mbrojtëse të Kosovës vepronin nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. KFOR-i jep udhëzime për funksionimin e përditshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në përputhje me politikën dhe përparësitë e përcaktuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Detyrat e TMK-së të përcaktuara me Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/3 për ndryshimin e Rregullores nr. 1999/8 mbi themelimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës ishin: Të ofrojë shërbime të reagimit ndaj katastrofave; Të kryejë aktivitete të kërkimit dhe shpëtimit; Të ofrojë kapacitetet e veta në dhënien e ndihmës humanitare në vende të izoluara; Të ndihmojë në çminim; Të kontribuojë në rindërtimin e infrastrukturës dhe në rindërtimet për komunitetet, duke përfshirë monitorimin e shtëpive të rindërtuara dhe të pabanuara në pronësi të komuniteteve pakicë dhe në detyrat e tjera humanitare, duke marrë parasysh nenin 1.2 (Trupat Mbrojtëse të Kosovës nuk do të kenë kurrfarë roli në zbatimin e ligjit apo në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike) dhe Të kryejë detyra ceremoniale në kuadër të fushëveprimit të saj si agjenci për shërbime emergjente civile në përputhje me udhëzimet e koordinatorit të TMK-së dhe të KFOR-it. Rreth 2 përqind të pjesëtarëve të TMK-së ishin të gjinisë femërore.

Me Ligjin për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, themelohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka kontroll dhe administrim të përgjithshëm mbi Forcën e Sigurisë të Kosovës, duke përfshirë të gjitha fuqitë që bien mbi Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës.[95]

Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës është i aplikueshëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët e saj (aktiv dhe rezervë) të uniformuar, pjesëtarët civilë dhe rekrutët e saj. Sipas përcaktimin në këtë ligj: Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas këtij ligji, është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Forca e Sigurisë së Kosovës do të jetë e dizajnuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksionet e sigurisë që nuk i përkasin policisë apo organizatave tjera për zbatim të ligjit, të cilat funksione do të autorizohen përmes një procesi monitorues sipas standardeve të përcaktuara, i cili do të vendoset nga Prania Ushtarake Ndërkombëtare, në bashkërendim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar.[96]

2.9 Policia e Kosovës[97]

Fillimisht Policia e Kosovës ka vepruar me emërtimin Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), i cili është themeluar nën mandat të OSBE-së (Misioni në Kosovë) për zhvillimin e një institucioni efektiv policor për një Kosovë demokratike. Mandati i UNMIK-ut, sipas Rezolutës 1244, përfshinte edhe detyrën e krijimit të një force të re policore.

SHPK ishte nën komandën e UNMIK-ut, komisari i policisë së të cilës i komandonte edhe policinë ndërkombëtare (CIVPOL) dhe SHPK-në. SHPK ka arritur madhësinë e paraparë prej mbi 7000 pjesëtarësh në vitin 2008. Rreth 85 përqind të zyrtarëve të SHPK-së janë shqiptarë, 15 përqind i përkasin etnicitetit serb dhe etniciteteve tjera. Rreth 15 përqind të pjesëtarëve të SHPK-së janë të gjinisë femërore. [98]

Me anë te Ligjit nr. 03/l-035 për policinë[99], të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datën 20.02.2008 themelohet Policia e Republikës së Kosovës si shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB)[100] dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të përgjithshëm të Policisë, i cili është emëruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës me datë 10.12.2008.[101]

---

[95] Shih Neni 1 dhe Nenin 2 të Ligjit nr. 03/l-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti iii / nr. 26 / 2 qershor 2008

[96] Shih neni 9, Ligji nr. 03/l-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 27 / 3 qershor 2008

[97] http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?idwww2

[98] Më 6 shtator të vitit 1999 Misioni i OSBE-së ne Kosovë, ne pajtim me Rezolutën 1244, ka hapur Shkollën e Policisë dhe ka filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Shërbimit Policor të Kosovës. Shih http://www.kosovopolice.com/historiku.html

[99] Ligji nr. 03/l-035 për policinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 28 / 4 qershor 2008

[100] Ueb faqja e Ministrisë së Punëve të Brendshme: http://www.mpb-ks.org/

[101] Ueb faqja e Policisë së Kosovës http://www.kosovopolice.com/
Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në mbështetje të nenit 94.6 dhe 128.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 37 të Ligjit për Policinë dhe në përputhje me rekomandimin e Ministrit të Punëve të Brendshme për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës mori vendimin për emërimin e Z. Sheremet Ahmeti Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës.

Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.[102]

2.10 Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës

Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës është Agjension Ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, i pavarur nga Policia e Republikës së Kosovës, dhe ka autorizim të zhvillojë inspektime ndaj Policisë së Republikës së Kosovës, raportojë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve dhe të hetojë akuzat për shkelje të rënda disiplinore ndaj të gjithë punonjësve të policisë pa dallim grade dhe të gjitha shkeljet e tjera ndaj pozitave të larta ekzekutive, dhe t'i rekomandojë Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici se çfarë mase disiplinore, nëse është e nevojshme, duhet të shqiptohet.[103]

2.11 Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)[104]

SHKK është shërbim i ri, i themeluar pas luftës ne Kosovë, i cili fillimisht administrohej nga UNMIK-u-Divizioni i Menaxhimit Penal (Shtylla I, Departamenti i Drejtësisë dhe Policisë). Që nga themelimi i tij në vitin 1999 e deri në vitin 2001, viti i cili shënoi fillimin e funksionimit të mirëfilltë të SHKK-së, janë krijuar pesë qendra të paraburgimit, një qendër korrektuese dhe një burg[105], duke punësuar kështu , (sipas gjendjes se muajit qershor 2008), "1538 persona, prej të cilëve meshkuj ishin 1276 persona ose 82, 96%, ndërsa femra ishin 262 ose 17.04%",[106] të cilët janë rekrutuar dhe të cilëve u është ofruar trajnim bazik, ndërsa është krijuar edhe baza ligjore që i referohet ekzekutimit të sanksioneve penale dhe trajtimit të pozitës së personave të dënuar dhe të paraburgosur. Nga viti 2006 SHKK e ushtron veprimtarinë e tij ne kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe në këtë vit është emëruar edhe Komisionari i Shërbimit Korrektues të Kosovës.[107]

---

[102] Neni 128, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (15 qershor 2008). Ndërsa, Neni 10 i Ligjit nr. 03/l-035 për policinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 28 / 4 qershor 2008, përcakton detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë, të cilat janë: a) ta mbrojë jetën, sigurinë dhe pronën e të gjithë personave; b) t'i mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave; c) ta parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike; d) t'i parandalojë dhe t'i zbulojë veprat penale; e) t'i hetojë veprat penale; f) të ofrojë mbikëqyrje dhe kontroll për sigurinë në komunikacion; g) të ofrojë mbikëqyrje dhe kontroll të kufijve; h) të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe i) të kryejë detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi;

[103] Ligji nr. 03/l-036 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti III / nr. 26 / 2 qershor 2008, Ueb faqja e Inspektoratin Policor të Kosovës http://www.ks-gov.net/ipk/

[104] Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it-Njëri prej synimeve kryesore të komponentit të drejtësisë së EULEX-it është ta përmirësojë dhe përforcojë gjyqësinë e Kosovës për ta bërë atë plotësisht shumë-etnike, të paanshme, pa ndërhyrje politike dhe të jetë e aftë për të mbajtur gjykime të drejta sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira evropiane. Komponenti i drejtësisë përmban rreth 10% të personelit të përgjithshëm të EULEX-it, apo 300 njerëz. Prej tyre, rreth 70 punojnë në sistemin e burgjeve dhe janë më shumë se 40 gjyqtarë dhe rreth 20 prokurorë.

[105] Shërbimi Korrektues i Kosovës, vepron ne kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka nën administrim institucionet: Burgun e Dubravës, Qendrën Korrektuese në Lipjan dhe Qendrat e paraburgimit në: Prizren, Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Mitrovicë. http://www.md-ks.org/?pagewww1,62
Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 20.:- Përgjithësisht, sistemi ndëshkimor në Kosovë është funksional, por mbesin sfida serioze për sa i përket planifikimit strategjik dhe standardeve të sigurisë.

[106] Rexhep Gashi: Shërbimi Korrektues i Kosovës (historiku, fushëveprimi, organizimi) dhe struktura e personave te dënuar e te paraburgosurit ne institucionet korrektuese, E drejta, nr. 1-2, Prishtinë, 2008.,

[107] Shih Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/26, 27 prill 2006, Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

2.12 Dogana e Kosovës

Shërbimi doganor në Kosovë është një shërbim i ri. Sikur shërbime tjera doganore të Ballkanit perëndimor, shërbimi doganor i Kosovës po e vë në prioritet perspektivën e vet evropiane për tu radhitur përkrah standardeve evropiane. Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është themeluar në gusht të vitit 1999 nga shtylla e BE-së, për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajtshëm konform të rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u shndërrua në Doganën e Kosovës. Kodi i ri doganor, i miratuar me 11 nëntor 2008, nga Kuvendi i Kosovës, mundësoi ketë tranzicion. Shërbimi Doganor ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojta e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Pra, misioni i Shërbimit doganor mund të ndahet në dy kategori kryesore: Mbledhja e taksave doganore[108] dhe kontributi për sigurinë. Sa i përket kontributit për sigurinë Dogana e Kosovës, përfshihet tek: luftimi i aktiviteteve ilegale, rritja e sigurisë përmes prezencës në pikat kufitare; luftimi i krimit kufitar; luftimi i trafikut të drogës etj., si dhe mbrojta e popullatës dhe ambientit, parandalimi kontrabandimit të armëve dhe substancave eksplozive**.**[109]

Ndërsa, komponenti i Doganave i EULEX-it ka mision të ndihmojë për të siguruar që shërbimi doganor në Kosovë mund t'i arrijë objektivat e saja për të mirën e shoqërisë dhe njerëzve të saj. Në këtë komponentë do të punojnë 27 ndërkombëtarë dhe 19 vendorë. Në një botë me ndryshime të shpejta, ku tregtia globale po bëhet shumë e rëndësishme, është jetike që shërbimi doganor t'i bëjë dy gjëra: ta ndihmojë tregtinë e arsyeshme për të mbështetur një ekonomi të fuqishme; dhe, të bëjë zbatim efikas të ligjit për të parandaluar dhe zbuluar tregtinë ilegale. Duke e luftuar tregtinë e paligjshme në bashkëpunim me agjencitë tjera për zbatimin e ligjit gjithashtu shërbimi doganor i kontribuon luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar dhe ndihmon për t'i mbrojtur të drejtat pronës intelektuale. Shërbimi doganor i Kosovës do të jetë "në ulësen e ngasësit". Komponenti doganor i EULEX-it do të monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë shërbimin, dhe, kur është e nevojshme, do të ushtrojë përgjegjësi ekzekutive ligjore në ekipe të përziera të ndërkombëtarëve dhe personelit të shërbimit doganor. Edhe EULEX-i do të bashkëpunojë me programet e komunitetit evropian për doganat. [110]

2.13 Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH)

QKSPEZH[*111*] është institucion që u ofron përkrahje teknike, administrative dhe edukative të gjitha agjencioneve të sigurisë publike siç janë: Policia e Kosovës, Shërbimi Doganor i Kosovës,

---

[108] Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 40: Shërbimi i Doganave ka pranuar planet e reja të BE-së për dogana, duke deklaruar kritere të qarta të bazuara në praktikat më të mira të BE-së për të matur kapacitetin operacional dhe themeluar plane për reformimin e doganave në të ardhmen dhe përgatitur për përputhshmërinë me standardet dhe rregullat ndërkombëtare. Po aty fq. 41: Pothuajse 75% e të gjitha mbledhjes së taksave grumbullohen në kufi. Edhe përkundër mungesës së kontrollimeve të rregullta doganore në dy pikat kufitare në veri të Kosovës, përgjithësisht mbledhja e të ardhurave nga Shërbimi Doganor i Kosovës për janar-shtator 2008 ishte 12% është më e lartë se të ardhurat e mbledhura për të njëjtën periudhë në vitin 2007.

[109] http://www.dogana-ks.org/?cidwww1,33

[110] Paul Acda http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?idwww2

[111] Me hyrjen në fuqi të Urdhëresë Administrative të UNMIK-ut nr.2008/3, më 26 mars të vitit 2008, Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) funksionon si agjencion ekzekutiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, është transformuar në janar të vitit 2006 nga Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës e themeluar në shtator të vitit 1999 nga shtylla III e UNMIK-ut, gjegjësisht Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë - Misioni në Kosovë, me synim që të krijojë një forcë moderne policore, e cila do ta kthejë besimin tek

Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës. Edukimi i pjesëtarëve të agjencive të sigurisë publike është një ndër komponentët kyçe të zhvillimit dhe të krijimit të një sistemi modern dhe të qëndrueshëm të sigurisë në Kosovë. Këto agjenci janë të përgatitura në mënyrë profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtarisht të akceptuara, që t'u bëjnë ballë sfidave dhe kërcënimeve që kanë evoluar dhe kanë marrë dimension tjetër. Krimi i organizuar, terrorizmi ndërkombëtar dhe format e tjera të dukurive negative kanë vënë si imperativë para nesh që të mendojmë se si t'u kundërvihemi në të ardhmen.[112]

Sipas respodentit, sa i përket trajnimeve për çështje gjinore "janë të përfshira në trajnimin në kuadër të lirive dhe të drejtave të njeriut ku janë dy ose tre orë ku flitet për barazinë gjinore dhe të drejtat gjinore, mirëpo nuk ka pas trajnime të veçanta, kurse pas mbarimit të shkollës kemi ofruar trajnime të veçanta për të drejtat gjinore. Për mendimin tim duhet të rishikohet kurrikulumi dhe të futet një kapitull i tërë për barazinë gjinore ku ata duhet të ndërgjegjësohen para se të fillojnë punën lidhur me të drejtat gjinore duke pasur parasysh pjesëmarrjen e kënaqshme të femrave.[113]

"Ne nisemi nga aspekti, thekson Lulzim Fushtica**,** se edhe të drejtat e njeriut edhe barazia gjinore duhet të jenë të përfshira në çdo trajnim. Kemi edhe trajnime të veçanta që bëhen për barazi gjinore. Për çdo program që bëhet në qendër është kompatibil me konventat ndërkombëtare dhe kontrollohen nga OSBE. Programet që kanë qenë të zhvilluara më herët kanë qenë nga ekspert ndërkombëtar të cilët kanë njohuri mbi këtë çështje. Mendoi se sa i përket natyrës së punës të gjitha programet janë të kontrolluara nga zyra ligjore ne kuadër te qendrës duke pasur parasysh se nëse ndodh ndonjë incident ku janë të përfshirë pjesëtaret e SHPK ose Doganës, gjëja e parë që bëhet është se vihet në shkollë dhe shihet se çka ata kanë mësuar. Kemi bërë shumë por ende ka edhe shumë për tu bërë. Kemi filluar bashkëpunimin me EULEX-in, me Departamentin e trajnimeve, ...ne kemi edhe sektorin në kuadër të qendrës që merret vetëm me barazi gjinore, (se ne jemi organ ekzekutiv i qendrës dhe i raportojmë direkt ministrit) ku kujdesemi që nga konkurset e punës deri tek gradimet, promovimi në punë, të drejtat e grave sipas ligjit në fuqi".[114]

2.14 Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP)

IKAP është Agjension Ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. IKAP është institucioni kryesor i aftësimit, përgjegjës për aftësimin e përgjithshëm të nëpunësve civilë të Kosovës. Si institucion i aftësimit parësor, i koordinon aktivitetet e aftësimit të nëpunësve civilë të Kosovës në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe komunat. IKAP ka zhvilluar një varg trajnimesh për Barazi Gjinore si dhe ka mbajtur një Trajnim të trajnerëve për Barazi gjinore.[115]

Në bashkëpunim me UNIFEM-in, janë realizuar një varg trajnimesh për nivele të ndryshme të nëpunësve civilë ku IKAP ka inkuadruar trajnerë të trajnuar nga kjo organizatë, kryesisht në lëmin e mbrojtjes së të drejtave të gruas dhe në përgjithësi për aspektin e barazisë gjinore. Gjatë zbatimit të Planit Nacional Veprues për Barazinë Gjinore, IKAP ka organizuar disa punëtori të përbashkëta me UNIFEM-in. Po ashtu, me UNIFEM-in ka ekzistuar bashkëpunimi edhe në krijimin e rrjetit të trajnerëve për fushën e barazisë gjinore. Gjithashtu, janë mbajtur

---

zbatuesit e ligjit dhe në mënyrë efikase të zbatojë parimet e kryerjes së detyrave policore në bashkëpunim me komunitetin.

[112] http://www.mpb-ks.org/?pagewww1,11

[113] Intervistë me Behar Selimin, janar 2009.

[114] Intervistë me Lulzim Fushtica, shkurt 2009.

[115] Shih Urdhëresë Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/25 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (1 tetor 2003).

trajnime të avancuar nga barazia gjinore zhvillimin e moduleve të të cilit e ka financuar UNIFEM-i.[116]

Trajnimi mbi Rezolutën 1325 dhe marrëdhëniet e saja me CEDAW, si dhe rëndësinë e saj për procesin e ndërtimit të paqes në Kosovë konsiderohet të jetë thellësisht i nevojshëm të futet në programet e trajnimit të IKAP-it.

2.15 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK)

IGJK[117] themelohet me Ligjin Nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës[118], si organ i pavarur profesional i cili gëzon statusin e personit juridik, dhe i cili vepron në bashkëpunim me Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës ose Institucionet të cilat trashëgojnë përgjegjësitë e tij për koordinimin e nevojave për aftësimin profesional të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës, për aftësimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor të Kosovës.

Duke marrë parasysh përgjegjësitë ligjore të përcaktuara në nenin 2 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, IGJK-ja është institucioni kryesor përgjegjës për:

a) Aftësimin e bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve);
b) Vlerësimin dhe organizimin e provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë;
c) Kurset e posaçme të aftësimit për avancim të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
d) Kurse për aftësimin bazë të gjyqtarëve porotë; dhe
e) Kurse për aftësimin e profesionistëve të tjerë në lëmin gjyqësisë të identifikuara nga IGJK-ja.

Sipas Ligjit Nr. 02/L-25 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës-IGJK është qendra kryesore e trajnimit gjyqësor në Kosovë me përgjegjësi për të ofruar trajnim profesional për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e sistemit të drejtësisë në Kosovë, roli i këtij Instituti është shumë i madh edhe në promovimin e Rezolutës 1325 dhe sidomos në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve me Rezolutën 1325 dhe parimet e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe antidiskriminimit. Në bazë të programeve të konsultuara të trajnimeve nuk janë mbajtur trajnime nga ky institut për legjislacionin që ka të bëjë me Rezolutën 1325.

2.16 Njësitë për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ)

Përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm mbrojtës, promovues dhe raportues për të drejtat e njeriut, i cili do të monitorojë dhe raportojë mbi zbatimin e ligjeve dhe strategjive të cilat i aprovon Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës si dhe instrumenteve ndërkombëtare të cilat janë pjesë e ligjit të aplikueshëm në Kosovë, u kurorëzuan me datën 21 korrik 2005, kur Kryeministri i Kosovës nxori Vendimin Nr.055, qe obligon secilën Ministri të formojë Njësinë për të Drejtat e Njeriut. Këto Njësi duhet të përbëhen nga 3 deri 7

[116] Shih http://www.ks-gov.net/ikap/Default.aspx?PIDwwwPartners&LIDwww1
[117] Shih http://www.kjijudicial.org/?cidwww1,21
Shih Raporti Gjashtëmujor, i Institutit Gjyqësor të Kosovës (1 janar – 30 qershor 2008), Prishtinë, 22 korrik 2008. Pjesëmarrja gjinore në trajnime në Institutin Gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2007-878 meshkuj dhe 285 femra. Ndërsa në vitin 2008 942 meshkuj dhe 332 femra.
[118] Shih Rregullore nr. 2006/23 (24 prill 2006) Për shpalljen e Ligjit mbi themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-25 mbi themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

zyrtarë, kryesisht bartës të funksioneve që merren me aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut.

Me 11 gusht 2005, Kryeministri i Kosovës nënshkroi Udhëzimin Administrativ Nr.8/2005 për përshkrimin e detyrave të punës së Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Ministritë e Qeverisë së Kosovës. Në kontinuitet të funksionalizimit të Njësive për të Drejtat e Njeriut në prill 2007 aprovohet Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2007 Për Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Qeverinë e Kosovës**.**

Njësitë për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ) janë themeluar në funksion të krijimit të mekanizmave të nevojshëm për mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut konform standardeve për të Drejtat e Njeriut, si në nivelin qendror po ashtu edhe në nivelin lokal, të cilat në mandatin e tyre kanë edhe fushën e promovimit të mundësive të barabarta dhe monitorimit të legjislacionit cili rregullon këtë fushë.[119]

Njësiti për të Drejtat e Njeriut (NjDNJ) në kuadër të Ministrive do të veprojnë si një mekanizëm mbikëqyrës, monitorues brenda për brenda Ministrisë, sa i përket zbatimit të dokumenteve, ligjeve mbi të drejtat të njeriut të cilat aprovohen nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, e të cilat bien në përgjegjësin dhe kompetencat e ministrisë përkatëse.[120]

2.17 Njësitë Komunale për të Drejtat e Njeriut (NJDNJK)

NJDNJKjanë themeluar sipas Udhëzimit Administrativ MAPL-Nr.2008/02 dhe kanë këto përgjegjësi të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin komunal.
Njësitë për të drejtat e njeriut janë vendosur në komuna për të siguruar monitorimin e të drejtave të njeriut në nivel lokal. Ato i plotësojnë njësitë për të drejtat e njeriut në nivel ministror. Sidoqoftë, trajnimi për stafin relevant duhet të intensifikohet për të përmirësuar koordinimin. Mekanizmat monitorues nuk janë akoma efektiv.[121]

Njësitë për të drejtat e njeriut në ministri dhe komuna kanë marrë trajnime të mëtejshme dhe kanë organizuar sesione informative për Ligjin Kundër Diskriminimit dhe ligje tjera që kanë të bëjnë me barazinë gjinore (duke përfshirë edhe LBGJ-në) dhe jodiskriminimin në përgjithësi. Kapaciteti i njësive për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe komunal akoma është i vogël.

---

[119] Shih Neni 11-pika 11.3 i Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 Për Njësitë e të Drejtave të Njeriut në Qeverinë e Kosovës. Zyrtarët në kuadër të Njësitit për të Drejtat e Njeriut do t'i mbulojnë këto sfera të të drejtave të njeriut: mundësitë e barabarta (lidhur me zbatimin e ligjit kundër diskriminimit), barazinë gjinore (konform Ligjit për barazi gjinore), të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve (komuniteteve), të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër trafikimit.
[120] Shih Udhëzimin Administrativ Nr.8/2005 për përshkrimin e detyrave të punës së Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Ministritë e Qeverisë së Kosovës. Për më tutje NjDNJ do të zhvillojë dhe hartojë politika dhe udhëzime në lëmin e respektimit të të Drejtave të Njeriut në kuadër të ministrisë përkatëse; NjDNJ do të bashkëpunojë me Institucionin e Ombudspersonit , si dhe do të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Ombudspersonit të cilat i adresohen Ministrisë përkatëse; NjDNJ do të vlerëson zbatimin e të drejtave të njeriut në nivelin e Ministrisë; NjDNJ do të merr pjesë në draftimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore; NjDNJ do të bënë promovimin e të drejtave të njeriut; NJDNJ kujdeset për zbatimin e ligjeve të cilat aprovohen nga Kuvendi i Kosovës, e të cilat janë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të ministrisë përkatëse; NjDNJ do të merë pjesë në mënyrë aktive në punën e grupeve të ndryshme Ministrore të cilat veprojnë në kuadër të Qeverisë së Kosovës. NjDNJ do të këshillon vendimmarrësit në Ministri lidhur me çështjet e të drejtave të Njeriut.
[121] Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 17.

Të gjithë mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, e posaçërisht Agjencia për Barazi Gjinore, nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm, legjitimitet dhe status të qartë. Këto probleme institucionale kanë ndikim negativ për gjendjen e gruas në Kosovë.[122]

2.18 Avokati i Popullit - Institucioni i Ombudspersonit

Ombudspersoni fillimisht ishte krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2000/38 (30 qershor 2000) Mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, e cila përcaktonte: Ombudspersoni i përkrah dhe i mbron të drejtat dhe liritë e individëve dhe personave fizikë dhe garanton se të gjithë njerëzit në Kosovë mund t'i gëzojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, që do të mbrohen në mënyrë efektive me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, sidomos me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolat e saj dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.[123]

Më pas edhe Kreu 10 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë përcakton: Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë, pa pasur frikë apo kërcënim për masë ndëshkimore, të bëjnë ankesa pranë një zyre të pavarur në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe veprimeve që përbëjnë shpërdorim të pushtetit nga çfarëdo organi publik i Kosovës.[124]

Në muajin shkurt 2006, PSSP nxori Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit për të zëvendësuar Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/38. Që nga nxjerrja e Rregullores së UNMIK-ut, ka pas huti në lidhje me kompetencat e Institucionit për hetimin e ankesave kundër zyrtarëve të UNMIK-ut. Pas nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06, e cila parasheh Ombudspersonin vendor të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, duket se kompetencat e Institucionit të Ombudspersonit ishin kufizuar duke i trajtuar ankesat vetëm kundër IPVQ-ve. Kjo u konfirmua në letrën që iu dërgua Ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit nga ish Zëvendës i PSSP-së në gusht të vitit 2006, në të cilën thuhej se Institucioni i Ombudspersonit do të duhej të përqendrohej në ankesat kundër strukturave të IPVQ-ve dhe se Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, i themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, do të kishte mandatin për t'i trajtuar shkeljet eventuale të të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u. Megjithatë, në fund të vitit 2007 UNMIK-u i kishte dhënë shenja palëve të treta se Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit megjithatë i gëzonte kompetencat e Ombudspersonit ndërkombëtar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/38, përderisa të emërohej Ombudspersoni i ri nga Kuvendi i Kosovës.[125]

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit ngritet në nivel kushtetues si Institucion i pavarur ku në Nenin 132 epet roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit dhe përcaktohet:

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

---

[122] Monitorimi i Sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore: Qendra Kosovare për Studime Gjinore Prishtinë, 2007, fq. 8

[123] Neni 1.1. Rregullorja e UNMIK-ut Nr 2000/38 (30 qershor 2000) mbi themelimin e institucionit të Ombudspersonit në Kosovë.

[124] Kreu 10 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë.

[125] Raporti i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat ,Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, për Komitetin për të Drejtat, Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Gjenevë.

2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.

3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.[126]

Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj. Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës, të cilët, ku numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit.[127]

Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.[128]

Çështjet e diskriminimit që lidhen drejtpërdrejt me gjininë trajtohen nga Njësia për Barazi Gjinore në kuadër të këtij institucioni.

Respondentja nga Zyra e Ombudspersonit përshkroi detyrat e saj:…brenda Zyrës së Ombudspersonit ekzistojnë tri njësi. I pari është grupi për të drejta të fëmijëve, pastaj grupi që punon kundër diskriminimit dhe së treti grupi që avokon për barazi gjinore. Ideja pas krijimit të këtyre grupeve është se disa kategori sociale pësojnë më shumë nga diskriminimi... Grupi i fëmijëve ishte krijuar në bashkëpunim me UNICEF-in, ndërsa dy grupet tjera janë krijuar pas miratimit të ligjeve përkatëse nga qeveria. Në këto ligje Zyra e Ombudspersonit përshkruhet si mekanizëm special, dhe kësisoj ligji për barazi gjinore gjithashtu kërkonte që Ombudspersoni të mbulojë edhe çështjet e barazisë gjinore.[129]

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve dorëzoi një ankesë lidhur me zbatimin e dobët të politikave nga ana e UNMIK-ut, kundër dhunës në familje. Megjithatë, hulumtimi i ankesave kundër institucioneve dhe agjencive ndërkombëtare nuk bie nën mandatin e Ombudspersonit. Respondentët komentuan mbi frustrimin e femrave që nuk kishin mundësi të procedojnë kundër praktikave diskriminuese në punë, siç janë ngacmimit seksual dhe largimit të padrejtë nga agjencitë ndërkombëtare.

2.19 Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12,130, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut, Paneli këshillëdhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtave

[126] Kapitulli XII Institucionet e Pavarura Neni 132 (Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit) Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
[127] Neni 133 (Zyra e Avokatit të Popullit) Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
[128] Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit], Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
[129] 73 Intervistë me Violeta Krasniqin, korrik 2007.
[130] Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/12 (23 mars 2006) mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërën apo në më shumë instrumentet ndërkombëtare.[131]

Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshillëdhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshillëdhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshillëdhënëse.

Paneli këshillëdhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.[132]

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshillëdhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Paneli Këshillues i të Drejtave të Njeriut i themeluar për të adresuar boshllëkun në juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe shqyrtuar ankesat për shkeljet e të drejtave të njeriut nga UNMIK-u, ka mbajtur sesionin e tij përurues në nëntor të vitit 2007. Rregullat e tij të procedurës janë aprovuar në shkurt 2008. Paneli aktualisht është duke shqyrtuar një numër të rasteve, disa prej të cilave i janë referuar PSSP-së në përputhje më dispozitat e rregullores 2006/12. Në mars të vitit 2008 paneli ka lansuar një fushatë informuese për të promovuar mandatin e tij.[133]

2.20 Ndihma Juridike Falas

Ndihma juridike falas është institucioni i parë në Ballkan, i asistencës ligjore, i financuar nga shteti. Ndihma Juridike falas është ofrimi i këshillave juridike dhe informative personave të kualifikuar dhe financiarisht të përshtatshëm lidhur me të drejtat e tyre dhe mjetet juridike. Po ashtu, përfshinë përfaqësimin pa pagesë të palëve në gjykata dhe organe administrative, si edhe ndihmën juridike në përpilimin e shkresave, dhe parashtresave, procedurave duke përfshirë ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe zgjidhjen alternative të kontesteve. Ky shërbim financohet nga Qeveria e Kosovës për t'i mundësuar qasje në drejtësi, qytetarëve të cilët e plotësojnë kriterin e përshtatshëm financiar.

Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/36 për ndihmë juridike është themeluar Komisioni për ndihmë juridike si organ i pavarur i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ky Komision do të sigurojë ndihmë juridike për ata të cilëve do t'u mohohej qasja efektive në drejtësi nga mungesa e mjeteve të mjaftueshme.

---

[131] Shih Neni 1.2. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/12.
a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948; (b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollet e saj; (c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollet e saj; (d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966; (e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965; (f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979; (g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe (h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.
132 Shih Neni 2, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/12.
133 Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 18.

Ndihma juridike në Republikën e Kosovës funksionon nëpërmjet tri institucioneve të saj: Komisioni për ndihmë juridike (i cili është përgjegjës për të siguruar që ofrimi i ndihmës juridike të jetë: efikas, fleksibil, gjithëpërfshirës, i efektshëm dhe i qëndrueshëm), Zyra Koordinuese për ndihmë juridike (e cila administron sistemin e ndihmës juridike dhe i mbikëqyrë byrotë e qarkut për ndihmë juridike) si dhe Byrotë e Qarkut për ndihmë juridike (të cilat ofrojnë ndihmë juridike qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilëve i është mohuar qasja në drejtësi për shkak të mungesës së mjeteve materiale. [134]

Koordinatorja e Ndihmës Juridike, thekson: Klientët tanë kryesor janë personat me vështirësi financiare që kanë ndonjë kontest ligjor por që nuk mund të paguajnë avokat. Ne ju ndihmojmë edhe grupeve të ndjeshme përfshirë këtu pjesëtarët e komuniteteve pakicë, personave me aftësi të kufizuara, njerëzve të moshuar, fëmijëve, viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit dhe shumë kategorive të tjera të personave me nevoja të veçanta". [135]

Sipas respodentit, nga UNHCR, Programi i ndihmës juridike pa pagesë, po ashtu dukshëm ka zbutur situatën e vështirë të pjesëtarëve nën përkujdesje të cilët janë në rrezik të mbetjes të pa shtetësi, duke u mundësuar atyre marrjen e dokumenteve personale dhe në këtë mënyrë krijimin e mundësisë për ata që të regjistrohen dhe të ushtrojnë të drejtat dhe obligimet si banorë të Kosovës.

***

Përderisa shumica e përfaqësuesve qeveritar në nivelin qendror dhe komunal kanë njohuri themelore për Rezolutën 1325, procesi i artikulimit të Rezolutës dhe instrumenteve të ndërlidhura të të drejtave të njeriut, në legjislacionin vendor nuk kuptohet gjithnjë qartë. [136]

Mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore janë krijuar në të gjitha nivelet e qeverisjes, por artikulimi në politika dhe rregulla administrative mbetet i ngadalshëm për shkak të përkufizimeve financiare dhe mungesës së vullnetit të zyrtarëve në nivelet më të larta të vendimmarrjes. Disa nga të intervistuarit kanë cituar shembuj të bashkëpunimit të parregullt dhe pakoordinuar nga lidershipi i komunitetit ndërkombëtar dhe agjencive gjegjëse të cilët kanë penguar përfshirjen efektive të grave në proceset vendimmarrëse dhe kanë ngadalësuar inicimin e përfshirjes të çështjeve gjinore nga niveli qendror në atë komunal. Për më tej, respondentët theksuan shembuj të shumtë të dialogut të kufizuar dhe joproduktiv ndërqeveritar dhe mungesës së vullnetit politik në nivel kombëtar për të përfshirë më shumë gra në vendimmarrje.

---

134 Shih Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/36 (7 qershor 2006) për ndihmë juridike. Shih Po aty Neni 4.2 Komisioni përbëhet nga një komisioner dhe tetë (8) zëvendës, të cilët janë profesionistë të kualifikuar që kanë njohuri për ndihmën juridike dhe sistemin e drejtësisë apo të cilët sjellin njohuri përkatëse dhe shkathtësi të vlefshme të rajoneve nga vijnë në punën e Komisionit.
Duhet cekur se anëtar të këtij Komisioni, në pajtim me rregulloren e cekur janë kandidatë të propozuar nga Shoqata e Rrjetit të Grave Kosovës.
Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 19. Në fushën e qasjes në drejtësi, sistemi për ndihmë juridike tani është operativ; ai përbëhet nga Komisioni për Ndihmë Juridike, i cili ka qenë operativ prej shtatorit të vitit 2007, Zyrës Koordinuese për Ndihmë Juridike dhe pesë Zyra të Qarkut për Ndihmë Juridike me një staf prej 21 personash, përfshirë 13 juristë dhe tre pjesëtarë të stafit prej komuniteteve jo-shumicë.

135 Drita Rexhepi, Fokus Kosova, UNMIK, Pranverë 2008, fq.12.

136 Nga intervistat e kryera në vitin 2007, nga RRGGK, Kosovë.

Lidhur me vullnetin politik ne zbatimin e Rezolutës 1325, mund te them, thekson Igballe Rogova, "se s'ka vullnet politik për përfshirjen e grave në pozita vendimmarrëse."[137]

Sipas Nazlie Bala, zbatimi i hollësishëm i Rezolutës 1325 në praktikë nuk është duke ndodhur "në mungesë të mekanizmave përcjellës, në veçanti pranimit dhe aprovimit të Rezolutës 1325 nga vetë Institucionet vendimmarrëse të Kosovës.[138]

Në vitin 2006-7 prioritet i është dhënë vendimit mbi statusin e ardhshëm të Kosovës. Sipas Nazlie Bala, "nuk ekziston vullnet politik për të zbatuar, monitoruar dhe raportuar për të drejtat gjinore. çështjet gjinore deri me tani janë çështje dytësore në prioritet e organizmave politikëbërse në Kosovë."[139]

Arritja e përfaqësimit prej rreth tridhjetë përqind të grave në parlament, falë kuotës së përcaktuar, nga shumica e të intervistuarve vlerësohet si e arritur që ofron "cilësi përmes kompromisit". Respondentët vërejtën margjinalizimin e përgjithshëm të grave brenda strukturave partiake dhe mungesën e programeve për përfshirje të çështjeve gjinore si në politikat partiake ashtu edhe në negociatat politike në Kuvend.

Ndërsa, Shqipe Krasniqi, ushtruese e detyrës së Kryeshefes Ekzekutive të ABGJ-së, thekson: Mendoj se kuota për sistemin dhe mentalitetin e shoqërisë kosovare është obligative dhe e domosdoshme për të pasur përfaqësimin e denjë në parlament pavarësisht asaj nëse kemi kualitet ose kuantitet. Çështjet gjinore ndikojnë edhe në ndryshimin e të menduarit apo mentalitetin e një populli e për dhjetë vite mendoj se është periudhë e shkurtër, mirëpo obligimet që janë dhënë nga ndërkombëtaret dhe ligjet e përpiluara të japin hapësirë që nuk jemi larg ndryshimit të të menduarit.[140]

Maria Fihl-Vetting, thekson se ka pasur rastin të takohet me pjesëtarë të qeverisë si dhe me zyrtaret e ABGJ-së ku edhe ata vetë pohuan se nuk është punuar mjaftë në aspektin e barazisë gjinore, mirëpo është mjaft premtuese kur e shikon sepse brenda institucioneve qeveritare ka departament për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore edhe pse mund të duket se çështja e barazisë gjinore është e fundit në listën e qeverisë së Kosovës.[141]

[137] Intervistë me Igballe Rogoven, shkurt 2009.
[138] Intervistë me Nazlie Bala, shkurt 2009.
[139] Intervistë me Nazlie Bala, shkurt 2009.
[140] Intervistë me Shqipe Krasniqin, shkurt 2009.
[141] Intervistë me Maria Fihl-Vetting, shkurt 2009.

3. Ligjet dhe Politikat me Qëllim të Fuqizimit dhe Promovimit të të Drejtave të Grave

Republika e Kosovës është duke ndërtuar një infrastrukturë të re ligjore e cila synon të jetë konform Standardeve Ndërkombëtare dhe Evropiane mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.[142] Në Kosovë, barazia gjinore nuk është diçka e sajuar nga dëshira, por e sanksionuar në një varg aktesh të ndryshme ligjore. Në këtë drejtim, në Republikën e Kosovës janë nxjerrë një varg ligjesh dhe politika të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së femrave dhe meshkujve në shoqëri dhe mënjanimit të pabarazisë gjinore ekzistuese, por, "legjislacioni, nuk duhet në këtë drejtim të ofrojë thjeshtë të drejta të barabarta (në kuptim ligjor të konceptit) por garanci për të mos cenuar të drejtat themelore".[143]

3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Më 9 prill, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kësaj i ka paraprirë përgatitjet nga grupi punues kushtetues, diskutimet publike[144], certifikimi i draft

---

[142] Para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji në fuqi në Kosovë përfshinte: Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh, do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar me lart, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj. Shih Neni 1, Rregullore e UNMIK-ut Nr.1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (15 qershor 2008), legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë. Shih Neni 145-Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

[143] Enkelejda Olldashi: Si të arrihet qytetaria evropiane? Revista Teuta, Prishtinë, shtator 2008, fq. 8.

[144] Me datën 25 Shkurt 2008 RrGGK dhe Instituti Demokratik Nacional (NDI) kanë organizuar një debat lidhur më kushtetutën së bashku me gra deputete të Parlamentit të Kosovës. Një prej çështjeve kyçe që u diskutua është përfshirja në kushtetutë e kuotës 40% përfaqësimi i të dy gjinive në nivel qeveritar, duke përfshirë parlamentin dhe ministritë.
Me 1 Mars anëtaret e RrGGK-së dhe anëtaret e komisionit kushtetues, Nekibe Kelmendi, Gjyljeta Mushkolaj, Lirie Osmani si dhe Vjosa Dobruna, u takuan tek Hani i 2 Robertëve për të vazhduar debatin e tyre lidhur me kushtetutën. Përveç kuotës, një çështje tjetër madhore që u diskutua ishin dilemat rreth futjes së Rezolutës së KSKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në kushtetutë. Përderisa anëtarja e komisionit deklaron se ishte ambicie shumë e madhe të implementohet nga institucionet e Kosovës dhe se nuk duhet të futet kjo rezolutë në kushtetutë, aktivistet argumentuan se duhet të futet kjo rezolutë sepse kjo do ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare.
Për të arritur implementimin e kësaj Rezolute do të varet nga qeveria e Kosovës e cila ka përgjegjësinë ligjore të implementoj këtë Rezolutë sipas kushtetutës.
Me 2 Mars, RrGGK dërgoi rekomandimet tek komisioni për kushtetutë dhe ato përmbanin:
• Kuota 40% e pjesëmarrjes në të gjitha nivelet qeveritare siç është e paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore;
• Rezoluta e KSKB-së 1325 të futet në listën e konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare;
• Të përfshihen dispozitat në Kushtetutë, të cilat sigurojnë se Agjencia për Barazi Gjinore është organi përgjegjës për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e akteve të brendshme dhe ndërkombëtare mbi barazinë gjinore;
• Të përfshihen dispozitat të cilat sigurojnë respektimin e së drejtës në pronë si të femrave ashtu edhe të meshkujve;
• Të sigurohet që Kushtetuta ofron referenca specifike se bashkëshortët në martesë janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet pronësore dhe personale;

kushtetutës nga PCN-ja dhe aprovimi nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.[145] Kushtetuta garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe grave sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Në këtë drejtim ne Nenin 7.2. është përcaktuar:" Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore". Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, garantohen me këtë Kushtetutë dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.[146]

Edhe pse Rezoluta 1325 nuk përmendet në mënyrë specifike, Kushtetuta përmend drejtpërdrejt promovimin e të drejtave të grave me Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW).

3.2 Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ)

Më 7 qershor 2004 ka hyrë në fuqi Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë, (LBGJ),[147] me të cilin mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore". Barazia gjinore bazohet në parimin e sjelljes së njëjtë dhe në parimin e mundësive të barabarta, ndërsa jetësohet me masat pozitive dhe me politikë të vetëdijesuar për barazi gjinore... LBGJ përcakton standardet për arritjen e barazisë gjinore, dhe i ndan përgjegjësitë për arritjen e kësaj barazie mes Kuvendit, qeverisë dhe ministrive dhe

---

• Të përfshihen dispozitat të cilat sigurojnë se punëdhënësi do të ofrojë pagë të njëjtë për femra dhe për meshkuj, për punë me vlerë të njëjtë, dhe do të sigurojë punësim dhe kushte të barabarta dhe të drejta të njëjta; dhe

• Të përfshihen dispozitat të cilat sigurojnë se gruaja nuk e humb shtetësinë e saj pas martesës me një të huaj.

Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 1 dhjetor 2007 - shkurt 2008, www.womensnetwork.org

[145] Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-(Versioni i përkthyer Shqip), fq. 8: Kushtetuta është e bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës të përgatitur nga përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Marti Ahtisaari. Kushtetuta në mënyrë të qartë konfirmon që dispozitat e Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës kanë përparësi në raport me të gjitha dispozitat legale në Kosovë. Ajo, po ashtu, konfirmon Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës si referencë kryesore për të verifikuar pajtueshmërinë e kushtetutës me ligjet dhe aktet tjera legale. Kushtetuta konfirmon se PCN është autoriteti përfundimtar në Kosovë për sa i përket interpretimit të aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Kushtetuta nuk i referohet KB-ve ose UNMIK-ut, përveçse në kontekst të përfundimit të misionit të tij në Kosovë.

[146] Neni 22, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kapitulli 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Të Drejtat dhe Liritë Themelore) përcakton:

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
2. Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.
3. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.
4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.146

[147] Ligji nr. 2004/2 për barazi gjinore, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: viti II / nr.14 / 1 korrik 2007

organeve të pushtetit lokal duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Në dispozitat e LBGJ-së, në nenin 2.2, përkufizohet: Trajtim i barabartë gjinor do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.[148]Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve, sipas LBGJ-së, arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

3.3 Ligji Kundër Diskriminimit (LKD)

Në shtator të vitit 2004 ka hyrë në fuqi Ligji Kundër Diskriminimit (LKD).[149] "Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit."[150] Qeveria është e obliguar që të ofrojë informata lidhur me Ligjin Kundër Diskriminimit ndërsa trajnime specifike janë ofruar për gjyqtarët dhe prokurorët mbi përdorimin praktik dhe konsistent të LKD-se. LKD ndalon diskriminimin e drejtpërdrejt dhe të tërthortë dhe definon të gjitha format e paraqitjes së diskriminimit – mes tjerash, ngacmimin, viktimizimin dhe segregacionin,. (...) Një risi e rëndësishme është që ...barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë."[151]

Ligji kundër diskriminimit zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizikë dhe juridikë të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike të cilat cenojnë të drejtat e personit/ave fizikë dhe juridikë.

Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006 për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit është nënshkruar nga Kryeministri me dt. 25 maj 2006. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i rregullave praktike, lehtësirave strukturore dhe fizike për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit si dhe promovimit të trajtimit të barabartë për të gjithë personat pa diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve të tjera të personave te cilët pretendojnë se janë viktimë e diskriminimit ashtu siç parashihet në Nenin 2, alineja (a) të Ligjit kundër Diskriminimit.[152]

Qeveria e Kosovës, më 11 tetor 2005, ka miratuar Planin e veprimit për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit[153] i cili "përcakton parametrat e aktiviteteve të kufizuara në kohë, përgjegjësitë e vepruesve/institucioneve të angazhuara si dhe propozimet për hartimin e një përshkrimi të detajizuar të nevojave të financimit për zbatimin e Planit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe nga donatorët.

Qeveria e Republikës së Kosovës në takimin e saj të 34-të, të mbajtur me datën 03 shtator 2008, ka shpallur muajin shtator-Muaj Kundër Diskriminimit në Kosovë.[154] Nën moton "Të gjithë të barabartë dhe pa diskriminim", gjatë muajit shtator 2008 janë zhvilluar një varg aktivitetesh

[148] LBGJ, Neni 3.
[149] Ligji Nr.2004/ 3 Kundër Diskriminimit, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: VITI II / Nr.14 / 1 korrik 2007.
[150] Shih Marcus Brand, Zhvillimi i Institucioneve të Kosovës dhe Bartja e Autoriteteve nga UNMIK-u tek Institucionet Lokale të Vetëqeverisjes, Gjenevë, Qenda për Shkenca Aplikative në Negociata Ndërkombëtare (CASIN), janar 2003.
[151] Shih Neni 8, Ligji Nr.2004/ 3 Kundër Diskriminimit, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: VITI II / Nr.14 / 1 korrik 2007.
[152] Shih Neni 1 Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2006 për zbatimin e Ligjit kundër Diskriminimit.
[153] Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 4/170, 11.10. 2005.
[154] Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 05/34, 03.09.2008.

sipas një plani të përgatitur nga ZQM, në bashkëpunim me Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Ministritë si dhe me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Qëllimi i muajit kundër diskriminimit ka qenë: realizimi i një varg aktivitetesh lidhur me promovimin e mundësive të barabarta dhe parimit të trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç definohet në legjislacionin kundër diskriminimit, promovimi i mekanizmave institucionalë në nivelin qendror dhe lokal, si dhe ngritjen e vetëdijes së popullatës së gjerë lidhur me përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të siguruar mbrojtje dhe respektim të lirive dhe të të drejtave e qytetarëve të saj konform standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë kuadër, ZQM, me 19 Shtator 2008, datë kjo që shënon katërvjetorin e hyrjes në fuqi të Ligjit Kundër Diskriminimit, organizoi një konferencë për media dhe prezantoi aktivitetet të cilat janë zhvilluar në kuadër të këtij muaji.

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në vitin 2008, ka mandatuar dy studime hulumtime) që të vlerësojë: (1) perceptimet e qytetarëve mbi diskriminimin në Republikën e Kosovës dhe (2) perceptimi i nëpunësve civil mbi diskriminimin në Administratën Publike të Republikës së Kosovës, të cilat janë botuar si dy botime të veçanta.[155] Projekti është përkrahur dhe mbështetur nga OSBE.

Në vitin 2008, nga Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë/ZQM është bërë publikimi i përmbledhjes së legjislacionit kundër-diskriminim në formë të broshurës. Përmbledhja është e përgatitur në pesë gjuhët lokale: shqipe, serbe, turke, boshnjake dhe rome. Publikimi ka për qëllim informimin e opinionit publik dhe zyrtarëve/nëpunësve civilë mbi rëndësinë e zbatimit në praktikë të ligjit kundër- diskriminimit. [156]

Gjithashtu Ligji kundër diskriminimit - dhe Udhëzimi Administrativ për zbatimin e tij është publiku edhe në alfabetin Braille, e cila i dedikohet komunitetit të personave të verbër.

3.4 Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM)

Kuvendi i Republikës së Kosovës,[157] me përpjekje të shtuara për arritjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit, në seancën plenare të mbajtur më 17 tetor 2008[158], miratoi Rezolutën

[155] Shih botimet: Perceptimi i qytetarëve mbi diskriminimin në Republikën e Kosovës (2007-2008) Vëllimi 1, dhe Perceptimi i nëpunësve civil mbi diskriminimin në Administratën Publike të Republikës së Kosovës(2007-2008) Vëllimi 1, Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë.

[156] Shih Përmbledhje e Ligjit Kundër Diskriminimit dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e tij, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë, Maj 2008.

[157] Burimi: www.undp.org/ mdg. Korniza e Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM-ve) përmban 8 objektiva, 18 synime dhe 48 tregues. Shumica e synimeve duhet të arrihen gjatë periudhës 25 vjeçare, pra prej vitit 1990 deri në vitin 2015. Tetë OZHM-të janë si në vijim: Objektivi 1: Përgjysmimi i varfërisë së skajshme dhe i urisë; Objektivi 2: Përfshirja e të gjithë fëmijëve në shkollimin fillor; Objektivi 3: Avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas; Objektivi 4: Zvogëlimi për dy të tretat i vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën 5 vjeçare; Objektivi 5: Zvogëlimi për tri të katërtat i vdekshmërisë së nënave; Objektivi 6: Zvogëlimi i përhapjes së HIV/AIDS –it, i malaries dhe i sëmundjeve të tjera; Objektivi 7: Sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore; Objektivi 8: Krijimi i partneritetit global për zhvillim me synim të dhënies së ndihmës, të zhvillimit të tregtisë dhe të faljes së borxheve. Shtatë objektivet e para e nënvizojnë përgjegjësinë e vendeve në zhvillim që t'i trajtojnë pengesat kryesore zhvillimore, duke kërkuar reforma më të gjëra të politikave dhe përmirësim të qeverisjes. Ndërsa objektivi i tetë e vë përgjegjësinë te vendet e zhvilluara për t'ua shlyer një pjesë të borxhit, për t'ua përshtatur ndihmën me nevojat e shtetit pranues dhe për t'u ofruar vendeve në zhvillim qasje më të mirë në teknologji dhe tregje.

[158] Gjithashtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është bërë përurimi i monitorit të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit me ç'rast kryeparlamentari Krasniqi në fjalën e tij të rastit, duke shprehur

për adoptimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit, sipas tekstit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara *A/RES/55/2* të aprovuar me 8 shtator 2000.

Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës që të krijojë partneritete globale, si dhe mirëpret përkrahjen ndërkombëtare në mobilizimin e përpjekjeve dhe të burimeve drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit në Kosovë si dhe Inkurajon autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat që të përfshihen në procesin e arritjes se Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri më 2015.

Po ashtu, Kuvendi zotohet që të miratojë kornizën e nevojshme ligjore dhe të krijojë politika të duhura që mundësojnë përfshirjen dhe përmbushjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit përmes planit përkatës kombëtar për zhvillim, dhe siguron mekanizma dhe kapacitete të duhura institucionale, si dhe burime financiare të cilat lehtësojnë arritjen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit. Po ashtu, Kuvendi duhet të mbajë seancë vjetore për të diskutuar përparimin e arritur në lidhje me Objektivat për Zhvillim të Mijëvjeçarit, bazuar në raportin e ofruar nga Qeveria, dhe inkurajon të gjitha autoritetet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat, që të kontribuojnë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit.

Një nga Tetë OZHM-të është edhe Objektivi 3: Avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas dhe në këtë drejtim është obligim i Republikës së Kosovës në zhvillim që t'i trajtojnë pengesat kryesore zhvillimore, duke kërkuar reforma më të gjëra të politikave dhe përmirësim të qeverisjes.

3.5 Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) (2008-2013)

Në vitin 2008 Qeveria e Kosovës (Vendimi Nr.07/17, 24.04.2008) ka miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2008-2013).[159] Fillimisht, Programit të Kosovës për Barazinë Gjinore i ka parapri Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore. Qeveria e Kosovës, në vitin 2004 ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore. Ky plan paraqet rekomandimet për adresimin e problemeve dhe të çështjeve specifike të kontrasteve gjinore në Kosovë. Si një mekanizëm për barazi gjinore, Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore është hartuar në pajtim me nevojat e grave të Kosovës dhe është disenjuar në atë mënyrë që të mund të pasqyrojë përpjekjet vendore në lidhje me kontekstin e lëvizjeve ndërkombëtare për avancimin e statusit të grave, si dhe me qëllim të propozimit të hapave konkretë për rrugën që duhet të marrë Kosova drejt barazisë dhe zhvillimit. Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore (PKV) zakonisht vlerësohet si hap konkret drejt një përfshirje efektive të çështjeve gjinore dhe inkorporimit të dispozitave të Rezolutës 1325 në politikë veprimi. Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës në mënyrë specifike ka përfshirë përfaqësuesit nga shoqëria civile në grupin e vet punues.1 PKV është krijuar me ndihmë nga UNIFEM-i dhe është miratuar përfundimisht nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2004. Ai në mënyrë eksplicite bazohet në Konventën CEDAW dhe Deklaratën dhe Platformën e Veprimit të Pekinit. Një dokument tjetër i dalë nga PKV i quajtur Objektivat dhe Veprimet Strategjike që Adresojnë Fusha Specifike Kritike fokusohet në shëndetësinë, të drejtat e njeriut dhe dhunën ndaj grave dhe fëmijëve, arsimin, politikën dhe kulturën.1 Ai përcakton zotimin e të gjitha niveleve të qeverisë dhe grupeve të shoqërisë civile në krijimin e masave kundër diskriminimit dhe fuqizimin e grupeve të brishta. I njëjti përcakton kornizën e përgjegjësive

---

keqardhje pse Kosova për arsye të statusit politik, nuk ka qenë e përfshirë në nxjerrjen e Deklaratës së Asamblesë së Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Mileniumit në Samitin e vitit 2000.

159. Shih Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) (2008-2013) http://www.ks-gov.net/abgj/

qeveritare për koordinimin dhe zbatimin e këtyre masave. Me rëndësi është fakti që PKV shtjellon kontekstin e përgjithshëm kosovar, duke analizuar ndryshimet e paskonfliktit dhe pasojat që janë shkaktuar nga këto ndryshime. PKV thekson se qëllimet duhet të arrihen përmes bashkëpunimit ndërsektorial të institucioneve joqeveritare, kombëtare dhe ndërkombëtare në periudhën mes 2003 – 2007.

PKBGJ synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe specifik për ndryshime në kushtet e jetesës së grave dhe vajzave në Kosovë, si dhe për eliminimin e ndasive të cilat janë të lidhura ngushtë me varfërinë, mentalitetin dhe traditën e një shteti shumetnik dhe diktatorial.[160]

PKBGJ paraqet programin strategjik për integrimin e Barazisë Gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverise së Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, hartimi i PKBGJ-së është fokusuar në 6 fusha specifike; (i) integrimi i grave në ekonomi; (ii) integrimi i grave në tregun e punës dhe përkujdesja sociale për kategoritë e prekura nga problemet sociale; (iii) gratë në proceset e vendimmarrjes, (iv) përkujdesja shëndetësore dhe qasja e grave dhe meshkujve në shërbimet shëndetësore, (v) arsimimi; dhe, (vi) përfaqësimi dhe kontributi i tyre në kulturë dhe media.

Në këtë kuadër, PKBGJ ofron një vizion të përmirësuar afat mesëm për arritjen e barazisë gjinore. Dokumenti që kemi hartuar është bazuar dhe ka ruajtur orientimet strategjike të vendosura në SPZHK, duke iu përgjigjur qëllimeve të Integrimit Evropian si dhe Synimeve të Mijëvjeçarit.

Qëllimet e këtij PKBGJ-së janë; (a) të analizojë gjendjen aktuale të grave dhe meshkujve në Kosovë duke dhënë ecurinë afatshkurtër dhe afatmesme të fenomeneve dhe ndikimin e tyre në luftën kundër varfërisë; (b) të identifikojë mundësitë duke përfshirë politikat dhe institucionet në shërbim të barazisë gjinore; (c) të identifikojë fushat për ndërhyrje dhe të rekomandojë politikat, programet dhe masat për zgjidhjen e problemeve dhe përballimin e sfidave që paraqet lufta kundër varfërisë, dhe zhvillmi ekonomik e social i vendit; (d) të hartojë aq sa është e mundshme një buxhet, që do të jetë një mekanizëm në duart e Qeverisë së Kosovës për arritjen e qëllimeve.

PKBGJ-ja duhet të merret parasysh nga çdo zyrë apo institucion dhe ky program të përfshihet në të gjitha politikat e institucioneve.[161]

3.6 Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (2009-2011)

Është miratuar nga Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008.[162] Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës 2009-2011 është hartuar me koordinimin e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës /Zyrës për Qeverisje të Mirë, dhe nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë me shumë aktorë të

[160] Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 22:- Në fushën e të drejtave të grave, qeveria ka aprovuar Programin për Barazi Gjinore 2008-2013, i cili identifikon objektivat, politikat dhe institucionet e angazhuara në implementimin e Ligjit për Barazi Gjinore.
Në qershor, qeveria ka dorëzuar një raport për Profilin Gjinor të Kosovës në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas duke mbuluar periudhën 1999-2007.

[161] Intervistë me Shqipe Krasniqin, shkurt 2009.

[162] Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 13/46, 03.12.2008 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës për periudhën 2009-2011.

rëndësishëm të fushës së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe me institucione ndërkombëtare të kësaj fushe. Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës synon të jetë një dokument që ofron hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë për të përmirësuar zbatimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përhapjen e njohurive për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Me këtë Strategji fokusi i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në periudhën e ardhshme trevjeçare do të jetë në disa fusha kryesore:

1. Hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit në fushat e të drejtave të njeriut;
2. Nxjerrja e legjislacionit të nevojshëm, përfshirë rishikimin dhe zbatimin e legjislacionit aktual;
3. Ndërtimin e kapaciteteve institucionale që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, përfshirë këtu krijimin e mekanizmave të ndryshëm dhe zhvillimin e aktiviteteve trajnuese;
4. Krijimin e mekanizmave raportues dhe monitorues, me theks të veçantë raportimin për mekanizmat ndërkombëtarë;
5. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile, dhe me theks të veçantë me Institucionin e Ombudpersonit.[163]

Megjithëse pas luftës, të drejtat e grave u riformuluan nën konceptet demokratike dhe parimet e të drejtave të njeriut, respektimi i plotë i tyre kufizohet jo vetëm nga mentaliteti patriarkal, por edhe nga vështirësitë në zbatimin e ligjeve. Megjithë ekzistencën e një kuadri të mirë ligjorë, vështirësitë në zbatimin e ligjeve, mungesat në strukturat zbatuese dhe fondet e pamjaftueshme, po vonojnë arritjen e synimeve për barazi gjinore. [164]

Sa u përket mekanizmave për barazi gjinore, Kosova radhitet në vendin e parë në rajon, mirëpo ekziston një zbrazëti e madhe në zbatimin e këtyre ligjeve dhe në funksionalizimin e mekanizmave për barazi gjinore. Këta mekanizma kanë mungesë të resurseve financiare dhe njerëzore. Nuk mjafton të miratohen ligjet dhe të themelohen mekanizmat. E gjithë kjo aparaturë ka nevojë të funksionojë, të njihet dhe të përkrahet...[165]

Atifete Jahjaga, thekson "...të drejtat e grave në Kosovë njihen vetëm në bazë ligjore, në praktikë ato nuk janë edhe aq mirë të jetësuara dhe janë ende larg standardeve ndërkombëtare..." Ndërsa, "Sigurimi i plotë i barazisë gjinore nuk duhet të konsiderohet një problem vetëm i grave, por i të gjithë shoqërisë, as vetëm i një organizimi apo institucioni, por i të gjithë instancave të shtetit, pasi vetëm atëherë dhe në këtë mënyrë do të mund të thyhen barrierat dhe të arrihet në realizimin e një barazie të vërtetë**.**[166]

Maria Fihl-Vetting, mendon se "Kosova ka legjislacion shumë modern, kuotën gjinore në parlamentin e Kosovës, po ashtu ekziston edhe grupi jo formal i grave të parlamentit dhe nëse iu duhet ndihmë do të bëjnë që së bashku me meshkujt të punojnë dhe të arrihet një zgjidhje.[167]

[163] Shih Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (2009-2011), Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008.
[164] PKBGJ Fq.15 dhe 16
[165] Flora Macula: Si ta ndryshojmë imazhin e gruas, Revista Teuta, Prishtinë, dhjetor 2008, fq.14.
[166] Intervistë me Atifete Jahjaga, shkurt 2009.
[167] Intervistë me Maria Fihl-Vetting, shkurt 2009.

Sipas, Susanne Backstedt, nuk është e thënë vetëm të përpilohen ligjet dhe te miratohen ato ligje, zbatimi nënkupton që edhe njerëzit në rrugë të dijë si të sillen me njëri tjetrin, unë do të doja të flisnim për ndërtimin e shoqërisë sepse atëherë do të zbatohen ligjet. Atëherë kur njerëzit në rrugë mësojnë se çka është Rezoluta 1325 ata duhet të sillen në mënyrë si kërkon Rezoluta 1325… Është temë e vështirë të punohet sepse merr mjaftë kohë të punosh në lidhjet mes njerëzve të formosh një kod të sjelljes dhe mendoj se pikërisht kjo është strategjia që ne duhet ta bëjmë së bashku.[168]

Theodora Krumova, thekson: "Mendoj se duhet të rishikohen këto ligje pas disa kohe, ndoshta do të ishte mirë qe kur të rishikohen të futet edhe Rezoluta 1325 dhe të përmbushen hapësirat që kanë mbetur sepse teoritikisht janë shumë mirë por të bëhen ne atë mënyrë që të zbatohen praktikisht. Ndoshta zbatimi pastaj do të jetë më i suksesshëm, mendoj se ka akoma ligje që janë po ashtu shumë të rëndësishëm që do të mundësonin edhe fuqizimin e grave në ekonomi, në vendimmarrje, qasjen e grave në trashëgimi.[169]

4. Shoqëria Civile në Kosovë

Një aspekt i dallueshëm i shoqërisë civile në Kosovë është lidershipi i organizatave dhe OJQ-ve të grave, të cilat kanë punuar në mënyrë të koordinuar në nivel të terrenit dhe janë rrjetëzuar në mënyrë përmbajtjesore në proceset e Shërbimit Civil dhe të qeverisë, duke ofruar edukim dhe përkrahje lidhur me pjesëmarrjen e grave. Kjo pjesë e raportit fokusohet ekskluzivisht në organizatat e grave, edhe pse ato përbëjnë vetëm një sektor të shoqërisë së gjerë civile në Kosovë. [170]

Shumica e përfaqësuesve të shoqërisë civile që kemi intervistuar[171] dëshmonin një nivel të caktuar të të kuptuarit të kornizës ligjore ndërkombëtare për arritjen e barazisë gjinore: Rezolutës 1325, CEDAW dhe Platformës Vepruese të Pekinit. Brenda organizatave të grave, kjo kornizë është e rëndësisë së veçantë. Aktivistet Kosovare ishin të përfshira në hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore dhe në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013.

Megjithatë, ky proces i përkrahur nga UNIFEM-i bazohej fuqimisht në mjetet ligjore ndërkombëtare për avancimin e të drejtave njerëzore të grave dhe në lidhjet ekzistuese me rrjetet ndërkombëtare të avokimit, disa prej të cilave ekzistonin edhe para vitit 1999.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK), i formuar në vitin 2000, fillimisht ishte një rrjetë joformal i grupeve të grave dhe organizatave nga regjione të ndryshme të Kosovës, nga i cili u zhvillua në një rrjet që avokon për të drejtat e grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. RRGGK grupon 87 organizata të grave që përfaqësojnë të gjitha grupet etnike dhe komunitetet e ndryshme në tërë Kosovën. Misioni i RRGGK është të "mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga

[168] Intervistë me Susanne Backstedt, shkurt 2009.
[169] Intervistë me Theodora Krumova, shkurt 2009.
[170] Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 21:- Sidoqoftë, shumica e organizatave të shoqërisë civile janë të vogla dhe varen kryesisht nga donacionet e huaja. Kjo do të thotë se agjenda e shoqërisë civile kryesisht është e dirigjuar nga donatorët. Qeveria nuk ka një qasje strategjike për ndërveprim me organizatat e shoqërisë civile. Përgjithësisht, shoqëria civile mbetet e dobët.
[171] Nga intervistat e kryera në vitin 2007, nga RRGGK, Kosovë.

orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, mosha, orientimi seksual apo aftësitë e tjera. RRGGK përmbush nivelin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, avokimeve dhe hulumtimeve".[172] Grupet anëtare të rrjetit vijnë nga një varg i gjerë i sektorëve socialë, përfshirë arsimin, zhvillimin ekonomik, shërbimeve psiko-sociale, nevojat speciale, ndërtimin e kapaciteteve, hulumtimet dhe studimet gjinore, grupet që punojnë rreth dhunës në baza gjinore dhe grupet që ofrojnë avokim dhe përkrahje ligjore.

Siç sqaron Drejtoresha Ekzekutive e RRGGK-së, Igballe Rogova, Rezoluta 1325 është shfrytëzuar nga aktivistet Kosovare si mjet për të obliguar agjencitë hezituese ndërkombëtare të hyjnë në dialog me grupet e grave në Kosovë: (në vitin 1999)... para se të kthehesha në Kosovë nga largimi me dhunë, isha shumë e ngazëllyer për arsyen që OKB-ja do të administrojë me Kosovën sepse pritja shumë nga ta, dhe mendoja se ata do të respektojnë të drejtat e grave, dhe do të implementojnë të gjitha deklaratat, por ...kur erdha në punë që nga dita e parë e kuptova se ata plotësisht injoronin lëvizjen e grave dhe gratë udhëheqëse nga Kosova. Ne kishim gra në politikë, gra shumë të fuqishme, dhe gra në shoqërinë civile, gjithashtu gra shumë të guximshme, të cilat u injoruan, atëherë mendova si mund të ndryshojmë këtë gjendje? Filluam me organizimin e takimeve me qëllim të avokimit ...dhe thjesht për të thënë "na dëgjoni", dhe më pastaj kur OKB nënshkroi Rezolutën, ne kishim një mike në një organizatë të caktuar, Komisionin e Grave për Gra dhe Fëmijë Refugjatë, Znj. Maha Muna, e cila nga kjo organizatë u dërgua për të punuar në UNIFEM. Ne po i tregonim komisionit të grave se çfarë por ndodhte në Kosovë dhe se gratë po injoroheshin, dhe Maha na tha që të përdorim Rezolutën. Kështu që në vitin 2000 ne filluam të shfrytëzojmë rezolutën dhe të avokojmë, t'i shkruajmë letra OKB-së, madje edhe OKB-së në Nju Jork, duke u thënë që kjo rezolutë duhet zbatuar.[173]

Organizatat e grave kosovare kanë dhënë kontribut drejtpërdrejt për zbatimin e Rezolutës 1325 në takime të ndryshme zyrtare dhe joformale, trajnime, protesta dhe përmes projekteve, rrjetëzimit lokal, rajonal dhe ndërkombëtar si dhe lobimit.**,** unë mendoj, thekson Behar Selimi, se shoqëria civile po punon mjaftë në këtë drejtim gjë që institucionet e Kosovës akoma kanë nevojë të vetëdijesohen lidhur me Rezolutën 1325..., sepse kjo Rezolutë nuk është dokument deklarativ por ka karakter mandator, mendoj se ne nivel të institucioneve duhet punuar me shumë.[174] Ndërsa, Atifete Jahjaga, thekson se "si qytetare e Kosovës jam jashtëzakonisht e kënaqur me angazhimin dhe rezultatet e shoqërisë civile lidhur me avokimin e realizuar për të drejtat e njeriut dhe grave, me theks te veçantë të Rezolutës 1325, mirëpo natyrisht se nuk ka vend për vetëkënaqësi, me rëndësi diçka ka filluar të lëvizë dhe kjo paraqet nismën e cila është premtuese.[175]

Aktivitetet e organizatave të grave përfshijnë ndihmën e dhënë për viktimat e dhunës seksuale të shkaktuar gjatë luftës, dhunës në familje dhe trafikimit. Aktualisht, organizatat anëtare të RRGGK ndërlidhen rregullisht dhe lobojnë tek zyrat qeveritare të të gjitha niveleve, si individualisht ashtu edhe nën ombrellën e RRGGK. Grupet e grave janë i vetmi sektor i shoqërisë kosovare që në mënyrë eksplicite dhe konsistente adreson Rezolutën 1325 si parim operativ që integrohet në punën e tyre. Si rezultat i drejtpërdrejt i kësaj, në vitin 2007, RRGGK ka filluar një seri të bisedimeve me forcat e KFOR-it të stacionuara në Kosovë lidhur me mënyrën se si dhe përse është e rëndësishme Rezoluta 1325 për misionin e tyre. Megjithatë, lobimi i përgjithshëm për fuqizimin dhe avancimin e grave në Kosovë mbetet jo i vlerësuar nga

[172] Shih Ueb-faqen e RRGGK, http://www.womensnetwork.org
[173] Intervistë me Igballe Rogovën, korrik 2007.
[174] Intervistë me Behar Selimin, janar 2009.
[175] Intervistë me Atifete Jahjaga, janar 2009.

bashkëpunimi i pamjaftueshëm i institucioneve vendore dhe komunitetit ndërkombëtar me grupet e grave.[176]

Nga intervistat bëhet e qartë se ekziston një zbrazëti e shpeshtë në komunikim mes shumë administratorëve ndërkombëtarë dhe grupeve të grave, edhe pse në sipërfaqe zakonisht ekziston një vullnet i dukshëm për të konsultuar dhe diskutuar, kjo është arritur përmes përpjekjeve të shumta nga ana e RRGGK-së. Megjithatë, administratorët ndërkombëtarë kanë qenë të ngadalshëm në sigurimin e përkrahjes së vazhdueshme për iniciativat e ndërmarra nga grupet e shoqërisë civile, për të shtyrë më tej qasjen e barabartë të grave në rrjedhat zhvillimore dhe në të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Sigurisht se kjo reflekton mungesën e përgjegjësisë së drejtpërdrejt të administratorëve ndërkombëtarë ndaj opinionit publik kosovar dhe faktin që parimet ndërkombëtare ligjore të të drejtave të njeriut, përfshirë barazinë gjinore, duhet të fitojnë shumë më shumë përkrahje praktike se sa përkrahje retorike që aktualisht është duke u ofruar nga komuniteti ndërkombëtar. Gjatë diskutimit të pengesave me të cilat përballet zbatimi gjithëpërfshirës i Rezolutës 1325, Drejtoresha Ekzekutive e RRGGK sqaron: Pengesa kryesore në zbatimin e Rezolutës 1325 është në faktin që... Rezoluta fuqimisht kërkon përfshirjen e grave në pozitat vendimmarrëse, posaçërisht në negociatat paqësore. Por liderët në nivelet vendore dhe ndërkombëtare nuk ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për gratë ...me të vetmen arsye se ata mendojnë që është obligim i meshkujve të bisedojnë për paqen, ndërsa rezoluta përmban shumë nene të cilët duket se për OKB-në janë të pamundshëm për tu zbatuar. Për shembull, një nen i qaset luftës kundër trafikimit. Por ... kudo që shkojnë forcat ushtarake, shtohet trafikimi. Kështu që kjo ndikon në moszbatimin e planit të tyre, për të zbatuar në plotësi Rezolutën 1325.[177]

Detyra jonë ka qenë informimi i shoqërisë se ekziston Rezoluta 1325 kurse me monitorimin e kësaj Rezolute në Qeveri do të duhej të merrej Agjencia për Barazi Gjinore dhe gratë në parlament.[178]

Duke e njohur punën efikase të organizatave që funksionojnë në terren, Flora Macula sugjeron që duhet të ketë edhe më shumë punë të OJQ-ve në këtë drejtim, të mblidhen fakte dhe argumente, të cilat do ndihmojnë avokimin në fushën e caktuar. Ka nevojë për ngritje të kapaciteteve të organizatave në vende jashtë rajonit të Prishtinës edhe atë në komunikim, avokim, dhe strukturave organizative, në mënyrë që të ngritet cilësia e organizatave në fushën e programatikes dhe performancës.[179]

Përkundër faktit se OJQ-të aktive të grave kosovare me sukses kanë parashtruar një varg çështjesh të rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë e grave gjatë tetë viteve të fundit, në përgjithësi ato nuk përfillen nga institucionet qeveritare, ndaj ndikimi i tyre në sektorin e sigurisë mbetet i zbehtë.[180]

Gratë nga shoqëria civile luajnë një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e vendimmarrësve për Rezolutën 1325. Kjo bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si p.sh: takimet me vendimmarrësit, organizmi i debateve në media, organizimi i trajnimeve dhe protestave,

[176] Po aty.
[177] Po aty.
[178] Intervistë me Igballe Rogoven, shkurt 2009.
[179] Intervistë me Flora Maculën, korrik 2007.
[180] Monitorimi i sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë, 2007, fq. 7. www.kgscenter.org

projekteve, rrjetëzimeve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare, nëpërmes të cilave lobuan në promovimin e implementimit të kësaj Rezolute.

Gratë aktiviste përdoren Rezolutën 1325 si mjet avokues për pjesëmarrjen e grave në bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës.[181]

Megjithëse jepen edhe konstatime, thekson respodenti nga UNHCR Shpend Halili, se niveli i përfaqësimit, përkatësisht i angazhimit publik i femrës në Kosovë është i kufizuar, mendojmë se ekziston edhe bindja se megjithatë janë për t'u dalluar edhe përparime të suksesshme. Sigurisht se pasja e qëllimeve më të larta e bën më pak të dukshëm suksesin, por i cili në fakt është i pranishëm. Është me rëndësi gjithashtu edhe pjesëmarrja kualitative në institucione dhe në vendim-marrje, kundruall përfaqësimit kuantitativ.[182]

Virgjina Dumnica, thekson se ka organizata të cilat merren me barazi gjinore kurse brenda organizatës se tyre nuk kanë punonjës meshkuj nëse lëvizja e grave është e fuqishme duhet involvuar dhe meshkujt për të qene më e fuqishme. [183]

Mendoj, thekson Blerta Bejtullahu, se është dashur të punohet më shumë, duhet që shoqëria civile të jetë ndjekëse, të jenë ata që ngrisin zërin, ...nuk mund të them se nuk është punuar mirëpo mund të bëhet më shumë.[184]

Krahas administrimit ndonjëherë të tepruar nga agjencitë ndërkombëtare, u ripërtëri dhe rithemelua Lobi i Grave Kosovare; Lobi Rajonal i Grave për Evropën Juglindore-(LRG EJL)[185]; e veçanërisht duhet përmendur rikrijimin e lidhjeve me gratë nga Serbia, si masa të domosdoshme drejt ndërtimit të një shoqërie civile kohezive.

Lobi Rajonal i Grave për Evropën Juglindore është themeluar në vitin 2006 dhe përbëhet nga 27 politikane dhe aktiviste nga shtatë vende të Evropës Juglindore-EJL-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Lobi është i zotuar në thellimin e sigurisë njerëzore, promovimin e të drejtave të grave dhe pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse si dhe thyerjen e barrierave të politikave etno-centrike.

Përkundër miteve ekzistuese në fushën e politikës ndërkombëtare, thekson Igballe Rogova, zhvillimi dhe rindërtimi i paqes, sigurisë dhe në veçanti pajtimi, nuk mund të blihet. Donatorët nuk mund të "blejnë" pajtim të mirëfilltë, e as qe mund të përcaktojnë hapin e pajtimit. Pajtimi paraqet një proces të cilit i duhet shumë kohë, durim dhe përkushtim ndaj ndërtimit të mirëbesimit mes të gjitha palëve të përfshira. Lobi Rajonal i Grave është dëshmi e këtij procesi. Ne nuk jemi formuar menjëherë dhe sipas kërkesës së donatorëve por jemi zhvilluar organikisht me kalimin e kohës. Së pari na është dashur ta diskutojmë të kaluarën dhe historitë tona, për të kuptuar qëndrimet dhe pozicionimet e njëra tjetrës. Pajtimi do të vije kur qytetarëve tu sigurohet hapësira e duhur për të diskutuar mbi të kaluarën e tyre, për dhimbjet, gëzimet, shpresat dhe të

[181] Monitorimi i sigurisë në Kosovë nga perspektiva gjinore, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë, 2007, fq. 8. www.kgscenter.org
[182] Intervistë me Shpend Halili, shkurt 2009.
[183] Intervistë me Virgjina Dumnica, shkurt 2009.
[184] Intervistë me Blerta Bejtullahun, shkurt 2009.
[185] Shih: Zëri i Gruas Kosovare Vëllimi VI, Numri 3, gusht 2008 – nëntor 2008.
Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 2 prill 2008 - qershor 2008, www.Womensnetwork.org Edita Tahiri nga Kosova është zgjedhur Kryesuese e Lobit Rajonal të Grave për Paqe, Drejtësi dhe Siguri në Evropën Juglindore.

ardhmet e tyre. Ne nuk mund ti detyrojmë qytetarët të lëvizin përpara në rast se ata nuk janë vetë të gatshëm, deri sa të mos i kenë zgjedhur çështjet e së kaluarës.

Për këtë arsye themi se drejtësia ndihmon procesin e pajtimit. Kur njerëzit kuptojnë se kriminelët përndiqen dhe sillen para drejtësisë përmes proceseve transparente, ata do të jenë në gjendje të gjejnë mirëkuptim dhe do të kenë mundësi të jetojnë në qetësi jetët e tyre... Vetëm pasi që të jetë zbatuar drejtësia në mënyrë transparente dhe përmes një procesi të hapur njerëzit do të mund të rikthejnë besimin e tyre dhe të lëvizin drejt një të ardhme të përbashkët. Vetëm atëherë ne do të mund të kemi paqe dhe siguri në rajon. [186]

Importimi i ideve dhe agjendave të panjohura pa konsultim të mjaftueshëm paraprak, stimuloi dhe ndonjëherë provokoi një reagim më koherent dhe të determinuar nga rrjetet e grave se sa që ndoshta do të mund të arrihej brenda tetë vitesh nën kushte normale.

Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi Kalimtare në EJL (LRG) me përkrahje të UNIFEM-it, më 27 tetor 2008, në Prishtinë organizoi konferencën e parë publike me titull "Një e ardhme e sigurt për rajonin tonë: Çka duhet bërë për të arritur atje? Gratë lidere flasin"

Konferenca rezultoi me një deklaratë të miratuar nga anëtaret e LRG-së për paqe dhe siguri në EJL, që do të dorëzohej Këshillit të Sigurimit të OKB-së në nëntor të vitit 2008.[187]

Një delegacion i LRG-së u takua edhe me Presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu, dhe disa anëtare u paraqiten në dy debate televizive. Gjatë konferencës, anëtaret e LRG-së identifikuan prioritetet në vijim:

- Luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe dhunës në rajon;
- Trajtimi i rëndësisë që ka varfëria në vazhdimin e pasigurisë dhe jostabilitetit rajonal; dhe
- Përqendrimi në drejtësinë kalimtare, roli dhe rëndësia e forumeve të tregimeve të vërteta për pajtim në rajon.

Përveç anëtarëve të LRG-së, konferencën e përshëndeti edhe Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, Ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, Ministrja e Energjisë dhe Minierave, Justina Pula, dhe përfaqësues të EULEX-it dhe ZCN-së. [188]

BIRN ka përgatitur një dokumentar që u shfaq në Konferencën e Lobit Rajonal të Grave, më 27 tetor 2008 Qëllimi i këtij dokumentari ishte që të prezantohet puna e anëtareve të LRG dhe të jap mesazhin tek publiku më i gjerë lidhur me rolin e gruas si politikane dhe përpjekjet e tyre për të arritur një paqe të qëndrueshme.

Përmes këtij dokumentari u dha mesazhi që gratë në Regjionin e Ballkanit Perëndimor punojnë së bashku pavarësisht nga kombi, religjioni, besimet e tyre. Gratë shkëmbyen shqetësime dhe ceshtje të ngjashme lidhur me të Drejtat Njerëzore të Grave pavarësisht situatës aktuale politike dhe sociale. Po ashtu, nga dokumentari doli nevoja për të ngritur Zërin e Grave në regjion me vëmendje në rregulloret dhe çështjet politike dhe të sigurisë në nivelin ndërkombëtar, regjional dhe lokal si dhe tek vendimmarrësit.

---

[186] Citat nga Fjalimi i Igballe Rogoves, (më 27 tetor 2008-Prishtinë-Konferenca e Lobit Rajonal të Grave)
[187] Shih http://www.rwlsee.org/report. pdf.
[188] Shih Zëri i Gruas Kosovare Vëllimi VI, Numri 3, gusht 2008 – nëntor 2008 Shih http://www.rwlsee.org/report. pdf.

Me datën 11 Dhjetor 2008 emisioni “Jeta në Kosovë" lansoi fimin dokumentar "Lobi Rajonal i Grave" i cili u shfaq para një audience prej 450 personave si dhe mijëra teleshikuesve.

Megjithatë kapaciteti i grupeve të grave lokale për tu takuar dhe diskutuar në mënyrë proaktive paraqet një nga fuqitë e theksuara të shoqërisë civile Kosovare, siç është vërejtur në tryezën e rrumbullakët të organizuar në korrik (2007) për të diskutuar ”leksionet e mësuara nga tetë vite të UNMIK-ut”, dhe për të përgatitur rekomandimet për Misionin e ardhshëm të Bashkimit Evropian në periudhën pas vendimit për statusin final të Kosovës. Takimi mblodhi pjesëtarë të RRGGK-së dhe përfaqësuesve të agjencive ndërkombëtare dhe qeverisë. Diskutimet në tryezën e rrumbullakët paraqitën përmbledhje të të arriturave dhe parashtrimin e ideve nga organizatat e grave, dhe u nda në dy pjesë:

4.1 Të arriturat e diskutuara në tryezën e rrumbullakët (korrik 2007):

“Ne nuk jemi aty ku ishin para tetë vitesh.”

Hartimi i legjislacionit specifik për çështje gjinore që mbulon dhunën në familje, antitrafikimin, barazinë gjinore, familjen dhe luftën kundër diskriminimit edhe më tej ka përafruar cakun e arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, që do të mund të sillte përmirësime të theksuara sa i përket respektimit të të drejtave të grave dhe fëmijëve dhe marrëdhënieve mes gjinive në përgjithësi.

Unifikimi dhe fuqizimi i lëvizjes së grave Kosovare u paraqit si rezultat i administrimit nga agjencitë ndërkombëtare, siç u shpreh njëra nga gratë; neve “na u desh të punojmë së bashku kështu që u bashkuam”.[189]

Tryeza e rrumbullakët shqyrtoi përvojat e ndryshme të punës me agjenci ndërkombëtare mbi çështjet gjinore gjë që çka pati diskutime nga më të llojllojshmet.

Gjatë rikujtimit të “leksioneve të mësuara”, u shfaqën edhe komentet vijuese: ...me shpresë se Misioni i ardhshëm i BE-së në Kosovë do të jetë më i gatshëm se sa UNMIK-u për të shfrytëzuar kapacitetet ekzistuese, vullnetin dhe entuziazmin e OJQ-ve lokale që janë aktive në fushën e çështjeve gjinore në Kosovë, që si rezultat do të mundësonte bashkëpunim dhe partneritet në projektet e përbashkëta. Si rezultat, Misionit të ardhshëm të BE-së në Kosovë, do t’i vihen në dispozicion informata të shumta nga terreni, për të mundësuar kësisoj realizimin e politikave dhe projekteve më të mira, më të kuptueshme dhe më efektive (gjë që nuk u realizua gjatë administrimit të UNMIK-ut).

Një shembull ekstrem i “mundësive të humbura” mund të jetë organizata “Iniciativa e Grave të Kosovës” (KWI) e themeluar në korrik të vitit 1999. KWI u krijua pasi që Zyra për Popullatë, Refugjatë dhe Migrim e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara ofroi një grant prej 10 milionë dollarësh për Komisionin e Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë i cili duhej të zbatonte këtë projekt. Ideja ishte që të shfrytëzohej ky fond për të përkrahur nevojat e grave kosovare dhe për të ndihmuar në rigjenerimin dhe konsolidimin e organizatave ekzistuese të grave kosovare, të cilat ishin dëmtuar rëndë e në disa raste edhe shkatërruar plotësisht gjatë luftës së vitit 1999.

Megjithatë u bë një gabim flagrant, që eventualisht rezultoi me dështim të plotë të kësaj iniciative. Planifikimi i alokimit të fondeve u krye përmes një qasje “nga lartë poshtë”. Nuk pat

[189] Diskutimi në tryezë të rrumbullakët, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, korrik 2007.

kurrfarë konsultimi paraprak me akterët lokalë, të cilët do të mundësonin identifikimin e nevojave reale të grave kosovare dhe OJQ-ve të grave. Si rrjedhojë, pjesa më e madhe e fondeve u përdorën për të financuar kostot operative të partnerëve ndërkombëtarë të UNHCR-së. Pasojë tjetër ishte fakti që për shkak të mungesës së njohurive dhe informatave relevante lokale, pjesa tjetër e fondeve u shpërnda në baza *"ad hoc"* tek organizata të cilat i përmbyllën aktivitetet e veta pas shpenzimit të donacioneve dhe me ndërprerjen e rrjedhës së fondeve.[190]

Duke përmbledhur rekomandimet e diskutimit në tryezën e rrumbullakët, organizatori komentoi, "me qëllim të parandalimit të përsëritjes së gabimeve nga tetë vitet e kaluara është e domosdoshme që në të ardhmen misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë të merr parasysh përvojat e akterëve lokalë gjatë periudhës mes viteve 1999-2007".[191]

4.2 Rekomandimet nga tryeza e rrumbullakët (korrik 2007)

"*Nuk jemi duke filluar nga zero*"

Në këtë takim u theksuan konkluzionet për të cilat ekziston dëshira që të merren parasysh nga Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë, që pritet shpejt të vendoset në Kosovë:

1. Mekanizmat ligjorë dhe politikë janë të domosdoshëm për zbatimin e barazisë gjinore, por gjithashtu nevojiten edhe njerëz më të kualifikuar;
2. Akterët ndërkombëtar duhet të lejojnë pjesëmarrje më të gjerë dhe të kenë vullnet për të bashkëpunuar me vendorët;
3. Do të ishte maturi e vërtetë për Misionin e BE-së të mos fillojë me "lojën e fajësimit", do të thotë të mos fillojnë me paragjykime negative dhe të pavërtetuara lidhur me popullatën vendore;
4. Gratë nga shoqëria civile duhet të ndihmojnë aktivisht në formësimin e mandatit të Misionit të BE-së, duke qenë proaktive në krijimin e një "agjende gjinore" paraprakisht të miratuar nga të dyja palët;
5. Në planifikimin e misionit të BE-së duhet të jetë prezentë edhe perspektiva gjinore, dhe kjo duhet tu sqarohet akterëve lokalë që nga fillimi dhe të negociohet me ta;
6. Perspektivat gjinore duhet të përpilohen dhe mbrohen nga nivelet e larta të udhëheqësish së Misionit dhe jo të mbesin të ngujuara në nivele të cilat zakonisht mbulohen nga gratë;
7. Të mbizotërojë transparenca në të gjitha proceset administrative, ndërsa për këtë dhe për monitorim do të lobohet nga grupe të shoqërisë civile;
8. Ndarja e fondeve për të trajnime;
9. Duhet krijuar një grup punues ndërsektorial, i cili do të informojë stafin dhe punëtoritë lidhur me çështjet aktuale dhe leksionet e mësuara, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe komunikimi i hapur;
10. Duhet krijuar dhe mbajtur metoda të hapura të komunikimit me grupet e grave në baza të rregullta dhe në mënyrë të vazhdueshme;
11. Të gjithë akterët ndërkombëtarë duhet të konsultohen me grupe të grave lokale gjatë dizajnimit të programeve për përkrahjen e grave vendore.

---

[190] Luljeta Vuniqi, Mirëserdhët në Kosovë! Pjesa e dytë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, gusht 2007, f. 7. Për më shumë informata lidhur me këtë citat, shih Chris Corrin Auditimi Gjinor, Jock M. Baker dhe Hilde Haug Raporti Përfundimtar: Vlerësimi Ekstern I Iniciativës së Grave të Kosovës (2002).

[191] Luljeta Vuniqi, Mirëserdhët në Kosovë! Pjesa e dytë, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, gusht 2007, f. 7.

III. OBLIGIMET E REZOLUTËS 1325

Pjesa e dytë e këtij raporti mbi zbatimin e Rezolutës 1325 përmbledh rezultatet kryesore sipas neneve të Rezolutës, të cilat adresojnë fushat e rëndësishme të obligimeve:

- Përfshirja e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes;
- Perspektiva gjinore dhe trajnimi i policisë dhe personelit ushtarak;
- Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave;
- Përfshirja e perspektivës gjinore në raportet e OKB-së.

1. Përfshirja e Perspektivës Gjinore në të Gjitha Nivelet e Vendimmarrjes

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 ne nenin 1 "*Nxitë* Shtetet anëtare që të sigurojnë përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare si dhe mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve." Neni 8 *"Nxitë"* shtetet anëtare që të sigurojnë përfaqësim më të më madh të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare si dhe mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

Edita Tahiri, ishte gruaja e vetme e pranishme gjatë negociatave të Rambujesë[192]. Ajo kishte thënë se ...duke u angazhuar në procesin e dezintegrimit të Jugosllavisë duke tentuar të realizonim ëndrrën tonë për Pavarësinë e Kosovës... në atë kohë nuk ndjeja kurrfarë diskriminimi gjinor, ndonëse ulesha në takime vetëm me meshkuj, madje edhe në Rambuje... Atëherë nuk e kam ndjerë këtë dallim dhe diskriminim gjinor.[193]

Atmosfera e pasluftës në Kosovë, megjithatë, ishte e karakterizuar me margjinalizim të shtuar të grave në të gjitha sferat dhe me presione shoqërore për t'iu përshtatur roleve më tradicionale: Pas luftës, ishte një çlirim i kësaj barre të okupimit, meshkujt ishin agresivë dhe gratë ishin të margjinalizuara, madje edhe unë.[194]

Optimizmi i grave aktiviste me arritjen e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë shpejtë u konfrontua me mungesën e vetëdijes dhe interesin e administratës së lartë ndërkombëtare për të përkrahur dhe praktikuar përfshirjen e çështjeve gjinore. Jo vetëm që gjinia anashkalohej të njihej nga nivelet më të larta të proceseve vendimmarrëse ndërkombëtare, por edhe stafi i gatshëm për të punuar në proceset e përfshirjes të çështjeve gjinore nuk inkurajohej dhe në këtë mënyrë përfshirja e çështjeve gjinore si parim i politikbërjes dështoi. [195]

Aktivistet Kosovare dhe organizatat joqeveritare kanë pritur që administrata e OKB-së do të përkrahte në mënyrë aktive dhe do të bashkëpunonte me aktivistet vendore. Duke diskutuar mungesën e përfaqësimit të grave në bisedimet aktuale për përcaktimin e statusit final të Kosovës, Igballe Rogova theksonte:… ekziston kjo mungesë e vullnetit politik... në fillim jemi

[192] Marrëveshja e Rambujesë, e hartuar nga forcat e NATO-së në mars të vitit 1999, e cila e përfundoi luftën, kishte referenca të seksit apo gjinisë vetëm në Kapitullin 2, "Policia dhe siguria e popullatës civile, nenin 1, Parimet e përgjithshme.
[193] Intervistë me Edita Tahirin, korrik 2007.
[194] Intervistë me Edita Tahirin, korrik 2007.
[195] Për ta rregulluar si duhet?; Qasja gjinore në Administratën e UNMIK-ut 2001 në Kosovë, Kvinna Till Kvinna.

munduar me dërgim të letrave, pastaj organizuam protesta në rrugë... ishte minus 20 gradë celsius kur mbajtëm protestë në ambient të hapur me këngë, performancë dhe me një flamur të madh që kishte mbishkrimin Rezoluta 1325 na jep të drejtën që të jemi pjesë e ekipit negociator. Parulla qëndroi në muret e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës për 6 apo 7 muaj. Ishte periudha kur ne kishim filluar Koalicionin paqësor të grave me Gratë në të zeza të Serbisë. Vendosëm të fillojmë këtë koalicion sepse, pikësëpari, nuk kishte femra në ekipin tonë negociator, ndërkaq, ato e kishin një grua por ajo nuk përfaqësonte të gjitha gratë e Serbisë, andaj ato kishin ndjenjën se nuk kishin përfaqësim të denjë të gruas. Prandaj ne organizuam protesta në të njëjtën kohë, në të njëjtën orë, në Prishtinë dhe në Beograd, pastaj vazhduam të punojmë së bashku. Mendonim se nëse ne, gratë, nuk mund të jemi në ekipin negociator, mund të aplikojmë (një) zë alternativ dhe mund të sjellim perspektivën e gruas në negociata. Si? Shkruam deklarata para se ata të takoheshin atje, në Vjenë, dhe në çdo deklaratë që e dërguam përmendëm Rezolutën 1325, në çdo letër, dhe me Koalicionin paqësor të grave, dërguam deklarata mbi atë se çfarë mendojmë ne për statusin e Kosovës, kështu që ne e përdorëm Rezolutën dhe në të gjitha letrat që i dërguam shfrytëzuam hapësirën për të përmendur 1325. Mendoj se kjo Rezolutë na ndihmoi që të kemi një takim të veçantë me të Dërguarin Special i cili ishte në krye të procesit negociator, Martti Ahtisaarit, sepse ai na aprovonte ftesën çdo herë që kërkonim takim me të. Gjatë vitit 2006 u takuam 4 herë me të, edhe pse zyrtarisht na mungonte ky përfaqësim. [196]

Kur në vitin 2001, Kryetari i Këshillit të Sigurimit të OKB-së vizitoi Prishtinën dhe takoi gratë vendore përfaqësuese të OJQ-ve, ai mirëpriti përpjekjet e lëvizjes së grave në Kosovë për promovimin e pajtimit dhe bashkëpunimit ndërgrupor. Megjithatë, për shumë gra të shoqërisë civile, "ky gjest diplomatik nuk u kthye në pjesëmarrje më cilësore të grave në nivel të mesëm dhe të lartë të procesit të ndërtimit të paqes atëherë – apo tani."[197]

Si organe vendimmarrëse përfundimtare në Kosovë, UNMIK-u dhe agjencitë e OKB-së si dhe organizatat tjera ndërkombëtare në Kosovë, pritej të jenë shembull për institucionet vendore duke zbatuar Rezolutën në tërë procesin e negociatave për status dhe mjetet relevante ndërkombëtare për barazi gjinore. Ndonëse PSSP-ja, Soren Jessen Petterson, dëshmoi përpjekje të kufizuara në asistimin e grave të Kosovës duke sjellë ZCGJ në nivelet më të larta brenda strukturave të UNMIK-ut dhe duke i dhënë atyre kompetenca për të kryer punën e tyre. Mungesa e përgjithshme politike në emër të Petersonit, i cili zotëronte fuqinë për të ndikuar në përbërjen e ekipit negociator, ishte dëmtuese për sa i përket përfshirjes së grave në proceset negociatore.[198] Krijimi i Grupit të Unitetit me udhëheqës të partive politike të cilët posedonin vende të fituara në Parlament, përfshirë kryetarin e parlamentit dhe Kryeministrin, parashihte përfshirjen e një përfaqësuesi të shoqërisë civile. Përzgjedhja e një mashkulli, (Kryeredaktorit të gazetës ditore *Zëri*, Blerim Shala), për të zënë këtë pozitë, ishte shembull i qartë i përjashtimit të grave nga nivelet politike dhe të shoqërisë civile gjatë proceseve të negociatave paqësore.[199]

Në përgjithësi, shumica e zyrave ndërkombëtare dhe një bollëk pozitash me "përgjegjësi gjinore" duket të jenë dobët të menaxhuara pa plane të mirëfillta të veprimit dhe pa synime të qarta, që nuk rezultoi në përfshirje të çështjeve gjinore, por në margjinalizim të mëtutjeshëm dhe trajtim të çështjeve dhe shqetësimeve të grave si çështje të buta krahasuar me agjendat

[196] Intervistë me Igballe Rogova, korrik, 2007.
[197] Monica Llamazares, Femrat e Kosovës: Lidhjet që mungojnë në ndërtimin e dështuar të paqes së pasluftës.
[198] Intervistë me Luljeta Vuniqi, korrik 2007.
[199] Intervistë me Igballe Rogova, korrik 2007.

dhe ambiciet më të mëdha politike “dhe në një atmosferë të konkurrencës dhe territorialitetit në mes të aktorëve të shumtë.”[200]

Veç kësaj, Luljeta Vuniqi, Drejtoresha ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), theksoi se ka pak mirëkuptim të rëndësisë së punës së shoqërisë civile dhe vullnet të rrallë politik për të ndërtuar partneritete me organizatat e grave për të ndihmuar në lehtësimin e udhëheqësish femërore dhe hyrjen e tyre në role vendimmarrëse. Fitohej përshtypja se agjencitë ndërkombëtare vijnë në Kosovë me pikëpamje paragjykuese dhe shumë shpesh në baza të përkohshme. Financimi për projekte të ndryshme është i kufizuar nga donatorët të cilët shpesh kanë agjenda të tyre politike. Kështu, krahas varësisë së shoqërisë civile në donacione ndërkombëtare, nuk ofrohet asnjë përkrahje nga strukturat e institucioneve vendore.[201]

Pjesëmarrja e vogël e grave në vendimmarrje duket edhe në raportin 1 me 10 në favor të meshkujve në poste udhëheqëse në administratën publike. Gjithashtu, statistikat tregojnë se përqindja e grave të punësuara në institucionet qendrore dhe lokale është vetëm 35.6%. Struktura gjinore në postet udhëheqëse në komuna është 25%... Niveli i ulët i përfaqësimit të grave në strukturat vendimmarrëse është tregues i faktit se aspiratat dhe nevojat e grave janë jo të përfaqësuara denjësisht dhe se gratë kanë pak mundësi për të nxitur politika që adresojnë probleme të grave përfshirë edhe varfërinë e pabarazinë gjinore apo të përmirësojnë statusin dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik e social të vendit.[202]

Rezultati i Anketës së Fuqisë Punëtore 2007 shpalosi një shkallë papunësie prej 43.6% (meshkuj 38.5%, femra 55.2%), një shkallë aktiviteti prej 46.5% (meshkuj 65.2%, femra 28.3%) si dhe një shkallë punësimi prej 26.2% (meshkuj 40.1%, femra 12.7%). Rreth 30.000 të rinj hyjnë në tregun e punës për çdo vit. Me shkallën aktuale të rritjes, ekonomia nuk mund ta thithë këtë fuqi punëtore të re në shtim. [203]

UNMIK-u, punësoi relativisht femra dhe asnjëherë punësimet nuk ishin të bazuara në perspektivë gjinore por bazoheshin në faktin nëse ajo ishte e re, e bukur, me një njohuri të vogël të gjuhës angleze. Ku janë profesionistet? Ne kishim shumë femra të diplomuara. Kishim shumë gjenerata të arsimuara, por UNMIK-u asnjëherë nuk bazohej në këtë fakt. Ata sillnin ekspertë të fushave të ndryshme, dhe kjo për shkak se nuk kishin informata të cilat mund t’i merrnin bazuar në hulumtime të cilat duheshin të kryheshin për vendin në të cilin shkonin.[204]

Arsyeja e tretë ishte besimi se kultura kryesisht mashkullore në pozitat kyçe të strukturave të UNMIK-ut dobëson kapacitetin e administratës për të siguruar përfshirjen e grave në

[200] Po aty.
[201] Intervistë me Karl Kulessa, Nëntor, 2007.
[202] PKBGJ, fq. 21
[203] Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 32. Shih Po aty, fq. 44. Papunësia në Kosovë sipas shënimeve në Kosovë sillet në 43% të popullatës ekonomikisht aktive. Gjithsej 334,595 persona (krahasuar me 327,262 persona në 2006) janë regjistruar si të papunë nga shërbimet publike për punësim në Kosovë në vitin 2007; 93% e të regjistruarve si punëkërkues janë regjistruar për më shumë se 12 muaj... Në mesin e të papunësuarve afatgjatë, grupet më të pafavorshme janë gratë, romët, ashkalinjët, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara. Sistemi aktual i përfituesve me aftësi të kufizuara ndikon në destimulimin e personave me aftësi të kufizuara që dëshirojnë të kërkojnë punë; përfitimi për personat me aftësi të kufizuara është gjendje në dispozicion për ata që nuk punojnë ose marrin pjesë në trajnime profesionale. Një fushë për shqetësim është punësimi i femrave. Gratë e reja ballafaqohen me papunësi më të madhe sesa meshkujt dhe më shpesh janë në rang shoqëror më të ulët.
[204] Intervistë me Lumnije Deçani, korrik 2007.

vendimmarrje. Që nga fillimi i misionit, të pesë PSSP-të ishin meshkuj, siç ishin edhe të gjithë Zëvendësit Kryesorë dhe Zëvendësit e PSSP-së. Kryesuesit e misionit dhe Zëvendës Kryesuesit e Misionit të shtyllave tjera ishin të gjithë meshkuj, ndërsa në pozitën e Drejtorëve të Departamenteve femrat emëroheshin herë pas here.

Agjencitë e OKB-së, siç janë, UNICEF, UNIFEM, UNFPA, UNHCR dhe UNDP, kanë pasur tendencë që të kenë më shumë femra në pozitat kyçe, por fillimisht ishin të përjashtuara nga pjesëmarrja në diskutimet e nivelit më të lartë dhe vendimmarrës të UNMIK-ut në vitet hershme të pas konfliktit. Megjithatë, kjo situatë rrjedhimisht ka ndryshuar. Këto agjenci kanë praktika më të vazhdueshme dhe më të përqendruar në pajtim me të drejtat e gruas dhe dispozitat e Rezolutës së OKB-së 1325, përkundër faktit se ato në përgjithësi nuk i janë referuar kësaj të fundit në politikat operative.

Lidhur me përkrahjen thelbësore të UNIFEM-it në Kosovë për projektet vendore të organizatave të grave, Igballe Rogova thekson: Ato përkrahin iniciativa vendore dhe kjo është arsyeja pse i admiroj, admiroj zyrën e tyre në Prishtinë.[205]

Në nivelin vendor, LBGJ synon të krijojë përfaqësim të barabartë të meshkujve dhe femrave në të gjitha nivelet e organeve ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore, institucionet publike dhe emërime në qeverinë qendrore dhe lokale. Sipas LBGJ-së: Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit të jetë 40 %.[206]

Zgjedhjet e treta për Kuvend të Kosovës në nëntor të vitit 2007[207] mundësuan zgjedhjen e 36 grave parlamentare në Kuvendin e përbërë prej 120 vendesh. Gratë, po ashtu, zotërojnë 22%-28% për qind të vendeve të të gjitha kuvendeve komunale. Megjithatë, ka pak gra në pozita të larta vendimmarrëse. Ne këtë drejtim ne Qeverinë aktuale janë dy ministre (nga 17 ministri) dhe tri poste të zëvendës ministreve.

Në muajin nëntor 2007, RrGGK ka bashkëpunuar me OSBE-n dhe me UNIFEM-in për t'i nxitur e edukuar votuesit mbi sistemin e ri zgjedhor në Kosovë si dhe për gratë kandidate që garojnë për poste. Organizatat anëtare të RrGGK-së kanë organizuar takime ku kanë marrë pjesë mbi një mijë qytetarë që përfaqësojnë të gjitha grupet etnike përgjatë Kosovës.

---

[205] Intervistë me Igballe Rogova, korrik 2007.

[206] Shih Nenin 3 LBGJ: Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve sipas nenit 3, pika 3.1, arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

[207] http://www.democracy2007.net/

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave- Seria e kërkimeve politike: Analizë e Zgjedhjeve: Trendet dhe mësimet e nxjerra, Prishtinë, Shkurt 2008

Kuota gjinore dhe listat e hapura: Kosova ka pasur kuotë gjinore që nga zgjedhjet e para në vitin 2000. Si në zgjedhjet e mëparshme, secili grup i tre emrave në listën e kandidatëve duhet ketë një kandidat të gjinisë së ndryshme nga dy të tjerët. Mirëpo, pasi që më nuk listat e mbyllura, ky mekanizëm si i vetëm nuk mund të realizojë kuotën gjinore prej e për këtë arsye u pa si e nevojshme që të sigurohet e njëjta në një mënyrë tjetër. përfundim të numërimit të votave të kandidatëve, kandidatët e gjinisë më pak përfaqësuar do të përbëjnë së paku 30% të listës së riradhitur në bazë të votave. p.sh. tre kandidatët në krye të listët janë të një gjinie, atëherë kandidati i tretë largohet favor të kandidatit së gjinisë tjetër që ka numrin më të madh të votave të fituara. proces vazhdon deri sa kandidatët e secilës gjini kanë së paku 30% të vendeve të fituara. Kjo vlen si për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës ashtu edhe për zgjedhjet lokale.

Gjatë zgjedhjeve, RrGGK-së ka bashkëpunuar edhe me Komitetin Drejtues të Grave dhe me Anëtaret e Parlamentit për të diskutuar se si gratë në shoqërinë civile mund t'i mbështesin gratë në politikë për t'i gjetur votuesit gjatë fushatave të tyre parazgjedhore. Për këtë dhe për aspekte tjera të bashkëpunimit me gra në politikë, RrGGK ka marr mbështetje nga UNIFEM.

Gjatë takimeve, anëtarët e RrGGK-së kanë ofruar informata për përdorimin e ri të sistemit elektoral me lista të hapura, si edhe kanë shpërndarë një publikim me informata për gratë kandidate, publikim ky i përgatitur nga Qendra për Trajnim dhe Studime Gjinore. Përfaqësuesit e RrGGK-së janë shfaqur edhe nëpër debate të medieve lokale për të sqaruar sistemin elektoral.

Në muajin tetor dhe nëntor të vitit 2007, me mbështetjen e "Balkan Trust for Democracy", RrGGK filloi monitorimin e premtimeve të politikanëve dhe partive politike të bëra ndaj qytetarëve përmes mediave gjatë fushatave të tyre parazgjedhore, si edhe ka mbledhur platformat e partive politike. Në të ardhmen, RrGGK-ja do t'i përdorë këto për tu ndihmuar qytetarëve t'i mbajnë përgjigjes zyrtarët e zgjedhur për premtimet e tyre.[208]

… Unë luftova kundër korrupsionit dhe nepotizmit; sepse thashë se këto fenomene do ta shpien Kosovën në dështim (…) U mundova ta ndryshoj sistemin politik ashtu që njerëzit me kualitete të vijnë në parlament dhe qeveri... Nuk kishte sukses…[209]

Përkundër trajnimeve të shumta për kandidate politike nga viti 2002 dhe lidhjeve të krijuara në mes të udhëheqësve të komunitetit të grave dhe politikaneve femra akoma ka kritika të mëdha nga të dyja grupet në lidhje me performancën e njëri tjetrit mbi çështjet sociale dhe politike. Ndoshta kjo pasqyron shumë kontradikta në mes të teorisë dhe praktikës së standardeve të të drejtave të njeriut kur ato zbatohen në mënyrë jokonsistente. Sipas shumicës së të intervistuarve futja në përdorim e sistemit të kuotës për arritjen e barazisë gjinore në vitin 2001 nuk ka sjellë rezultatet e pritura dhe shqetësime të përgjithshme se gratë e zgjedhura në qeveri në cilindo nivel kanë tendencë të jenë relativisht të papërgatitura për të përfaqësuar vizionin e grave dhe punën për ndryshimin e kërkuar, siç e cek Edi Shukriu: Ajo që ne kemi arritur është vetëm 30 për qind të grave në parlament, që duket si një teatër, unë do të doja kishim gra në parlament, por gra të kualifikuara për të ngritur zërin e tyre për pozitën e gruas, gjë që fatkeqësisht nuk është duke ndodhur.[210]

Në pyetjen a janë gratë në parlament duke punuar mjaftë në zbatimin e Rezolutës 1325, Pauline Menthonex, mendon se "ndoshta do të ishte mirë të dihet sa janë meshkujt duke punuar në drejtim të zbatimit të Rezolutës 1325.[211]

Ndërsa, Virgjina Dumnica, mendon se gratë parlamentare "duhet te bashkëpunojnë me meshkujt që në njëfarë mënyre t'i edukojnë ata lidhur me çështjet gjinore... kurse ato edhe këtë nuk e bëjnë...

Disa respondentë thanë se pamja e përfaqësueseve gra të "heshtura" nuk është faktik por në fakt shumë gra në parlament duhet të imponojnë vetveten dhe të insistojnë në zënien e pozitave më të mira në qeveri. Në përgjithësi, pabarazia gjinore në proceset e vendimmarrjes

[208] Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 1 dhjetor 2007 - shkurt 2008, www.Womensnetwork.org
[209] Intervistë me Edita Tahiri, korrik 2007.
[210] Intervistë me Edi Shukriu, korrik 2007.
[211] Intervistë me Pauline Menthonex, shkurt 2009.

konsiderohej që domosdo fillon në partitë politike: Nëse partitë politike janë më të përqendruara, nëse ato do të kishin si prioritet ngritjen e pozitës së gruas brenda partisë, me siguri se do të kishim edhe gra në grupin negociator, do kishim më shumë ministre gra, në presidencë dhe kudo tjetër.[212]

Megjithatë, në parti të mëdha, siç janë PDK dhe LDK, nuk ka programe për zbatimin e Rezolutës të KS të OKB-së 1325. Është raportuar se gratë nuk e dinë se çka pritet nga kryesia, nuk janë të barabarta me meshkujt në kryesi dhe për më tepër janë të përjashtuara nga proceset vendimmarrëse.

… shumë gjëra nuk zbatohen në qeveri apo parlament. Meshkujt në kuvend akoma vendosin gjatë pauzave të kafesë me kolegët e tyre, kështu që në parlament nuk bëjnë asgjë.[213]

Secila parti politike i ka forumet e grave. Po, a janë ato vetëm simbolike apo kanë ndikim në vendimmarrje, mendoj, thekson Lulzim Fushtica, se është çështje që duhet të shqetësohemi sepse zakonisht në parti politike merren vendimet vetëm nga liderët e partisë.[214]

Përderisa përfaqësuesit e qeverisë mund të kenë njohuri themelore të Rezolutës 1325, hapat dhe strategjitë e zbatimit të saj nuk janë kuptuar sa duhet.

Ne jemi të margjinalizuar (…) jo se nuk kemi shkathtësi për t'u përballur me të gjitha problemet e shoqërisë kosovare, por për faktin se ne thjeshtë jemi të injoruara nga bota mashkullore.[215]

Mbizotëronte ndjenja se kjo përfundimisht do të përbënte vështirësinë që gratë e ndienin në paraqitjen e ideve të tyre; duke rrezikuar në vartësi të mëtutjeshme të tyre, margjinalizim dhe injorim, madje edhe nëse numri i grave në Kuvendin e Kosovës do të rritej në masë të konsiderueshme: Ne akoma nuk kemi mundësi kur jemi të diskriminuara brenda partisë që të ngrisim zërin për një vend në parlament. Nuk do të ishte (ndryshim) i madh edhe sikur të rrisnim numrin e grave në parlament deri në 50 për qind.[216]

Respodentja Nazlie Bala, thekson se: Sot kultura dhe mentalitetit politik në Kosovë kërkon kuantitet dhe asesi kualitet.[217]

Në anën tjetër, disa respondentë e shohin fushatën për të ndryshuar sistemin zgjedhor me lista të hapura si një hap pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset vendimmarrëse. Përkrahësit e sistemit me lista të hapura do të kërkojnë me ngulm cilësi dhe sasi, sepse një gjë e tillë do të dekurajonte dhe parandalonte korrupsionin gjatë emërimeve të kandidatëve:

"…ata emëruan lojalistë dhe u munduan të eliminojnë zërat e pavarur-zërat vizionarë; sepse ata menduan se janë rivalë potencialë për ta".[218]

Përkrahësit e intervistuar besojnë se forca shtytëse për ndryshime lokale dhe qendrore qëndron në nivele rrënjësore, dhe institucionet kosovare nuk tregojnë gatishmëri për ndryshime. Sektori

[212] Intervistë me Teuta Sahatçia, korrik 2007.
[213] Intervistë me Flora Brovinën, korrik 2007.
[214] Intervistë me Lulzim Fushtica, shkurt 2009.
[215] Intervistë me Flora Brovinën, korrik 2007.
[216] Po aty.
[217] Intervistë me Nazlie Bala, shkurt 2009.
[218] Intervistë me Edita Tahirin, korrik 2007.

joqeveritar konsiderohet të ketë përgjegjësinë për ndryshimin e strukturave qeveritare përmes lobimit të drejtpërdrejtë. Responendët theksuan një perspektivë përgjithësisht pozitive mbi arritjen e barazisë gjinore te qytetarët dhe besojnë se shoqëria përfundimisht do të pranojë gra si udhëheqëse të shtetit.

Ndonëse janë krijuar mekanizmat vendor strukturor për arritjen e barazisë gjinore, zbatimi i tyre mbetet i ngadaltë për shkak të kufizimeve financiare dhe duket se janë shumë të varur në nivelet e larta vendimmarrëse. Edita Tahiri tha se aktiviteti kulturor është thelbësor për ndryshimin e qëndrimeve publike ndaj gjinisë. Siguria dhe fuqizimi i grave nuk mund të arrihet pa pasur gra në pozitat më të larta vendimmarrëse që do të shërbenin si shembuj për shoqërinë:

...ne duhet të identifikojmë gratë më kulmore dhe t'i përdorim ato si shembuj për të tjerat, sepse nëse dëshirojmë të inkurajojmë dhe fuqizojmë gratë që të hyjnë në jetën politike apo aspektet tjera të jetës, të udhëheqin, inkurajojnë lidershipin e grave, ne duhet të identifikojmë modele të tilla.[219]

Megjithatë, për t'u zgjedhur në mënyrë të suksesshme brenda partisë dhe për t'u ngritur në zgjedhjet qendrore, gratë kanë nevojë për resurse dhe përkrahje logjistike:[220] Gratë në politikë në këtë vend nuk kanë para për të garuar për vende në parlament[221]

Thuhet se distribuimi i buxhetit të ndarë nga prioritetet e bashkësisë ndërkombëtare duhet të përfshijë asistencën financiare për gratë e përfshira në politikë. Aktualisht, buxheti i ndarë për brengat specifike gjinore synojnë të jenë të shpërndara në sektorët jopolitikë për shkak të kufizimeve në financimet e aktiviteteve politike.

Në nivelin komunal, pjesëmarrja e barazisë gjinore në Shërbimin Civil nuk është arritur. Gratë kanë pirje që më parë të punësohen në degët ekzekutive komunale sesa të zgjidhen në degët legjislative komunale: Është konkludim i përgjithshëm se ndonëse kuota prej 40 për qind është realizuar, përfaqësimi i grave në pozitat e larta menaxherial nuk është përmirësuar.[222]

Sipas Behar Selimit, "...kuota është ajo e cila ka sjellë përfaqësimin e femrës në proceset vendimmarrëse, ndoshta mund ta ketë dëmtuar cilësinë apo përfaqësimin kualitativ të femrës por mund të jetë edhe si pasojë e edukimit, varfërisë apo infrastrukturës. Mendoj, se kuota, derisa të krijohet mentaliteti i cili pa kuotë nuk do të kërkojë përfaqësim të femrës, kuota do të na ndihmojë shumë..."[223]

Pauline Menthonex, mendon se kuota është hapi i parë drejtë barazisë gjinore në çdo shtet qe është ne tranzicion,...kuota duhet të aplikohet edhe në forcën e re të Kosovës...[224]

[219] Intervistë me Edita Tahirin, korrik 2007.
[220] Intervistë me Flora Brovinën, gusht 2007.
[221] Intervistë me Edita Tahirin, korrik 2007.
[222] Roli i dhe funksioni i Zyrtarëve komunalë për barazi gjinore në Kosovë, OSBE, Departamenti për të Drejta të njeriut dhe sundim të ligjit http://www.osce.org/documents/mik/2006/11/22088_en.pdf
[223] Intervistë me Behar Selimin, janar 2009.
[224] Intervistë me Pauline Menthonex, shkurt 2009.

Unë i kam urryer kuotat, thekson Maria Fihl-Vetting, por sipas të gjitha hulumtimeve dhe studimeve gjinore kuota është një prej elementeve bazë që të arrihet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje që besoj se edhe në Kosovë ka qenë e domosdoshme aplikimi i kuotës gjinore.[225]

Ariana Qosaj-Mustafa, Anëtare e Bordit të RrGGK, mendon: ...unë nuk do të pajtohesha se edhe meshkujt të cilët janë zgjedhur si deputet kanë dëshmuar kualitet në ndonjë proces më të dalluar në krahasim me gratë deputete. Por fakti që ato kanë hyrë në Kuvend sipas kuotës gjinore do të duhej së paku t'i bënte më avokuese për brengat e grave të Kosovës e ndoshta më pak besnike të vetëm politikave të partive që i kanë emëruar. Dihet mirëfillti se në krizat e ndryshme ekonomike dhe sociale gratë do të jenë ato që e mbajnë barrën e përkujdesjes familjare, shëndetësore e kështu me radhë kur bie përkrahja shtetërore në këtë drejtim. Për fat të keq gratë e zgjedhura me sistemin e kuotës vazhdojnë t'i përkrahin çështjet parësore pa marrë parasysh fare çështjet esenciale për përditshmërinë me të cilën ballafaqohen gratë.[226]
Blerta Bejtullahut mendon se duhet t'i mbështesim këto kuota, në mënyrë ... që grave tu ofrohet një vend ku merren vendime.[227]

Por, siç thekson Igballe Rogova, sa i përket kuotës, "këtu s'ka të bëjë me Rezolutën, kjo është pjesë e ligjit për zgjedhje, por mendoj se ka qenë e nevojshme ajo kuotë dhe akoma është e nevojshme. Besoj se mos të ishte kuota gratë s'do të ishin në parlament. Në fillim kuota e ka dëmtuar cilësinë mirëpo tani vërej një angazhim shumë të madh të grave. Kohëve të fundit gratë janë më të zëshme se burrat, unë si aktiviste gëzohem kur shoh se dëgjohet zëri i grave në parlament.[228]

Ndonëse shumica e ZKBGj-ve kanë ndjekur trajnimin themelor, shqetësimi është i shprehur. Takimet e rregullta me ABGj së fundi janë zvogëluar dhe nuk mbahen çdo muaj siç kërkohet me ligj. Mungesa e aktivitetit të ZKBGj-ve është e dukshme në përgatitjen e planit të veprimit të ZKBGj-ve, në këtë mënyrë nuk ka përcaktim të prioriteteve dhe planifikim të aktiviteteve që rezulton me mungesë të përgjegjshmërisë të NJDNJ dhe ZKBGj-ve në nivelet qendrore dhe komunale.

Ekziston një mungesë e përgjithshme e mirëkuptimit ndaj rolit të ZKBGj-ve apo NJDNJ nga ana e menaxherëve të lartë komunalë dhe në shumicën e komunave me qëllim lihen jashtë proceseve të rekrutimit dhe ngarkohen me një mori detyrash tjera. Veç kësaj, NJDNJ dhe ZKBGj-të disa herë janë viktima të rrethanave në komunat e tyre ku resurset financiare për aktivitete janë kritike por jo gjithmonë të gatshme nga buxhetet komunale. Mungesa e kandidateve femra për vende të lira të punës në nivele komunale është po ashtu arsye për mospërmirësim në pjesëmarrje të barabartë në nivelet vendimmarrëse.[229]

Mungesa e zbatimit të Rezolutës 1325 nga ana e UNMIK-ut dhe fakti se asnjë grua nuk ka qenë administratore e Kosovës dhe asnjë grua asnjëherë nuk ka udhëhequr forcat ushtarake shihet si pengesë serioze në sjelljen e ZQM. Kryesisht meshkujt merrnin pjesë në takimet me Ahtisaarin

[225] Intervistë me Maria Fihl-Vetting, shkurt 2009.
[226] Intervistë me Ariana Qosaj-Mustafa, shkurt 2009.
[227] Intervistë me Blerta Bejtullahun, shkurt 2009.
[228] Intervistë me Igballe Rogoven, shkurt 2009. Po aty. Në fillim kur gratë filluan të jenë pjesë e parlamentit, ne na konsideronin armik të tyre. Kur bisedonim për barazi gjinore, ato thonin se nuk është prioritet, fal punës qe kemi bërë bashkë me UNIFEM-in, pas një procesi dy vite e gjysme, të njëjtat gra të cilat thonin se nuk e kanë prioritet barazinë gjinore, ishin duke luftuar për barazi gjinor.
[229] Roli dhe funksionimi i Zyrtarëve komunalë për barazi gjinore në Kosovë, OSBE, Departamenti për të Drejta të njeriut dhe sundim të ligjit. http://www.osce.org/documents/mik/2006/11/22088_en.pdf

dhe ndjenja e papërshtatshmërisë është përforcuar nëse kishte prani të grave: Unë e kisha përshtypjen se meshkujt mendonin; "ti duhet të shkosh në shtëpi", kontrolloje ligjin për familje sepse aty e ke vendin.[230]

Behar Selimi mendon se kultura mashkullore rezistuese si në institucione ndërkombëtare ashtu edhe në ato vendore është pengesa kryesore në zbatimin e Rezolutës. Në përgjithësi, administratorët ndërkombëtarë kanë qenë të ngadalshëm në qasjen e mëtutjeshme të barabartë të grave në zhvillim dhe të drejta të njeriut, duke reflektuar mungesë të përgjegjshmërisë së drejtpërdrejtë para opinionit publik në Kosovë. Forca policore ndërkombëtare nuk tregoi shembull të mirë në zbatimin e Rezolutës 1325 por në fakt kishte tendenca që të përjashtojë gratë nga nivelet më të larta të punësimit.[231]

Rritja e pjesëmarrjes së gruas në qeverisje dhe përfshirja aktive e tyre në nivelet më të larta të udhëheqësish dhe vendimmarrjes është konsideruar të jetë në mënyrë të drejtpërdrejtë e lidhur me përfaqësimin domethënës dhe të drejtë të grave në media: Mediet janë mediume të rëndësishme për prezantime të aktiviteteve: ne kemi një numër të vogël të grave që udhëheqin mediume. Ne shikojmë tërë ditën meshkuj në TV, të cilët kërkojnë nga koleget e tyre femra që të shkruajnë diçka për ta meqë ata kanë fjalime në TV, ata i prezantojnë mendimet e grave si ide të tyre. Po ashtu, mediat i paraqesin gratë shumë sipërfaqësisht, jo për shembull për grupin negociator apo atë që mendojnë ato për zhvillimin ekonomik (apo) çka ajo mendon për kulturën. Ajo gjithmonë ka mendimin e saj për çdo gjë. Madje edhe nëse një grua nuk është anëtare e ndonjë partie, ajo mund të jetë qytetare, por ajo, po ashtu, mund të ketë mendim të vetin. Po ashtu, një … aspekt i Rezolutës 1325 është çështja e varfërisë, që është e lidhur me arsimin, situatën ekonomike dhe barazinë gjinore.[232]

Afërdita Kelmendi dhe Xheraldina Vula komentuan mbi nevojën për një fokus gjinor në programet televizive për të arsimuar dhe ndikuar në qëndrimet stereotipa gjinore të shoqërisë dhe për të siguruar pasqyrë pozitive gjinore dhe prezantim të barabartë të meshkujve dhe femrave në media. Në Kosovë, gratë përbëjnë audiencën më të madhe televizive. [233]Iniciativa për të prodhuar një film dokumentar që avokon dhe shpjegon Rezolutën 1325 nga RTV21 kishte synim arsimues: … ne e kishim një ide dhe ne e bëmë atë tërësisht në mënyrë edukative, jo për të edukuar vetëm aktivistet femra por femrat në të gjitha pjesët e shoqërisë, si dhe për të debatuar për mënyrën që duhet edukuar komunitetin, dhe se çka mund të arrijmë me Rezolutën 1325.

Afërdita Kelmendi, drejtoreshë ekzekutive e RTV21, shfaq mendimin se ekziston një qasje gjinore diametralisht e ndryshme në televizionet që drejtohen nga meshkujt. Veç kësaj, Vjosa Dobruna, kryesuese e bordit të RTK-së, tha se gratë në përgjithësi nuk janë të kënaqura me praninë e tyre në media, veçanërisht në programet e RTK-së; domethënë se mediet janë më të interesuara në prezantimin e çështjeve politike sesa ato sociale dhe gjinore.

U theksua se përkundër faktit se një e treta e Kuvendit të Kosovës është e gjinisë femërore, rrallëherë gratë kërkohen që të paraqiten në gazeta apo TV për të komentuar problemet ditore të natyrës politike. Megjithatë, kur shikojmë shtypin, perceptimi i grave është përgjithësisht më

[230] Intervistë me Cyme Mahmutaj, korrik 2007.
[231] Intervistë me Hysni Shala, korrik 2007. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me UNIFEM-in, ShPK-ja ka organizuar takime pune dhe seminare për të ngritur vetëdijen e rëndësisë së pjesëmarrjes së grave në nivelet vendimmarrëse.
[232] Intervistë me Flora Brovina, gusht 2007
[233] Intervistë me Afërdita Kelmendi dhe Xheraldina Vula, korrik 2007.

pozitiv dhe shumica e artikujve mendohet se pranonin arritjet e grave në politikë, sport, ekonomi dhe fusha tjera të jetës.

Përfundimisht, në Kosovë, trashëgimia e turbulencës politike të viteve të nëntëdhjeta dhe periudhës së pas luftës vazhdon të përulë pjesëmarrjen e grave në jetën publike, veçanërisht në politikë dhe ekonomi. Shumë familje në Kosovë jetojnë në kushte shumë të varfra. Papunësia është zvogëluar që nga viti 2002, por në vitin 2005 akoma raportohej se 33 për qind meshkuj dhe 60 për qind femra të fuqisë punëtore ishin të papunë.[234]

2. Perspektiva Gjinore në Trajnime të Personelit Policor dhe Ushtarak: Rendi dhe Ligji

Rezoluta e KS të OKB-së 1325, neni shtatë *"Nxitë"* vendet anëtare që të rrisin përkrahjen vullnetare financiare, teknike dhe logjistike për trajnimet gjinore, përfshirë ato të ndërmarra nga fondet dhe programet relevante, mes tjerash, nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gra dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë si dhe nga Zyra e Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë dhe organe tjera relevante.
Pabarazia e trajnimeve gjinore të trupave të KFOR-it është zhgënjyese. Trajnimi gjinor ka më shumë gjasa të përfshihet në edukimin e forcave të shumicës së vendeve perëndimore dhe veriore Evropiane sesa shtetet anëtare më të largëta. Trupat e KFOR-it Suedez, Italian dhe Gjerman në veçanti kanë punuar me organizata të grave në problemet lokale të trafikimit dhe prostitucionit të detyruar pasi që ishte zbuluar se nuk është siguruar asnjë trajnim i tillë për ushtrinë e KFOR-it. Megjithatë, OJQ-të kanë mungesë të autoritetit për të zhvilluar trajnime të tilla pa përkrahje institucionale të Pranisë Civile Ndërkombëtare dhe komandës së KFOR-it. Në prill të vitit 2007, vlerësohej se ishin të pranishëm 16,000 ushtarë nga 34 vende si pjesë e KFOR-it, ndonëse nuk janë në dispozicion statistika të ndara në bazë gjinore.[235]

TMK ka pasur 5,052 pjesëtarë, ku përafërsisht 2 për qind janë gra. Respondentët sugjeruan se kishte probleme të rëndësishme për gratë që kërkojnë gradime për shkak të ndalesës së rekrutimit që pengon lëvizjen dhe gradimin dhe se ekziston një kulturë "mashkullore" në rekrutime. Megjithatë, trupat e TMK-së kanë pranuar trajnime gjinore në seri prej katër modulesh dyditore dhe pastaj kanë ndjekur kurse të vazhdueshme të rastit pasi që të kenë përfunduar orët. Planet përfshijnë zhvillimin e një kursi të "trajnimit të trajnerëve" në mënyrë që të sigurohet shkathtësia e brendshme. Sidomos është e rëndësishme që pjesëtarët e FSK-së të përfshijnë një kurs të trajnimit për barazi gjinore dhe "trajnimit të trajnerëve" për këtë çështje.

Në Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK) janë ndërmarrë hapat për zbatimin e Rezolutës 1325 në trajnime për stafin me synimin se një gjë e tillë do të bëhet tipar i përhershëm i Trajnimit themelor për Zyrtarët korrektues, me plane për trajnime më të avancuara për menaxherë.

Po ashtu, është përpiluar një anketë për tërë stafin për të identifikuar brengat me kushtet e shërbimit, për mes së cilës do të dizajnohen politikat dhe aktivitetet në mënyrë që të krijohen trajnues gjinorë të brendshëm; të avancohen mundësitë për aplikimin e femrave për pozita të larta të stafit të ShKK-së; të avancohet trajnimi gjinor për menaxherë dhe të krijohen përshkrime të detyrave të punës për zyrtarët për mundësi të barabarta. Ndonëse zbatimi i përfshirjes të çështjeve gjinore është i mandatuar brenda shërbimit, ai akoma nuk është detyrë e caktuar për

[234] Enti statistikor i Kosovës, 2007. Tregu i punës për Gratë dhe burrat Kosovë, f. 29.
[235] Shih NATO, Informata mbi trupat në Kosovë www.nato.int/kfor/docu/pr/2007/04/pr070404.htm

asnjë zyrtar. Zëvendësdrejtori i ShKK-së është pika e kontaktit për çështje gjinore. Rreth 18 për qind e ShKK-së janë femra, shumica e tyre civile në pozita administrative. Në nivele vendimmarrëse punon vetëm stafi mashkullor.
Shërbimi Policor i Kosovës (ShPK) në mënyrë efektive ka integruar Rezolutën 1325 në rolet dhe obligimet e veta si në nivelin administrativ ashtu edhe atë operativ. Koordinatori i ShPK-së për Çështje gjinore theksoi se përqindja e policeve femra të uniformuara është aktualisht rreth 15 për qind, ku 10 për qind të tyre janë në pozita vendimmarrëse, që do të thotë, në mes të gradave të Rreshter dhe Gjeneral. Në mesin e grave më të graduara në ShPK, është një gjeneral, një kolonel, një komandant përgjegjës për 2-3 komuna dhe një grua kryesuese e operacioneve. Veç kësaj pesëdhjetë për qind të Këshilltarëve për çështje gjinore në stacione policore anembanë Kosovës janë femra.

Ndryshime të ngadalta por pozitive shihen në përfshirjen e çështjeve gjinore, përkundër këmbënguljes së stereotipizmit të çështjeve gjinore dhe mosbesimit të bilancit gjinor.

3. Mbrojtja dhe Respektimi i të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave

Rezoluta 1325, neni dhjetë (10) “Iu bën thirrje të gjitha palëve të përfshira në konfliktin e armatosur që të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht nga përdhunimi dhe format e tjera të abuzimit seksual, dhe të gjitha llojeve të tjera të dhunës në situatën e një konflikti të armatosur”.

Stabiliteti dhe mbajtja e paqes në shoqëritë e pas-luftës është drejtpërdrejtë e lidhur dhe e përcaktuar me arritjen e sigurisë njerëzore. Në Kosovën e pasluftës, dhuna dhe ngacmimet ndaj grave janë rritur dhe kjo në përgjithësi kuptohet si pasqyrim i efekteve të situatës së rëndë ekomomike dhe traumës së pasluftës.

Përgjegjësitë shtëpiake, mos-ofrimi i kujdesit të fëmijëve, kushtet e vështira të punës, aktivitetet e pavlerësuara dhe të nënçmuara të punësimit, punësimi i favorizuar për meshkuj janë pengesa në realizimin e aspiratave ekonomike të gruas. Gjendja socio-ekonomike e Kosovës përkeqësohet edhe më shumë nga zhvillimi i ngadalshëm ekonomik, reformat drastike ekonomike dhe privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.[236]

Përafërsisht, 37 për qind të popullatës së Kosovës jetojnë me më pak se €1.42 në ditë. Një numër gjithnjë e më i madh i njerëzve është duke u kategorizuar si persona që jetojnë në varfëri të skajshme; më shumë se 15 për qind të popullatës jeton me më pak se €0.93 në ditë. [237]Sipas statistikave në vitin 2007, shkalla e papunësisë për gratë arrinte mbi 70 për qind me mesatare të punësimit rreth 50 për qind.[238] Shkalla e papunësisë për personat e moshës 15 deri 24 vjeçe është 70.5 për qind, dy herë më e lartë sesa ajo e të rriturve.[239]

---

[236] Gratë në punë; Gjendja ekonomike dhe mundësitë për gra në Kosovë, UNIFEM, DFID. shtator 2000
[237] IFRC, Mal i Zi, Serbia dhe Kosova: Programi dhe buxheti i Kosovës 2007, http://www.ifrc.org/docs/appeals/annual06/MAACS00105.pdf
[238] Zyra e ZPSSP-së për lajme dhe komunikim, Transkripti i kumtesës për shtyp, http://www.euinkosovo.org/upload_briefing/Economic percent20Press percent20Briefing percent2022 percent20March percent202007.pdf Mars, 2007.
[239] Ueb faqja e UNDP-së, Zhvillimi ekonomik dhe punësimi, http://www.kosovo.undp.org/?cidwww2,89,222, 2007.

Mundësitë e punësimit për gratë janë kryesisht në fushat e bujqësisë dhe bizneseve të vogla. Sipas pasqyrës së proceseve të privatizimit në Kosovë, në mesin e 2,100 ofertuesve të parakualifikuar, 70 janë femra, ku 49 sosh janë të vetme dhe 21 përfaqësojnë kompani të ndryshme, duke e bërë përfaqësimin e gjinisë femërore në vetëm 3 për qind. Rëndësia e sigurisë ekonomike të gruas në Kosovë nuk është njohur gjatë negociatave për statusin final të Kosovës dhe në proceset e përditshme politike, ndonëse stabiliteti varet në sigurinë e gruas.

Të dhënat për varfërinë në Kosovë, tregojnë për një feminizëm të varfërisë dhe rritje të peshës së grave në grupin e të varfërve. Vlerësimi i varfërisë në Kosovë mbështetur në studimin e buxhetit familjar (Household Budget Survey 2005), tregon se familjet ku kryefamiljar është një grua janë më të varfra se familjet me një kryefamiljar mashkull.[240]

Sipas Susanne Backstedt, një ndër problemet madhore për gratë është edhe punësimi (për të qenë financiarisht të pavarur). Sepse, atë ditë kur je e pavarur financiarisht ti vendosë rregullat në jetën tënde. Zbatimi i Rezolutës 1325 mendoj se do të arrihej me anë të punësimit të grave, sepse është një çështje e madhe të jesh e pavarur ekonomikisht. Edhe nëse është viktimë e dhunës në familje nëna e pavarur do të mund të merr kujdesin e plotë për fëmijën e vet.[241]

Në zonat rurale, thekson Visare Mujku-Nimani, kemi mungesën e pavarësisë ekonomike që gratë të kenë të hollat e veta, në radhë të parë qe të ketë ajo të holla të vijë në Prishtinë për të bërë një kontroll shëndetësor duhet t'i kërkoj të holla nga burri, të marr leje ose të ketë ndonjë përcjellës nga familja për të bërë një vizitë të thjeshtë mjekësore. Mendoj se është mungesa ekonomike, edukimi si dhe mirëkuptimi brenda hierarkisë së familjes.[242]

Zonat rurale janë mjaft delikate sa i përket çështjeve gjinore, thekson Ariana Qosaj-Mustafa, edhe për faktin se numri më i lartë i papunësisë, analfabetizmit, dhunës në baza gjinore raportohet në zonat rurale. Nëse nuk punohet në sforcimin e mekanizmave për zbatimin e parimeve të sundimit të ligjit si dhe në ngritjen e mundësive ekonomike vetëm fushatat edukative/parandaluese nuk mjaftojnë. Sipas të gjitha gjasave vetëm iniciativat e edukimit pa u përcjellë edhe me mundësitë e krijimit të vendeve të punës, ngritjes së kapaciteteve të zanatit apo edukative nuk rezultojnë në afatgjatshmëri me një prezencë afatgjate të barazisë gjinore në kontekstin rural posaçërisht. Natyrisht këtu nuk duhet menduar vetëm në ofrimin e kurseve të floktarisë e rrobaqepësisë për gratë dhe vajzat e reja në zonat rurale por edhe ofrimin e mundësive fuqizuese të trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm formal apo joformal në punësimin e tyre. Pra fuqizimi do të përfshinte ofrimin e mundësive të zgjedhjes për arsimim dhe punësim.[243]

Përpjekjet e dështuara për të inkorporuar perspektivat e gruas në strategjinë ekonomike të qeverisë kanë ndikim të konsiderueshëm në arritjen e sigurisë së grave dhe vajzave. Përpilimi i komponentëve strategjikë makroekonomikë deri më tani ka shpërfillur çdo brengë të rëndësishme gjinore, që sinjalizonte mosinteresim në të drejtat e gruas.

Ndikimi i pasigurisë ekonomike është i dukshëm në shumë sfera të jetës, siç janë punësimi, martesa, trashëgimia, marrja e kredive dhe arsimi. Promovimi i mundësive të barabarta për të

[240] World Bank; October 007, "Kosovo poverty assesement"- The poverty incidence is estimated to be higher by 4% for fekale headed households compared to male heads of households.
[241] Intervistë me Susanne Backstedt, shkurt 2009.
[242] Intervistë me Visare Mujku-Nimani, shkurt 2009.
[243] Intervistë me Ariana Qosaj-Mustafa, shkurt 2009.

gjithë është esencial përmes marrjes në konsideratë të faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, kulturorë, demografikë, institucionalë, mjedisorë dhe fetarë.

Për të qenë strategjitë makroekonomike efektive, ato duhet të trajtojnë pasigurinë ekonomike qysh në rrënjë, me krijimin e programeve specifike dhe me analiza të thella të buxhetit.
Kur të flasim për fuqizimin e gruas, ta quajmë fuqizim ekonomik të gruas, duhet të ketë programe speciale që ky grup i pafavorshëm të bëhet i barabartë. [244]

Në këtë drejtim duhet të merret parasysh Neni 24 (Pika 3) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili përcakton: Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.[245]

3.1 Prona private

Tradicionalisht meshkujt kosovarë posedojnë pronë private dhe përkundër të drejtës për pronësi të përbashkët në martesë; titullar i pronës është zakonisht mashkulli. Në rast të shkurorëzimit, gratë shpeshherë e humbin pronën e përbashkët. Është evidente se vendet ku barazia gjinore është në nivel të ulët, ballafaqohen me një zhvillim më të ngadaltë ekonomik, dhe kanë pengesa në zbutjen e varfërisë më tepër sesa ato vende ku barazia gjinore është në nivel të kënaqshëm*.*[246]

Ligji për familjen përcakton: "Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore".[247] Gjithashtu është përcaktuar se: "Bashkëshortët vendosin për vendin e banimit me marrëveshje. Bashkëshortët vendosin për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare me marrëveshje. [248] Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje."[249]

LBGJ përcakton se pasuria e krijuar gjatë jetesës në martesë regjistrohet në regjistra publikë, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve. Institucioni që bën regjistrimin e pasurisë në regjistrat publikë është i detyruar të veprojë në pajtim me këtë ligj. Ky ligj më tutje parasheh se institucioni i autorizuar dhe personi përgjegjës për regjistrimin e pasurisë në regjistrat publikë, në rast të shkeljes së këtij ligji, dënohen me gjobë prej 10,000 deri në 20,000 euro. Ligji më tutje specifikon se pasuria e përbashkët e regjistruar si pronë e përbashkët administrohet

[244] Intervistë me Flora Brovinën, gusht 2007.
[245] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24 [Barazia para Ligjit]
1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.
[246] Banka Botërore "Zhvillimi dhe Ndërgjegjësimi Gjinor dhe të Drejtat Gjinore në Burime".
[247] Neni 42. (Bashkëjetesa martesore) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/7, 16 shkurt 2006, Për shpalljen e Ligjit mbi familjen të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/32 për familjen. (Ligji për familjen)
[248] Neni 44. (Vendbanimi, Ekonomia familjare, Profesioni). Ligji për familjen.
[249] Neni 49. Ligji për familjen.

bashkërisht dhe tjetërsimi i pasurisë së regjistruar në emër të të dy bashkëshortëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e dhënë nga të dy bashkëshortët.
Edhe pse ligji u jep të drejtën femrave për pronë, qiradhënie dhe trashëgiminë e pronës, ligji zakonor nuk e bën këtë. Kjo rezulton në shumë raste me heqjen dorë të vetë grave nga prona e tyre dhe kështu e vështirësojnë perspektivën e tyre ekonomike.[250]

Në mungesë të fletëposedimit të pronës, është shumë vështirë për gratë që të sigurojnë kredi për biznese private. Mungesa e kolateralit, nivelet e ulëta të arsimit dhe mungesa e përvojës ndërmarrësore parandalojnë gratë që të hyjnë në këtë treg, posaçërisht në zonat rurale.

Sipas LBGJ-së, Puna e përbashkët e bashkëshortëve me të cilën fitohet pasuria e përbashkët, konsiderohet kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët. Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.[251] Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj, mund të disponojnë me pjesën e tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë , pas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.[252]

Sipas të dhënave të ESK-së për vitin 2002, gratë posedojnë vetëm 6,5% të biznesit në Kosovë. Ndërsa një studim tjetër i kryer nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2004, thekson se prej 500 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) të regjistruara, 98% e tyre janë pronë e meshkujve, dhe vetëm 2% janë pronë e grave.

Bizneset që janë në pronësi të grave lidhen me madhësinë e ndërmarrjes. Rreth 99% të ndërmarrëseve femra janë ndërmarrëse individuale dhe posedojnë ndërmarrje të vogla. Niveli kaq i ulët i pronësisë së grave rrjedh pikësëpari prej shkaqeve sociale.[253]

3.2 Privatizimi

Një instrument kyç në tranzicionin në ekonomi të tregut është privatizimi. Në Kosovën e shkatërruar nga lufta, privatizimi ishte njëra nga nevojat fundamentale për zhvillimin e ekonomisë së tregut

Sidoqoftë, privatizimi në Kosovë, mbetet një proces mjaft i komplikuar, kjo edhe për shkak të pamundësisë së përcaktimit të pronësisë.

Më 13 qershor 2002 u themelua Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, për të administruar dhe ristrukturuar Ndërmarrjet Publike (NP) dhe për të privatizuar ato Shoqërore (NSH). Duhet cekur se nuk ishte asnjë grua në Bordin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Gati tri vite administrata ndërkombëtare, përkatësisht Shtylla IV dhe Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë brenda UNMIK-ut kanë tentuar ta krijojnë bazën legale për transformimin e pronës shoqërore. Ky proces ka rrjedhur ngadalë dhe ka qenë i shoqëruar me hamendje, hezitime dhe politizim. Në gjysmën e dytë të muajit prill, pas një procesi të gjatë konsultimesh dhe parapërgatitjesh nga faktori ndërkombëtar, por pa inkuadrimin adekuat të kosovarëve, para

[250] Raporti i Progresit të Kosovës (nën RKSKB-së 1244) për vitin 2005 KOMISIONI EVROPIAN-Bruksel, 9 nëntor 2005, SEC (2005) 1423, fq..21).
[251] LBGJ, Neni 15 (pika 8 dhe 10).
[252] LBGJ, Neni 15 (pika 13).
[253] PKBGJ, fq.18

Institucioneve të Qeverisjes së Përkohshme të Kosovës u paraqit Rregullorja mbi Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës, e cila do të duhej të udhëhiqte një proces të privatizimit në Kosovë.[254] Muhamet Mustafa, drejtues i RIINVEST, organizatë kjo e cila merret me hulumtimin e problemeve ekonomike, thotë se në procesin e privatizimit duhet të përfshihen edhe struktura tjera, jo vetëm AKM-ja. "Agjencia Kosovare e Mirëbesimit sa do ambicioze që paraqitet nuk mund ta mbikëqyrë e vetme procesin e privatizimit në Kosovë," thotë Mustafa. "Privatizimi është i lidhur ngushtë me amzën sociale të shoqërisë dhe për këtë arsye në këtë proces duhet të përfshihen edhe faktorë të tjerë vendorë".

Ndërsa, Agjencia Kosovare e Pronës[255] themelohet, në vitin 2006, si agjenci administrative e cila do të funksionojë si organ i pavarur, me qëllim të sigurimit të përkohshëm të zgjidhjes së kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, pa i referuar kërkesat e tilla në gjykatat me kompetencë territoriale dhe lëndore për ta. [256]

Ndikimi gjinor i këtij procesi nuk është analizuar. Megjithatë, nuk është e paarsyeshme që të supozojmë se, duke i parë shabllonet tradicionale të punësimit dhe gjendjen shumë të rëndë ekonomike, gratë do të vazhdojnë të ndikohen në mënyrë armiqësore.

Pa sindikata të fuqishme të punës për t'i përfaqësuar ato dhe duke e parë këmbëngulësinë e qëndrimeve patriarkale që favorizojnë punësimin e meshkujve si mbajtës të familjes, punonjëset femra në NSh me gjasë do të jenë në mesin e të parëve që do të humbin vendet e tyre të punës.

Është e vërtetë se privatizimi e shton punësimin në baza reale të fuqisë punëtore aktive, por rezultatet përfundimtare do të jenë negative për shkak të fuqisë punëtore tepricë të shumë ndërmarrjeve shoqërore dhe publike.[257]

3.3 Dhuna në familje

Dhuna në familje, si një formë e diskriminimit gjinor përbën sot një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave themelore. Mbrojtja, respektimi dhe aplikimi i politikave kundër dhunës

[254] www.riinvestinstitute.org/common/documents/Privatizimi%20ne%20Kosove.pdf Muhamet Mustafa: Privatizimi në Kosovë: Përparime dhe ngecje

[255] Shih Ueb faqja e Agjencisë Kosovare të Pronës http://www.kpaonline.org/sq/default.asp

[256] Shih Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/10 (4 mars 2006) mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, me të cilën themelohet Agjencia Kosovare e Pronës, si agjenci administrative e cila do të funksionojë si organ i pavarur, me qëllim të arritjes së zgjidhjes së efektshme dhe të shpejtë të kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Agjencia Kosovare e Pronës ka kompetenca për të pranuar, për të regjistruar dhe për të ndihmuar gjykatat në zgjidhjen e kategorive vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, si pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, si: (a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe (b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore. Ndërsa, duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Ligjin në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjerë relevantë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

[257] Shih Situata momentale – Varfëria në Kosovë nga Ardian Jashari http://www.kan-ks.org/lexo_lajmet.php?idwww108&kategoriawww136&gjuhawwwshqip

dhe llojeve të ndryshme të diskriminimit është shëndrruar në strategji gjithëkombëtare të shumicës së vendeve.[258]
Diskriminimi gjinor dhe dhuna i shoqëron gratë që në fazën embrionale gjatë gjithë jetës. Dhuna me bazë gjinore merr forma të dhunës psikologjike e fizike dhe manifestohet më shpesh në format e dhunës në familje, trafikimit për qëllime prostitucioni dhe abortit selektiv.

Sipas të dhënave të siguruara nga Shërbimi Policor i Kosovës rezulton se rastet e raportuara të dhunës në familje në vitin 2006 ishin 1,371 raste. Analiza e tyre tregon se në 92 % janë meshkuj të cilët e ushtrojnë dhunën (ndaj grave, fëmijëve, prindërve apo anëtarëve të tjerë të familjes) dhe vetëm 8% janë femra. Një studim i UNIFEM-it në vitin 2000 për dhunën ndaj gruas në Kosovë, tregon se 23% e të intervistuarave kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe fizike nga meshkujt gjatë viteve 1999 dhe 2000. Rreth 54% e këtyre grave në zonat rurale dhe 7% në ato urbane nuk e kanë raportuar këtë dhunë, madje për këtë as nuk kanë biseduar me të afërmit e tyre. I njëjti studim konfirmon se dhuna në familje është kryesisht e lidhur me modelin patriarkal të të qenurit "burrë"- dhe përgjegjës për mbajtjen e familjes. Me shtimin e varfërisë dhe të papunësisë, për shumë meshkuj, përmbushja e këtij roli tradicional është tronditur e për pasojë ata tashmë i janë kthyer dhunës ndaj gruas dhe fëmijëve, si i vetmi mjet për të dëshmuar fuqi mbi të tjerët dhe aftësi për të qenë "burrë". Dhuna gjinore merr forma të rënda në trafikimin e grave dhe vajzave për qëllime përfitimi. Megjithëse nuk është i njohur numri i grave të trafikuara, organizatat joqeveritare vlerësojnë se numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është rritur. Kështu, vlerësohet se numri i viktimave të trafikimit në vitin 2006 të jetë rritur 5 herë krahasuar me vitin 2001(burimi IOM). Një formë tjetër e dhunës me bazë gjinore është aborti selektiv. Të dhëna nga spitalet obstetrike-gjinekologjike tregojnë se zgjedhja e shumë prindërve është në favor të djemve. Megjithëse shifrat e abortit nuk raportohen ose raportohen pjesërisht (vetëm nga spitalet dhe klinikat publike), perceptimi i mjekëve është se një përqindje e lartë e tyre ndodh si rezultat i gjinisë së fëmijës.[259]

Sipas, Shobhana Rana, në çdo vend ka dhunë në familje mirëpo duhet të gjesh mënyrën si të diskutosh lidhur me këtë çështje dhe ta adresosh atë në mënyrë të drejtë.[260]

Kur u lancua kampanja "16 Ditët e aktivizmit kundër dhunës" për herë të parë në vitin 2000, çështja e dhunës në familje ishte akoma tabu në Kosovë. Aktivitete të ndryshme të ngritjes së vetëdijes kanë ndryshuar qëndrimet e njerëzve ndaj dhunës ndaj grave dhe fëmijëve dhe numri i rasteve të raportuara është rritur.[261] Shumë raste të dhunës në familje dhe të dhunimeve kalojnë pa u raportuar meqë konsiderohen si çështje private.[262]

Në Kosovën e pas-luftës, dhuna dhe ngacmimet ndaj grave janë rritur dhe kjo në përgjithësi kuptohet si pasqyrim i efekteve të situatës së rëndë ekomomike dhe traumës së pasluftës.

UNHCR, në të gjitha misionet e saj në botë shënon fushatën "16 ditë të aktivitetit kundër dhunës gjinore"; fushatë e cila është e përvitshme, dhe që nis më 25 nëntor, me rastin e Ditës

[258] Enkelejda Olldashi: Si të arrihet qytetaria evropiane? Revista Teuta, Prishtinë, shtator 2008, fq. 8, 9. Shih Po aty: Nocioni " dhunë ndaj gruas" jepet nga Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së e vitit 1993: " Çdo akt dhune mbi bazë gjinie që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimimin fizik, seksual, psikologjik, ose që shkakton vuajtje tek gruaja, duke përfshirë edhe kërcënimin për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private".
[259] PKBGJ, fq.
[260] Intervistë me Shobhana Rana, shkurt 2009.
[261] Kryeartikulli i OSBE-së – Ndryshimi i qëndrimeve ndaj dhunës në familje, 14 dhjetor 2004. http://www.osce.org/item/25770.html
[262] Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve; Raporti vjetor 2002.

Ndërkombëtare të Eliminimit të Dhunës kundër Grave. Fushata është përmbyllur më 10 dhjetor (2008), me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Fushata është shënuar edhe në kuadër të përvjetorit të 60të të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Një nga porositë e fushatës ishte se, të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen përderisa vazhdon të ketë dhunë gjinore. Për të ngritur vetëdijen për dhunën e bazuar në gjini dhe për të promovuar strategjitë se si të luftohet ajo, UNHCR në Kosovë përmes pranisë në terren ka organizuar aktivitete dhe ngjarje publike me pjesëmarrje të ndryshme. UNHCR mbajti një takim në afërsi të Prishtinës me fëmijë pjesëmarrës të ekspozitës me vizatime, në të cilën fëmijë nga komunitete dhe mjedise të ndryshme shfaqën përmes vizatimeve mendimet e tyre për rëndësinë e të drejtave të njeriut. Në kuadër të fushatës është shpërndarë një fletëpalosje me emërtimin "Jo dhunë", të përgatitur në gjuhët zyrtare në Kosovë.[263]

Koalicioni Kosovar kundër dhunës në familje dhe dhunës seksuale, me 11 – 14 nëntor 2008 u takua në Durrës për të diskutuar strategjinë e koalicionit për vitin 2009 dhe strukturën e koalicionit në të ardhmen. Anëtarët e koalicionit u pajtuan që mision i Koalicionit të jetë parandalimi i dhunës në familje dhe dhunës seksuale, si dhe përkrahja, ndihma dhe fuqizimi i të mbijetuarve të dhunës.

Caqet strategjike për vitin 2009 janë: Zvogëlimi i rasteve të dhunës në familje apo dhunës seksuale duke përkrahur programet për barazi gjinore dhe kanalizim të çështjeve gjinore; Ngritja e vetëdijes; Kompletimi i kornizës ligjore; Ngritja e kapaciteteve; dhe • Fuqizimi i Koalicionit.[264]

Dhuna në baza gjinore mund të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe mund të pengojë përpjekjet e arritjes së Qëllimeve Zhvillimore të Mijëvjeçarit.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës gjatë vitit 2007 ka realizuar një Hulumtim Kërkimor mbi Nivelin e Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave (RrGGK).[265] Hulumtimi rezulton me të dhëna dhe prezanton rekomandime.

---

[263] Intervistë me Shpend Halilin, shkurt 2009. Po aty: UNHCR me rastin e aktivitetit të "16 ditë të aktivitetit kundër dhunës gjinore" në bashkëpunim me OSBE ka organizuar dy tryeza të rrumbullakëta në Mitrovicë, në dhjetor të 2008. Qëllimi i takimeve ishte të sillen aktorë të ndryshëm vendim- marrës dhe të theksohet nevoja për kujdes të veçantë të institucioneve lokale dhe të shoqërisë civile. Përfaqësuesit paraqitën kornizën juridike duke adresuar çështjet e më poshtme: 1) dhuna e bazuar në gjini; 2) sfidat në ofrimin e mbështetjes viktimave dhe familjeve të tyre; dhe 3) shkaqet e ndodhjes së saj. Sipas pjesëmarrësve në këto tryeza të rrumbullakëta, shtrirja e dhunës të bazuar në gjini është më e madhe se sa raportohet. Po ashtu, është e ditur se grupet më të prekura janë femrat dhe fëmijët. Megjithatë, një konkludim ishte se ekziston zotim i stafit të institucioneve lokale dhe shoqërisë civile për të luftuar dhunën e bazuar në gjini. Një aspekt për të luftuar këtë dukuri sipas pjesëmarrësve në këto tryeza të rrumbullakëta është ngritja e kapaciteteve të mbrojtjes dhe ofrimi i mbështetjes më të madhe viktimave të dhunës.

[264] Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 3 gusht 2008 - nëntor 2008, www.Womensnetwork.org Po aty. Shtatë organizata e strehimore morën pjesë në këtë takim, përfshirë Qendrën për Mirëqenien e Gruas (Pejë), Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (Prishtinë dhe Mitrovicë) Medica Kosova (Gjakova), Liria (Gjilan), Hope and Homes for Children (Prishtinë) dhe Shtëpia e Sigurt në Gjakovë.

[265] Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave (RrGGK).
Dhuna ndikon negativisht në shëndetin mendor që rezulton në problemet fizike shëndetësore (si tensioni i lartë i gjakut, gastritin, çrregullimet në gjumë dhe ushqim). Më shumë se gjysma e grave kanë raportuar se janë në depresion, hidhërim, kanë çrregullime në ushqim, pagjumësi dhe tension të lartë të gjakut, krahas problemeve tjera shëndetësore. Shqetësuese është shifra 90 përqind e grave që kanë menduar të bëjnë vetëvrasje. Gjysma e profesionalistëve kanë njohur gra që kanë tentuar të bëjnë vetëvrasje dhe 14 profesionalistë kanë evidentuar gra që kanë bërë vetëvrasje si rezultat i dhunës.

Gjatë luftës në vitet 1998-1999, forcat serbe kanë keqtrajtuar gra në mënyrë psikologjike, fizike dhe seksuale. Dhunimi seksual gjatë kohës së luftës rezultoi me shtatzëni të padëshiruara, aborte dhe plagë fizike.

Raportet mbi dhunën familjare dhe seksuale[266] janë rritur dhe jo domosdoshmërisht mund të nënkuptohet se dhuna është në rritje. Tetëdhjetë përqind e viktimave të dhunës në familje janë lënduar nga dhunuesi i tyre edhe më parë.

Nga 47 gra që kanë provuar dhunën, 87 përqind e tyre kanë përjetuar dhunë gjatë shtatzënisë. Një e treta e tyre janë penguar të vizitohen te mjeku gjatë shtatzënisë. Tetë prej tyre kanë pasur dy apo më shumë aborte spontane. Në punën e tyre, 73 përqind e profesionalistëve kanë evidentuar gra shtatzëna që kanë përjetuar dhunë.

Në Kosovë, Dhuna në Familje reflektohet nga papunësia, varfëria dhe kushtet e vështira të jetesës, tensioneve politike të kombinuara me papunësinë që kontribuon në "stres dhe depresion", posaçërisht në mesin e burrave të cilët tradicionalisht bartin përgjegjësinë e "shtyllës së familjes".

Rreth 95 përqind të rasteve të dhunës në familje,[267] burrat ushtrojnë dhunë ndaj grave. Një polic i SHPK-së nga Njësiti i Dhunës në Familje komenton,"Ne i ndajmë rastet në bazë të gjinisë, por gjithmonë numri më i madh i rasteve janë femra". Të dhënat e SHPK-së për vitet 2006 dhe 2007 tregojnë se gratë ishin autore të krimeve në vetëm tetë përqind të rasteve të dhunës në familje.

Meqenëse, Qeveria e Republikës së Kosovës deri në momentin kur po raportohet nuk ka një Strategji dhe Plan Veprimi kundër dhunës në familje, me iniciativën e Rrjetit të Grupeve të Grave i Kosovës (RRGGK) është zhvilluar një hulumtim lidhur me dhunën në familje në Kosovë "Siguria fillon në shtëpi", i cili mund të shërbej si bazë e fortë mbi të cilën mund të bazohet Strategjia dhe Plani i Veprimit të Kosovës kundër Dhunës në Familje. Synimi kryesor do të ishte përfshirja e çështjeve gjinore në politikat publike nëpërmjet planeve konkrete të veprimit, të detajuara dhe buxhetuara për të hedhur bazat për avancimin e barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje në të ardhmen, mbështetur në dokumentet, rekomandimet dhe instrumentet ndërkombëtare, duke iu referuar kushteve konkrete të Kosovës.

Studimi[268] i 1.256 grave dhe burrave ka ilustruar se dhuna në familje përgjithësisht konsiderohet si diçka e turpshme në Kosovë, andaj mund të shpjegohet se përse nuk është raportuar në përmasat e saj reale. [269]

---

[266] Më 19 qershor, 2008, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara unanimisht aprovoi Rezolutën 1820 të KSKB-së kundër Dhunës Seksuale ndaj Grave, që dënon dhunën seksuale ndaj grave në mes të një konflikti. RrGGK dërgoi një deklaratë në mbështetje të rezolutës së re. Shih Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Vëllimi VI, Numri 2 prill 2008 - qershor 2008, www.Womensnetwork.org

[267] Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave (RrGGK).

[268] RRGGK-ja ka zbatuar një metodologji të përzier, që ka përfshirë mbledhjen e të dhënave statistikore nga institucionet përkatëse, rishqyrtimin e ligjit përkatës, të legjislacionit dhe të shërbimeve sociale në dispozicion; studimin e 1.256 grave dhe burrave të të gjitha moshave dhe grupeve etnike anë e kënd Kosovës; dhe studimin e përfaqësuesve të institucioneve kosovare, të organizatave relevante dhe të ekspertëve.

[269] Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje (Publikuar nga Qeveria e Kosovës) Prishtinë, Kosovë 2008

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përfunduar nëse dhuna është zvogëluar ose është rritur në Kosovë. Përafërsisht 43 për qind e të anketuarve kanë përjetuar dhunë familjare; 46.4 për qind e të gjitha (100 për qind) të grave dhe 39.6 për qind e të gjithë meshkujve.

Gjithashtu, Departamenti i Institutit të Politikave Sociale i cili vepron në kuadër të (MPMS), gjatë vitit 2008 ka ndërmarrë një hulumtim i cili i referohet rasteve të dhunës në familje për periudhën 2004-2008. Raporti ka nxjerrë në pah këto të dhëna: Qendrat për Punë Sociale (QSP) kanë raportua për vitin 2004 -223 raste të viktimave të dhunës në familje, për vitin 2005-380 raste, për vitin 2006-438 raste, për vitin 2007 -170 raste, d.m.th kemi një ramje të numrit të viktimave të dhunës në familje, ndërsa në gjashtëmujorin e parë-2008, QSP-të kanë raportuar për 91 raste të dhunës në familje.[270] Nga numri i përgjithshëm i viktimave të dhunës në familje të raportuara më lartë: 93% të viktimave kanë qenë të nacionalitetit shqiptar dhe 7% të tjerë; 64% e viktimave kanë qenë nga fshati, dhe 36% nga qyteti. Sa i përket gjinisë së viktimave të dhunës në familje 89% kanë qenë femra, dhe 11% meshkuj. Ndërsa sa i përket nivelit arsimor të viktimave të dhunës në familje-femrat me nivel të ultë të arsimit kanë qenë më tepër të ekspozuara dhunës në familje.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parasheh lëshimin e tri llojeve të urdhrave mbrojtës. Urdhri mbrojtës me disa apo të gjitha masat e parapara në Rregulloren 2003/12 mund të caktohet nga gjykata në seancë gjyqësore në kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh dhe duhet të lëshohet brenda 15 ditëve nga kërkesa e parashtruar. Pas kësaj periudhe, nëse ende ekzistojnë rrethanat e rrezikshmërisë për mirëqenien tuaj, mund të kërkoni vazhdimin e urdhrit mbrojtës. Ligjdhënësi gjithashtu ka paraparë edhe Urdhrin Mbrojtës Emergjent si dhe Urdhrin Mbrojtës të Përkohshëm Emergjent. Urdhri mbrojtës emergjent lëshohet nga gjykata me procedurë të shpejtuar brenda 24 orëve në rast të rrezikut tuaj të drejtpërdrejtë emergjent. Urdhrin mbrojtës të përkohshëm emergjent e lëshon komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë për dhunë në familje jashtë orarit të punës së gjykatës. Ky urdhër parashihet zakonisht gjatë emergjencës në rastet e dhunës që ndodhin gjatë vikendeve apo pushimeve zyrtare. [271]

Në aspektin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2008 ka ndihmuar në 694 raste, prej të cilave 555 raste dhunë në familje.[272]

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka qenë që nga fillimi pjesë e partneritetit për mbrojtjen e viktimave te dhunës në familje. Për nëpunësit e shërbimeve sociale është

[270] Dhuna në familje 2004-2008-Hulumtim i realizuar nda Departamenti i Institutit për Politika Sociale (MPMS).
[271] T'i njohim te drejtat tona (Përgatitur nga Besim M. Kajtazi) - GASGE, Prishtinë, 2005.
[272] Raporti vjetor 2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.
Gjatë vitit 2008 MD ka iniciuar 96 Urdhra për mbrojtje të viktimave, në mesin e tyre 26 Urdhra për mbrojtje emergjente të iniciuar si dhe 59 Urdhra për mbrojtje të iniciuar. 57 raste nuk kanë pranuar ndihmën nga mbrojtësit e viktimave. Deri me tani janë 24 viktima të cilat janë të strehuara.
Ndërkohë që në vazhdim (duke u trajtuar) janë 650 raste, të cilave MD është duke u ofruar ndihmë në këto fusha:
124 raste të viktimave janë përfaqësuar në seanca gjyqësore; 31 raste janë përfaqësuar në seanca hetimore në prokurori; 240 rasteve u është ofruar informim ligjor për procedurat gjyqësore dhe të prokurorisë; 59 raste janë shoqëruar në Qendrat Sociale për Punë, duke i ndihmuar në sajimin e marrëdhënieve bashkëshortore, duke u mundësuar takimet më fëmijë si dhe duke i ndihmuar në të siguruarit e ndihmave sociale; 22 raste të dhunës në familje janë të përsëritura;
1 rast i keqtrajtimit seksual është i përsëritur; 2 raste të trafikimit me qenie njerëzore janë të përsëritura;
11 raste gjenden në ekzakimin mjeko-ligjor.

hartuar doracaku: “Reagimi ndaj Rasteve të Dhunës në Familje” në partneritet me OSBE-në. Për zbatimin praktik të tij janë realizuar trajnime në të gjitha regjionet e Kosovës, edhe për nëpunësit e minoritetit serb. Gjithashtu MPMS ka qenë pjesë e fushatës për vetëdijesimin e publikut, dhe emisioneve televizive të organizuara për këtë qëllim. Edhe në mjetet e shkruara të informimit janë dhënë informacione për këtë temë.

Departamenti i Mirëqenies Sociale (DMS) në kuadër të MPMS-së ka krijuar një partneritet të mirë me strehimoret për mbrojtjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. Me këto strehimore Ministria ka marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara dhe ka mbuluar shpenzimet vjetore prej 50% për viktima të dhunës në familje. Aktualisht funksionojnë gjashtë (6) strehimore për strehimin e viktimave të dhunës në familje që me sukses kanë plotësuar nevojat. Aktivitetet që zhvillohen janë preventivë me qëllim të zvogëlimit të nevojës afatgjatë për këto strehimore. [273]

Shërbimi Policor i Kosovës**,** ka krijuar njësi të veçantë kundër dhunës në familje[274] e cila i trajton rastet e dhunës familjare. Në këtë njësi, janë të përfshirë zyrtarë policorë të dy gjinive, dhe të gjitha komuniteteve. Mirëpo, funksionimin e plotë kjo njësi e ka arritur me ndërtimin e infrastrukturës ligjore siç është Rregullorja për Mbrojtje Kundër Dhunës Familjare e UNMIK-ut Nr. 2003/12, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) dhe Parimi 6.18 Dhuna në Familje në Rregulloren e ShPK-së.

3.4 Arsimimi

Varësia ekonomike e grave dhe qëndrimet shoqërore që parandalojnë përfshirjen e grave në vendimmarrje përgjithësisht duket se injorohen.[275] Pozita ekonomike e grave është e ndërlidhur me qasjen e barabartë në arsim dhe punësim.[276] Megjithatë, injorimi i shtrirë i institucioneve vendore dhe partive politike mbi varfërinë gjinore është i shprehur. Varfëria, më parë sesa siguria fizike, konsiderohet nga shumica e respondentëve si dëmtuese e pozitës ekonomike të grave dhe si e tillë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në pjesëmarrjen e vajzave në arsim.

Infrastruktura e dobët rrugore dhe çështje të sigurisë janë faktorë që ndikojnë në vijimin e shkollimit të vajzave. Sipas publikimit të Institutit Riinvestit[277], të rriturit në zonat rurale (mbi 16 vjeç) udhëtojnë mesatarisht 18 kilometra në ditë për të shkuar në shkollë. Po ashtu, numri i pamjaftueshëm i objekteve shkollore e rëndon edhe më shumë problemin e shkollimit.

Për sociologun Shemsi Krasniqi, arsimimi i gruas është kusht për realizimin e barazisë gjinore, dhe jo vetëm për fuqizimin e gruas, por edhe për fuqizimin e familjes dhe të komunitetit në

[273] Raporti i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat, Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, për Komitetin për të Drejtat, Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Gjenevë.
[274] Njësia e dhunës familjare është e ndërtuar në tri nivele: Niveli Lokal-Në të gjitha stacionet janë dy hetues primarë të dhunës familjare, që merren me këto raste, të cilët janë të trajnuar dhe të përgatitur për ketë lëmi. Niveli Regjional- Në nivel regjional janë dy hetues të dhunës familjare të trajnuar, të cilët gjithashtu punojnë në këtë fushë duke koordinuar punën në regjionet e tyre me policinë dhe me organizata tjera që merren me këtë dukuri. Niveli Qendror-Në nivelin qendror- Drejtorati i Krimeve të Rënda, janë dy policë për dhunë familjare, të cilët menaxhojnë dhe mbikëqyrin tërë punën që është kryer në nivele të stacioneve dhe regjioneve.
[275] Intervistë me Cyme Mahmutaj, korrik 2007.
[276] Intervistë me Flora Brovina, gusht 2007.
[277] Riinvest 2005; “Profili socio-ekonomik i Kosovës dhe sfidat e zhvillimit”

tërësi...Arsimim nuk do të thotë vetëm mënyrë e të menduarit, por edhe mënyrë tjetër e të jetuarit.[278]

Në Kosovë, analfabetizmi ka dimensione të gjinisë, moshës dhe vendbanimit. Analfabetizmi është më i lartë në zonat rurale sesa në ato urbane. Të dhënat dhe analiza e Studimit të Buxhetit Familjar (Household Budget Survey) tregojnë se vajzat dhe gratë të deklaruara analfabete (mbi 7 vjeç, që nuk dinë shkrim-lexim) janë në masën 9.1 %. Ndërsa, për djemtë ky tregues është në masën 2,8%. Pothuajse 14% e grave (15 vjeç e më lart) që jetojnë në zonat rurale janë evidentuar si analfabete, në raport me meshkujt analfabetë që është më pak se 10%.[279]

Nazlie Bala, thekson se me shumë se 60% e popullatës në Kosovë jeton dhe vepron në zonat rurale. Nuk ka mekanizma edukativo arsimor në ngritjen e vetëdijes ne zonat rurale në katër drejtime të rëndësishme: Ekonomi, Shëndetësi, Arsim dhe Mirëqenie.[280]

Në Kosovë, është evidente mungesa e statistikave (kualitative dhe kuantitative), posaçërisht kur është fjala për edukimin (arsimimin) e vajzave dhe arsyet e moskyçjes së tyre në procesin edukativ. Megjithatë ekzistojnë tregues të cilët në mënyrë eksplicite reflektojnë ekzistimin e këtij fenomeni (diskriminimi gjinor në edukim) në shoqërinë kosovare varësisht nga periudhat kohore.

Ekzistojnë treguesit që thonë se sa më i ulët të jetë niveli arsimor i gruas, aq më e dobët është edhe fuqia e saj vendimmarrëse, për shkak të mundësive shumë më të pakta për punësim e sigurim të një pavarësie ekonomike. Po kështu, gratë në zonat rurale, gratë e varfëra, si dhe ato të papunësuara, kanë pak të drejta në vendimmarrjen për çështje të rëndësishme brenda familjes**.**[281]

MASHT, në vitin 2008 publikoi raportin -Treguesit dhe të dhënat Statistikore në arsim 2004/05, 05/06, 06/07.[282]

Struktura gjinore në nivelin parashkollor përkatësisht parafillor dhe në atë fillor e të mesëm të ulët është pothuajse e njëjtë me strukturën e përgjithshme të popullsisë e cila përafërsisht sillet rreth 48% të gjinisë femërore me 52% të gjinisë mashkullore.

Me përkrahje të UNICEF-it, MAShT-i ka përfshirë lëndë opsionale në nivelin tetëvjeçar, “Aftësitë e jetës” me module që kanë të bëjnë me stereotipa gjinorë, role gjinore, trafikimi dhe aftësi të komunikimit dhe bashkëpunimit. Ka përfunduar moduli i parë dhe i dytë i trajnimit të mësimdhënësve për lëndën zgjedhore “Aftësitë për jetën“. Në trajnim janë përfshirë 136 mësimdhënës nga 136 shkolla të Republikës së Kosovës është organizuar tryeza e rrumbullakët për prezantimin e raportit mbi monitorimin e lëndës zgjedhore “Aftësitë për jetën”.

[278] Shemsi Krasniqi, cituar sipas Besa Bytyqi: Gruaja e arsimuar, fuqizimi i garantuar, Revista, Teuta, Shtator 2008, fq.12
[279] ESK; “Kosova në shifra 2005”, v.c fq.
[280] Intervistë me Nazlie Bala, shkurt 2009.
[281] Intervistë me Atifete Jahjaga, shkurt 2009.
[282] Shih Raportin e MASHT-Treguesit dhe të dhënat Statistikore në arsim 2004/05, 05/06, 06/07.
Ky raport ka për qëllim të paraqes treguesit dhe të dhënat statistikore për vitet shkollore 2004/2005; 2005/2006 dhe 2006/2007 , për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, të cilat janë të mbledhura, të sistemuara dhe të përpunuara në kuadër të programit softverik Devinfo.

Qëllimi i tryezës ka qenë prezantimi i raportit vlerësues lidhur me mbarëvajtjen e lëndës "Aftësitë për jetën" dhe është diskutuar për të ardhmen e lëndës.

Në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Shërbimet katolike për asistencë, janë krijuar fushata mediale, debate dhe aktivitete për të bërë fushatë kundër braktisjes së hershme të shkollës nga ana e vajzave. Ekipet e kontaktit janë organizuar për të punuar me familjet dhe për t'u përpjekur që t'i inkurajojnë familjet që t'i kthejnë vajzat në shkollë. Te komunitetet RAE, ekziston një tendencë më e madhe për vajzat që të braktisin shkollën pas klasës së nëntë për shkak të martesave të hershme.

Nivele relativisht të ulëta të arsimit komplikojnë mundësitë për punësim me pagesë për shumë gra. Për shembull, përderisa analfabetizmi si për meshkuj ashtu edhe për femra është i lartë deri në moshën 45 vjeçe, për gratë mbi moshën 50 vjeçare kjo shkallë është 24 për qind krahasuar me atë të meshkujve prej 4 për qind. Veç kësaj, pas sistemit të ri të shkollimit të futur në përdorim në vitin shkollor 2003/2004, 81 për qind të braktisjeve të shkollës në të gjitha nivelet e arsimit janë të gjinisë femërore. Niveli më i lartë i arsimit të përfunduar nga shumica e meshkujve dhe femrave është shkolla e mesme; vetëm 6 për qind meshkuj dhe 5 për qind femra të moshës njëzet dhe tridhjetë vjeçare në vitin 2003 e kanë përfunduar arsimin e lartë.[283] Është e qartë se duhen më shumë strategji për promovimin e të drejtave të njeriut të femrave në arsim, në mënyrë që femrat të trajnohen si duhet për të hyrë në nivele të ndryshme të vendimmarrjes politike dhe civile. Ndonëse është e dukshme se gratë janë të përjashtuara nga jeta publike për shkak të prapavijës së tyre të dobët arsimore dhe mungesës së mundësive të punësimit, kultura mashkullore e sektorëve politikë dhe civilë kontribuon në masë të madhe në mungesën e grave.

"Do të ishte më mirë nëse do të futej Rezoluta 1325 në programet mësimore e jo vetëm të bëhen ligjërata kohë pas kohe. Është mirë që gjithçka rreth çështjeve gjinore të jenë pjesë e këtyre programeve sepse krijimi i modeleve gjinore fillon nga familja pra nëse në familje nuk ka mundësi edukimi tjetër atëherë shkolla do të jetë ajo e cila do të ndihmojë të edukojë në mënyrë të drejtë..."[284] Do të filloja me kontrollimin e eksperiencës së mësuesve nëse duhet trajnuar ata apo jo qe të shohim qëndrimet e tyre kur është në pyetje barazia gjinore që të mos japim shembuj të gabuar tek gjeneratat e reja.[285]

3.5 Trafikimi dhe dhuna në baza gjinore

Kosova mbetet burim, vend transiti dhe pikë destinimi për gratë dhe fëmijët e trafikuar për seks dhe punë në familje.[286] *Amnesty International* raporton se Kosova është bërë vend kryesor destinimi për gratë dhe vajzat e trafikuara për prostitucion të detyruar.[287]

Që nga arritja e KFOR-it dhe UNMIK-ut në vitin 1999, femrat, kryesisht nga Moldavia, Bullgaria dhe Ukraina janë trafikuar në Kosovë dhe gjithnjë e më shumë vajza dhe gra vendore trafikohen

[283] Po aty. f. 27.
[284] Interviste me Virgjina Dumnica, shkurt 2009.
[285] Intervistë me Susanne Backstedt, shkurt 2009.
[286] Shih http://www.unifem.sk/index.cfm?modulewwwproject&pagewwwcountry&CountryISOwwwKS#_ftn Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 62: Kosova mbetet një zonë e origjinës, transitit dhe destinimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore. Viktimat e trafikimit (kryesisht për shfrytëzim seksual) janë kryesisht nga Moldavia, Rusia dhe Ukraina. Janë duke u rekrutuar në trafikim një numër në rritje i shqiptareve të Kosovës në moshë jomadhore dhe prej familjeve me situatë të pafavorshme.
[287] A do të thotë se i kemi të drejtat? Mbrojtja e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave të trafikuara për prostitucion të detyruar në Kosovë, 2004, http://Web.amnesty.org/library/Index/ENGEUR700102004

brenda dhe jashtë Kosovës. Më herët shumica e femrave që janë identifikuar kanë qenë viktima të ardhura nga jashtë, por në vitet e fundit kjo ka ndryshuar. Tani numri më i madh i femrave viktima janë nga Kosova. Shumica nga to janë të mitura, të cilat janë trafikuar brenda Kosovës ose jashtë vendit. Kosova është një burim, vend transit dhe shtet me destinim të grave dhe fëmijëve, kryesisht me synim të përdorimit seksual...Unë mendoj, thekson në një intervistë Ricard Sondeijker, udhëheqës i Njësisë për Antitrafikim pranë OSBE-së, që shumica e femrave kosovare nuk janë në dijeni të trafikimit njerëzor dhe për rrezikun e këtij krimi. Prandaj është me rëndësi të organizojmë fushata për vetëdijesim.[288]

Në Kosovë, në vitin 2001, u miratua rregullorja e UNMIK-ut për ndalimin e trafikimit me njerëz. Në vitin 2003 u adoptua Kapitulli i veçantë për luftimin e krimit të trafikimit në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Gjithashtu janë ndërmarrë edhe një varg masash tjera, si: Plani i Kosovës 2005-2007 për luftimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme, në korrik të vitit 2008 ka miratuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit kundër trafikimit me Qenie Njerëzore për vitin 2008-2011.

Përderisa OSBE-ja ka pranuar se trafikimi është problem i madh, masat e UNMIK-ut kanë qenë jo të përshtatshme për të luftuar këtë problem.[289] OSBE-ja ka definuar mirë kornizën për veprim që duhet të ndërmerret nga vendet anëtare në luftimin e trafikimit. Vendimi i Këshillit Ministror të Maastricht-it nr. 2, Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2003) ka sjellë *Planin e veprimit të OSBE-së për të Luftuar trafikimin e qenieve njerëzore*[290]. Plani identifikon obligimet e institucioneve të OSBE-së dhe vendeve pjesëmarrëse dhe propozon rekomandime që duhet të ndërmerren në fushën e hetimit, zbatimit të ligjit dhe ndjekjes gjyqësore, mbrojtjes së viktimave dhe parandalimit të trafikimit.[291]

OSBE-ja vendos përgjegjësinë përfundimtare në përpjekjet kundër trafikimit në institucionet vendore. Institucionet vendore kanë ndërmarrë masa të ndryshme për të luftuar trafikimin. Dy Procedurat Standarde Operative (PSO-të) në Kosovë përbëhen nga politikat dhe obligimet shtetërore për të trajtuar gratë dhe fëmijët e trafikuar si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit. Memorandumi i Mirëkuptimit që themeloi PSO-në e parë është përpiluar në vitin 2000 në mes të OSBE-së, Njësitit hetues të trafikimit dhe prostitucionit brenda policisë së UNMIK-ut (TPIU), Organizatës ndërkombëtare për migrime (IOM) dhe një OJQ-je ndërkombëtare.[292] Grupi punues për asistencë dhe përkrahje të drejtpërdrejtë është mandatuar për të krijuar dhe zbatuar

---

[288] Ricard Sondeijker, udhëheqës i Njësisë për Antitrafikim pranë OSBE-së, intervistë në Revistën Teuta, dhjetor 2008, fq.16

[289] UNDP, Rini: Një gjeneratë e re për Kosovën, Raport i zhvillimit njerëzor, 2006, Prishtinë
Koordinatori Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, ZQM ka pasur rolin udhëheqës dhe koordinues në koordinimin e të gjitha veprimtarive dhe aktiviteteve në parandalimin dhe luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë ,deri në vitin 2008 kur kompetencat në këtë sferë kalojnë në Ministrin e punëve të Brendshme. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme,koordinon dhe organizon punën për hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës me dt ???? miratoi Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore (2008-2011)

[290] Vendimi i OSBE-së nr. 557 i Këshillit të përhershëm, korrik 2003
http://www.osce.org/documents/pc/2003/07/724_en.pdf

[291] Ueb faqja e Sekretariatit – Zyrës së përfaqësuesit special dhe koordinatorit për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, http://www.osce.org/cthb/13336.html

[292] Vlerësimi për themelimin e mekanizmit referues për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë OSBE, Departamenti për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete, Njësia kundër trafikimit, tetor 2007
http://www.osce.org/documents/mik/2007/10/27677_en.pdf

"asistencë dhe përkrahje të drejtpërdrejtë për politikat favorizuese për viktimat"[293] dhe përbëhet nga Njësia kundër trafikimit të qenieve njerëzore (THBS) pranë Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK), Divizionit për Avokim dhe Asistencë për Viktima (DAAV) pranë Ministrisë së Drejtësisë (MD), dy strehimoreve, Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), IOM-it dhe OSBE-së.

Në vitin 2005, Qeveria e Kosovës e ka miratuar planin e parë të veprimit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, kornizë kjo që udhëhiqte të gjitha përpjekjet kundër trafikimit në Kosovë. Plani ishte një përpjekje e përbashkët nga Qeveria e Kosovës, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jo-qeveritare, për zvogëlimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe për zbutjen e pasojave të tij. Ai ka përfshirë periudhën nga maji 2005 deri në dhjetor të vitit 2007. Në nivelin strategjik, *Plani i Veprimit i Kosovës për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore* (PVK), i miratuar në maj të vitit 2005, përvijon projekte të ndryshme dhe mekanizma strategjik për të luftuar trafikimin. Koordinatori kosovar kundër trafikimit i përgjigjej drejtpërdrejtë Kryeministrit, dhe ishte përgjegjës për zbatimin e PVK-së dhe i raporton Qeverisë. Ai po ashtu, kryeson grupin punues ndërministror për Parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen ligjore, që është përgjegjësi i drejtpërdrejtë për zbatimin e parimeve të PVK-së. Grupi punues ndërministror përfshin përfaqësues të Zyrës për qeverisje të mirë (ZQM) pranë Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MAShT), Ministrisë së kulturës, rinisë, sportit dhe çështjeve jorezidente, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS-së), Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), Ministrisë së shërbimeve publike (MShP) dhe Kreun e DAAV të MD-së.[294]

Në vitin 2007 institucionet kosovare konsideroheshin përgjegjëse për luftimin e trafikimit.[295] Megjithatë, shumë probleme ekzistojnë me këtë strukturë. Ekziston një mungesë e qartësisë për mënyrën më të mirë të funksionimit të mekanizmave të identifikimit dhe atyre referuese; parashtrohen pyetje mbi mënyrën e sigurimit të analizave të të dhënave aktuale mbi trafikimin; aktualisht nuk ka fare kompensim për viktimat e trafikimit; dhe duhet të ekzistojë një koordinator me orar të plotë kundër trafikimit. Veç kësaj: …ligjet penale diskriminuese të pas luftës …kanë mungesë të drejtësisë gjinore, dhe pjesëtarët e familjes që kufizojnë sigurinë e grave e vajzave në masë të madhe zvogëlojnë mundësinë e tyre të angazhimit në aktivitete të rindërtimit të paqes.[296]

Qeveria e Kosovës më 31 korrik 2008 ka miratuar Planin e ri Kosovar të Veprimit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (2008 -2011). Zëvendës Ministri i Brendshëm është nominuar Koordinator Kombëtar për Anti Trafikim. Strategjia dhe Plani i Veprimit për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore është aprovuar në korrik.

---

[293] Vlerësimi për themelimin e mekanizmit referues për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë OSBE, Departamenti për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete, Njësia kundër trafikimit, tetor 2007, http://www.osce.org/documents/mik/2007/10/27677_en.pdf, f. 14.

[294] Vlerësimi për themelimin e mekanizmit referues për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë OSBE, Departamenti për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete, Njësia kundër trafikimit, tetor 2007, http://www.osce.org/documents/mik/2007/10/27677_en.pdf

[295] Shih Vlerësimi për themelimin e mekanizmit referues për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë, përgatitur nga Njësia kundër trafikimit, Departamenti për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete.

[296] McKay, S., Kapitulli 7. Gratë, Siguria njerëzore dhe ndërtimi i paqes: Analizë feministe, http://home.hiroshima-u.ac.jp/heiwa/Pub/E19/Chap7.pdf

Sidoqoftë, prokurorët dhe gjyqtarët nuk janë të përgatitur për t'u marrë me viktimat e trafikimit. Prokurorët nuk janë proaktiv dhe bazohen kryesisht në deklaratat e viktimave. Disa dispozita të Kodit të procedurës Penale për trafikimin e qenieve njerëzore nuk janë adekuate. [297]

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka dështuar të hetojë në mënyrë të duhur dhe të ngrisë aktakuza kundër personave të cilët kanë qenë të përfshirë në veprimtaritë e trafikimit apo krime të tjera të ndërlidhura (për shembull përdhunimi dhe privimi i paligjshëm i lirisë) të kryera kundër viktimave të trafikimit me njerëz. Numri i rasteve të raportuara të trafikimit mbetet pothuajse i njëjtë gjatë gjithë periudhës për të cilën raportohet. Mirëpo, statistikat e Shërbimit Policor të Kosovës tregojnë që numri i viktimave nga Kosova është rritur. Së voni, trafikuesit me sa duket e kanë bartur tregtinë e seksit komercial nga vendet publike siç janë restorantet dhe kafe baret në shtëpi private dhe shërbime përcjellëse për të shmangur zbulimin.[298]

Që nga qershori i vitit 2007, RrGGK ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në një projekt të mbështetur nga UNFPA i quajtur "Ofrimi i sigurisë, Promovimi i shëndetësisë; Luftimi i dhunës së bazuar në gjini në Kosovë. Ky projekt ka për qëllim të ofrojë mbështetje tek gratë dhe fëmijët që vuajnë nga dhuna e bazuar në gjini si dhe të përmirësojë qasjen për kujdes shëndetësor reproduktiv.[299]

Zhvillimi i iniciativave kompetente kundër trafikimit dhe të punës mbi dhunën në familje brenda Policisë së Kosovës së fundi ka konsoliduar kapacitetin e policisë vendore për të trajtuar dhunën në baza gjinore. Prania e policeve femra ka qenë e rëndësishme për të trajtuar në mënyrë më të efektshme me krime të tilla. Ndryshime të ngadalta por pozitive janë parë në përfshirjen e çështjeve gjinore në këto fusha të interesit, përkundër këmbënguljes së stereotipizimit të çështjeve gjinore dhe mosbesimit të përgjithshëm në përparësitë sociale të politikave të drejtësisë sociale të ndjeshme ndaj gjinive.

Ndonëse viktimat janë duke raportuar më shumë raste në sistemin e drejtësisë dhe faktit që kanë ndodhur zhvillime pozitive në ligj dhe politika, gjykatat e Kosovës janë duke dështuar në zbatimin adekuat të Rregullores kundër dhunës në familje. Megjithatë, ekzistojnë shumë shembuj të bashkëpunimeve të shoqërisë civile me aktorë ndërkombëtarë dhe departamente të qeverisë mbi të drejtat e njeriut të gruas. Këto përfshijnë takimet e RrGGK-së për të formuluar një "Draft Strategji për të drejta të njeriut në Kosovë", si dhe punën e UNIFEM-it me njësitë gjinore të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK) në LBGJ dhe Rezolutën 1325.

Në vitin 2005, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) ka sponsorizuar një studim në bashkëpunim me disa organizata të grave në Kosovë mbi dhunën ndaj femrave për Divizionin e Kombeve të Bashkuara për Avancimin e Grave (UNDAW). ZQM ka bashkëpunuar me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) në hartimin e raportit mbi ngacmimet seksuale në Universitetin e Prishtinë dhe me Ministrinë e Shërbimeve Publike (MSHP) në hartimin e Politikave Kundër Ngacmimit Seksual në Institucionet e Administratës Publike. Këto dhe shembuj tjerë paraqesin potencialin e grupeve të shoqërisë civile për të punuar në mënyrë më

[297] Shih Raporti i Progresit për Kosovë (sipas Rezolutës 1244) 2008, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 05.11.2008-Versioni i përkthyer Shqip, fq. 62:
[298] Shih gjerësisht: Raporti i OSBE-së -Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë (Verë 2007)
[299] Zëri i Gruas Kosovare" Botimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Volumi V, Numri 4 shtator 2007 - nëntor 2007, www.Womensnetwork.org

të efektshme së bashku me aktorë shtetëror, në artikulimin e parimeve të Rezolutës 1325, në avokim për të drejta të njeriut.

Po ashtu Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron edhe rastet e trafikimit në sistemin e drejtësisë të Kosovës për pajtueshmëri me të drejtën vendore dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

OSBE-ja me shqetësim konstaton se autoritetet gjyqësore (gjyqtarët dhe prokurorët) shpesh dështojnë ta kuptojnë plotësisht veprën penale të trafikimit, ashtu siç parashihet me nenin 139 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).[300]

Është e qartë se në vitin 2007, numri i grave dhe vajzave të reja vendore të cilat trafikohen brenda si dhe jashtë Kosovës, është në rritje. Përkundër deklarimit nga ana e OSBE-së në vitin 1999 se trafikimi është problem madhor e shqetësues, masat e UNMIK-ut mbetën jo të kënaqshme. [301]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për barazi Gjinore, Ligji kundër Diskriminimit, Ligji për Familje, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, dhe Strategjia për të Drejtat e Njeriut,janë të arritura të rëndësishme në drejtim të barazisë gjinore dhe gjithsesi lehtësojnë promovimin e të drejtave të njeriut më gjerësisht në Kosovë. Megjithatë, shumica e meshkujve dhe femrave në Kosovë mbesin të painformuara për të drejtat e tyre.

Aktiviste femra të RrGGK-së janë aktive në fushata publike për ngritjen e vetëdijes mbi dhunën ndaj femrave dhe në informimin e femrave mbi të drejtat e tyre. Fushata e vitit 2005 përfshinte rrëfime personale në shfaqje teatrale, duke adresuar një varg shembujsh të dhunës në baza gjinore, përfshirë ato të kryera edhe nga ndërkombëtarët.

3.6 Të drejtat e pakicave

Në kuadër të Qeverisë së Kosovës ekziston Ministria për komunitete dhe kthim, [302] e cila ndër të tjera, zhvillon politika dhe promovon e zbaton ligje për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, të zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e një strategjie qeveritare për ndihmë që ju drejtohet komuniteteve dhe kthimeve dhe mbështet zhvillimin dhe zbatimin e këtyre strategjive në të gjitha komunat, të siguron se politika në nivel qendror dhe komunal përfshin dispozita për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, të drejtave të njeriut dhe interesave të të kthyerve, duke përfshirë fushën e lirisë së lëvizjes, përdorimin e gjuhëve, lirisë së shprehjes, përfaqësimit të drejtë, arsimit, punësimit dhe qasjes së barabartë në drejtësi, banim dhe shërbime publike e komunale.[303]

Gjithashtu në kuadër të Zyrës së Kryeministrit vepron Zyra për Komunitete e cila merret me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Ndonëse janë informuar për ekzistencën e Rezolutës 1325, gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane (RAE) në përgjithësi nuk kanë pranuar informata mbi Rezolutën 1325 dhe ligjet relevante kundër diskriminimit dhe barazisë gjinore, dhe nuk kanë farë njohurie se si këto ligje duhet të

[300] Shih Raportin e OSBE-së-Analiza ligjore e rasteve të trafikimit me njerëz në Kosovë Tetor 2007
[301] UNDP, Rinia; Një gjeneratë e re për një Kosovë të re, Raporti i Zhvillimit Njerëzor (Human Development Report), 2006 Prishtinë
[302] Ueb faqja e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim http://www.ks-gov.net/mkk/
[303] Shih Rregullore nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, Shtojca VII

zbatohen apo cilat janë implikimet e zbatimit të tillë për komunitetet dhe familjet e tyre. Gratë e komunitetit RAE janë përjashtuar nga shumica e iniciativave të cilat promovojnë të drejtat e gruas.

Zyra për Qeverisje të Mirë në maj të këtij viti ka publikuar manualin e Ligjit kundër diskriminimit dhe Udhëzimit Administrativ për zbatimin e tij në 5 gjuhë: Shqipe, Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome.

ZQM-ja gjithashtu ka hartuar një përmbledhje të Ligjeve për të drejtat dhe interesat e minoriteteve, në 5 gjuhë: Shqipe, Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome.

Qeveria e Republikës se Kosovës me datën 24 dhjetor 2008 ka aprovuar, Strategjinë për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009- 2015.

Strategjia për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas përbën një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndërtuar një klimë tolerance, pajtimi dhe respekti të ndërsjellë mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë, si dhe për të mundësuar një dialog politik në mes të Republikës së Kosovës dhe vendeve ku tani jetojnë përfaqësuese të këtyre komuniteteve, si dhe me agjencitë e specializuara siç janë (IOM,UNHCR dhe tjera) për të mbajtur nën kontroll procesin. Në strategji identifikohen dhe përcaktohen detyrat më prioritare, ofrohen nga njëra anë masa për të zgjidhur probleme specifike dhe nga ana tjetër masa që kanë për qëllim përmirësimin e përgjithshëm të gjendjes së të drejtave të njeriut dhe integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë. [304]

Strategjia, në radhë të parë adreson, përmirësimin e gjendjes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas që jetojnë në Kosovë, por ofron edhe zgjidhje dhe rekomandime për reintegrimin e personave të kthyer. Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit të saj e për rrjedhojë, është e aplikueshme në Kosovë.[305]

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZKM) në bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, kanë iniciuar projektin "Sqarimi dhe Lehtësimi i Plotësimit të Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës në Institucionet e Republikës së Kosovës". ZQM-ja ka hartuar një përmbledhje të Ligjeve për të drejtat dhe interesat e minoriteteve, e cila është pike veprimi në Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian.[306]

---

[304] Raporti vjetor i punës së Qeverisë 2008, Prishtinë, Dhjetor 2008
Procesi i hartimit të strategjisë ka ndjekur qasjen pjesëmarrëse dhe qasjen e bazuar në të drejta. Në procesin e hartimit është përfshirë edhe dialogu në mes "bartësit të detyrës" dhe "bartësit të drejtave" dhe është paraparë vazhdimi i komunikimit dhe i bashkëpunimit gjatë tërë procesit të zbatimit dhe monitorimit, duke krijuar kështu pronësi mbi strategjinë dhe mirëkuptim të dyanshëm. Qasja pjesëmarrëse ka rezultuar në pjesëmarrjen efektive të përfaqësuesve qeveritarë dhe përfaqësuesve të tri komuniteteve (Romë, Ashkali dhe Egjiptianë), dhe ka përfshirë edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile nga popullata shumicë. Tryezat, punëtoritë dhe konferencat rajonale gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e një game të gjerë të aktorëve nga qeveria dhe komunitetet. Kjo qasje ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë.
[305] Për më tepër informata për Qasjen e bazuar në të Drejta shih: Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Pyetjet e Shpeshta për Qasjen e bazuar në të Drejtat e Njeriut për Zhvillimin e Bashkëpunimit, Nju Jork, Gjenevë 2006.
[306] Raporti vjetor i punës së Qeverisë 2008, Prishtinë, Dhjetor 2008, fq.19

Disa OJQ Rome, me përkrahje të Shpresa Agushit, kanë kontribuar në zbatimin e Rezolutës përmes konsultimeve dhe këshillimeve në grupet punuese të qeverisë, OSBE-së dhe KFOS-it në trajtimin e çështjeve që ndikojnë te gratë RAE. Që nga viti 2006, disa gra rome kanë punuar në monitorimin e zbatimit të barazisë gjinore, ligjeve kundër diskriminimit dhe ligjeve të të drejtave të grave në lidhje me të drejtat e pakicave dhe kanë raportuar te OSI dhe Parlamenti Evropian.[307]

* * *

Më një fjalë, disa politikanë kosovarë janë bërë gjithnjë e më aktivë në përkrahjen publike të organizatave të grave dhe duket se e pranojnë rëndësinë e themelimit të legjislacionit të të drejtave gjinore. Aktivistet vendore kanë luajtur një rol të madh në ndihmën e ofruar për politikanët për t'u bërë më të vetëdijshëm për barazinë gjinore dhe në avokimin e suksesshëm për legjislacion që përkrah barazinë gjinore si e drejtë e njeriut. Kushtetuta, Plani Kombëtar i Veprimit, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji kundër diskriminimit dhe Ligji për familje janë të arritura të rëndësishme për barazinë gjinore dhe ndihmojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mënyrë më të gjerë në Kosovë.

Megjithatë, përderisa mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore ekzistojnë në nivel legjislativ, shumë meshkuj dhe femra në Kosovë janë të painformuar për të drejtat e tyre dhe mënyrën për t'iu qasur mbrojtjeve të ofruara nga ato ligje. Në këtë mënyrë, zbatimi gjithëpërfshirës i parimeve ligjore ndërkombëtare mbetet të realizohet në tërësi.

Në Kosovën e pasluftës, dhuna dhe ngacmimi seksual ndaj femrave është rritur duke pasqyruar ndikimet e situatës së rëndë ekonomike dhe traumës së pasluftës. Aktivistet e RrGGK-së janë aktive në fushatat publike për ngritjen e vetëdijes mbi dhunën ndaj gruas dhe në informimin e grave për të drejtat e tyre. Fushata e vitit 2005 përfshinte rrëfime personale në shfaqje teatrale dhe adresoi një varg shembujsh të dhunës në baza gjinore, përfshirë atë të kryer nga ndërkombëtarët.

Përderisa krimet e dhunshme kanë pësuar zbritje të vazhdueshme që nga themelimi i CIVPOL/ShPK, dhuna në familje vazhdon të jetë në shkallë brengosëse por është duke u raportuar gjithnjë më shpesh. Ndonëse viktimat janë duke raportuar më shumë raste para sistemit të drejtësisë dhe se janë treguar zhvillime pozitive në ligj dhe polici, gjykatat e Kosovës janë duke dështuar në zbatimin adekuat të Rregullores kundër dhunës në familje.[308]
Në vitin 2005, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) sponsoroi një studim, në bashkëpunim me disa organizata të grave në Kosovë, mbi dhunën ndaj grave për Divizionin e OKB-së për Avancimin e Gruas (UNDAW).

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, siç u cek më lartë, ka bashkëpunuar me ZQM për t'i hartuar Universitetit të Prishtinës një raport mbi ngacmimet seksuale në vendin e punës. Po ashtu, QKSGj në bashkëpunim me MSHP dhe institucionet tjera vendore kane hartuar Draft Politikat kundër Ngacmimit Seksual ne Administratën Publike. Ndonëse nuk janë vënë në fuqi akoma, kjo tregon për potencialin që kanë grupet e shoqërisë civile për të punuar në mënyrë të

[307] Shpresa Agushi, intervistë në vitin 2007.
[308] Ligji për familje ndalon dhunën në familje; Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 mbi Shpalljen e Kodit të Përkohshëm Penal, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbulon "Veprat penale ndaj jetës dhe trupit" përfshirë dhunimin, sulmimin seksual; Rregullorja 2003/12 parasheh tri lloje të urdhrave mbrojtës, përfshirë atë ndaj Dhunës në familje.

efektshme së bashku me aktorë shtetërorë në artikulimin e parimeve të Rezolutës 1325 në avokimin për të drejta të njeriut. Qendra Kosovare për Studime Gjinore në veçanti, është duke zhvilluar marrëdhënie bashkëpunuese me qeverinë, institucionet, si dhe me mediet kosovare.

RrGGK vazhdon të jetë mbrojtës dhe promotor i rëndësishëm i të drejtave të njeriut për gratë në Kosovë. Po ashtu, RrGGK në dy vitet e fundit ka shënuar marrëdhënie të rëndësishme pune me organizata kyçe të grave në rajon.

Në vitin 2004, Ligji Kundër Diskriminimit ishte nxitur nga nevoja për të siguruar legjislacion që mbështeste "rëndësinë e sigurimit të bashkëjetesës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe përfaqësimin e drejtë të popullit të Kosovës në proceset e zhvillimit të institucioneve demokratike të vetë-qeverisjes." LKD ndalon diskriminimin e drejtpërdrejt dhe po ashtu përkufizon të gjitha format e saja, mes tjerash, ngacmimin, viktimizimin dhe segregacionin. Ai adreson diskriminimin në të gjitha sferat e jetës sociale: punësim, edukim, kujdes social, strehim, siguri personale dhe qasje në jetën publike. Një inovacion kyç është që barra për të dëshmuar i është vënë palës së akuzuar për veprime diskriminuese. Individi apo institucioni duhen të dëshmojnë se nuk ka pasur diskriminim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për femrat që kanë vështirësi të mëdha në diskurset gjinore me mbizotërim patriarkal në Kosovë.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i autorizuar për të pranuar dhe hetuar ankesat lidhur me raste të diskriminimit. Krahas me këtë, qeveria është përgjegjëse për ngritjen e vetëdijes publike lidhur me Ligjin kundër Diskriminimit. Tani ofrohen trajnime specifike për gjyqtarët dhe prokurorët mbi përdorimin praktik dhe të vazhdueshëm të ligjit. Gjithashtu trajnime ofrohen edhe për nëpunësit civilë.

Igballe Rogova thekson: ne më shumë jemi fokusuar që të zbatohet Rezoluta 1325 nga qeveria dhe bashkësia ndërkombëtare se sa që kemi punuar ne vetëdijesimin e popullatës lidhur me Rezolutën. Në këtë drejtim ne si RRGGK bëmë një fushatë "T'i njohim të drejtat tona" por mendoj se nuk ka qenë e mjaftueshme. Mirëpo, këtu një rol të rëndësishëm në vetëdijesimin e popullatës kanë dhënë mediat, veçanërisht RTV21, që ka realizuar 2 filma dokumentar për Rezolutën 1325, dhe debate televizive,[309]

Standardet e të drejtave të njeriut sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë janë të mjaftueshme për nga ana teorike, për t'u përballur me këtë shkelje të të drejtave të njeriut; sidoqoftë shikuar nga mungesa e financimit, ekspertiza dhe koordinimi, kjo dëshmon për mungesë të duhur të vullnetit politik dhe mosefikasitet i duhur i mekanizmave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

4. Përfshirja e Perspektivës Gjinore në Raportimet e KB-së

Rezoluta 1325, Neni 17 Kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm që, "atje ku është e përshtatshme, që të përfshijë në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit, përparimin në drejtimet bazë gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse dhe në të gjitha aspektet e tjera që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat."

Nga ana e organizatave ndërkombëtare vazhdon të mbetet një nivel i ulët i kuptueshmërisë së përfshirjes së çështjeve gjinore si dhe ngatërrimi i zakonshëm është barazimi i konceptit "gjinor" me gratë, në vend se të shqyrtohet vleftësimi dallues i meshkujve dhe femrave në shoqëri. Në

[309] Intervistë me Igballe Rogova, shkurt 2009.

shumë raste, ndërkombëtarët kanë argumentuar nevojën për “barazi gjinore” si të pamundur të arrihet në “shoqëri kaq patriarkale” dhe kanë komentuar se shumica e femrave janë aq të shtypura saqë Ligji mbi Barazinë Gjinore i vitit 2004 nuk ka mundur të jetë më shumë sesa vetëm përmbledhje retorike. Është argumentuar se qëndrime të tilla përbrenda administratës ndërkombëtare, kanë dobësuar përpjekjet e qeverisë dhe shoqërisë civile për të bërë presion lidhur me drejtësinë gjinore, siç është paraparë nga Rezolutës 1325 si dhe lidhur me traktatet mbi të drejtat e njeriut. Është e qartë se ka shumë përjashtime kur përmendet ky qëndrim i caktuar, që ka mundësuar disa bashkëpunime të tërthorta drejt artikulimit të Rezolutës 1325 në rregullore, protokolle, kode etike dhe ligje përparimtare të arritura në vitin 2005 e më pastaj.

Megjithatë, artikulimi gjithëpërfshirës i Rezolutës 1325 është penguar deri në një masë nga ana e qëndrimeve negative ndërkombëtare dhe në të njëjtën shkallë si rrjedhojë e moskuptueshmërisë së tyre nga ana e nëpunësve civilë vendorë dhe popullatës së përgjithshme.

EULEX apo UNMIK-u mund të thonë që Rezoluta 1325 është me rëndësi, por në mënyrë që të kuptohet, gratë duhet të marrin një zotim nga ata që janë momentalisht në fuqi, kryesisht meshkuj, se kjo nuk është vetëm për çështje të grave, por se kjo është për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Edukimi mbi Rezolutën 1325 dhe marrëdhëniet e saja me CEDAW, si dhe rëndësinë e saj për procesin e ndërtimit të paqes në Kosovë konsiderohet të jetë thellësisht i nevojshëm në EULEX dhe UNMIK.

Të intervistuarit kanë komentuar se OKB-ja nuk ka nënvizuar Rezolutën 1325 si pikë të nevojshme fokusi për UNMIK-un dhe se PSSP-ja paraprak kishte komentuar mbi rëndësinë e saj. Në sytë e grupeve të shoqërisë civile, mungon konsistenca në qasjen ndaj rezolutës dhe rëndësisë së saj në ndërtimin e paqes në Kosovë. Një dështim i përgjithshëm në identifikimin dhe promovimin e kontrasteve të Rezolutës 1325 me mënyrën se çfarë vëmendje dhe çfarë drejtimi u tregohet çështjeve specifike të ligjit, rendit, eksploatimit seksual e abuzimit, përkundër faktit që ato janë pjesë e fushëveprimit të Rezolutës 1325. Duhet cekur se dështimi i UNMIK-ut për të zbatuar Rezolutën 1325 pasqyron vonesën e saj në përfshirjen e grave vendore eksperte apo organizatave joqeveritare (OJQ-ve) në vendimmarrje dhe planifikim programatik.

Përderisa pohohet në OSBE se Rezoluta 1325 është zbatuar brenda strukturave të saja të brendshme, rezoluta si e tillë nuk është publikuar apo përdorur në mënyrë strategjike dhe publikisht si kornizë e veprimtarisë së OSBE-së në Kosovë. Që nga viti 2004, OSBE-ja ka përfshirë dy këshilltarë për gjini, si dhe një njësi për çështje gjinore së bashku me ekspertë të ndryshëm të emëruar në detyra shtesë lidhur me çështje gjinore, por mungon integrimi i përgjithshëm mes pikave qendrore në OSBE dhe frymës së gjithëmbarshme të organizatës. Këshilltarët për çështje gjinore i raportojnë shefit të departamentit por përfshirja e çështjeve gjinore si e tillë nuk është e prioritizuar më gjerësisht. Sipas të intervistuarve, mungesa e planit specifik të veprimit të OSBE-së ndaj përfshirjes të çështjeve gjinore pasqyron qëndrimin e asaj se në OSBE gjinia shpeshherë konsiderohet si çështje që duhet marrë në konsiderim kur të jetë arritur rendi dhe ligji.

Agjencitë ndërkombëtare si UNDP nuk janë të detyruara të raportojnë mbi përfshirjen e perspektivave gjinore dhe përfshirjes të çështjeve gjinore në strukturat e tyre. Në Kosovë, përkundër kësaj, UNDP-ja ka lëvizur drejt rritjes së bashkëpunimit me departamente qeveritare, agjenci të tjera dhe grupe të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe organizata të grave. Një shembull i freskët i qasjes së tillë të shumëfishtë, të cilin mund ta imitojnë agjencitë

ndërkombëtare është përfshirja e UNDP-së në Iniciativën për Sigurinë e Gruas, e financuar bashkërisht nga Zyra për Parandalim të Krizës dhe Rimëkëmbje dhe Këshilli Britanik. Iniciativa e përbashkët do të hetojë dhunën ndaj grave dhe trafikimin duke pasur synim trajnimin e personelit të zbatimit të ligjit, duke përfshirë gjyqtarët, si dhe do të angazhohet për strehimoret e grave.

5. Përmbledhje

Në përgjithësi, monitorimi ka konstatuar se institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile në Kosovë kanë nivele shumë të ndryshme të njohjes dhe mbështetjes për Rezolutën 1325 dhe promovim të saj. Nivelet e tyre të angazhimit në fushat e mbuluara nga Rezoluta 1325 dhe marrëveshjet përkatëse mbi të drejtat e njeriut janë po ashtu të ndryshme. Derisa në parim, UNMIK-u u përmbahet parimeve të përfshirjes gjinore në operacionet, partneritetet dhe politikat e saja – veprimtaria dhe ndikimi i saj është jokonsistent në shpërndarjen e përfshirjes të çështjes gjinore, si element kyç i ndërtimit të paqes në nivelin lokal.

Të drejtat e njeriut për gruan nuk janë risi për territorin e Kosovës dhe ato janë mbrojtur ”dyfish” nëpërmjet shkrirjes së legjislacionit të mëparshëm “vendor” së bashku me pranimin e detyrimeve dhe përgjegjësive ndaj konventave ndërkombëtare si CEDAW. Në efekt, Rezoluta 1325 paraqet një përsëritje të parimeve të të drejtave të njeriut të cilat shpeshherë sulmohen në kohë lufte apo rindërtimi paslufte. Rëndësia e veçantë e Rezolutës 1325 për Kosovën është si një deklaratë e sërishme e aspekteve kyçe të zotimeve qëndruese të të drejtave të njeriut.

Për këtë arsye, është dëshpërues fakti që Rezoluta 1325 përmendet rrallë nga administratorët ndërkombëtarë dhe për këtë arsye nuk përdoret në mënyrë të duhur nga ana e organeve zyrtare si kornizë e vazhdueshme veprimi. Në anën tjetër, shoqëria civile ka shfrytëzuar mundësitë e dhëna nga Rezoluta 1325 si mjet avokimi për të inkurajuar, për të lobuar dhe promovuar pjesëmarrjen e gruas në të gjitha nivelet e jetës publike në Kosovë dhe shtetet përreth, dhe atë me shumë suksese.

Testi i zotimit të Kosovës ndaj kornizave ligjore do të varet nga vullneti i institucioneve politike të saja për të integruar tutje përfshirjen e çështjeve gjinore përgjatë strukturave publike dhe konventave sociale dhe për të vulosur vetë përgjegjësinë mbi të drejtat e njeriut, në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar.

REKOMANDIME

Në vijim janë paraqitur një varg rekomandimesh, të cilat kanë dalë nga hulumtimi dhe intervistat, të cilat janë ndarë për tri kategori:

1. **Rekomandimet për Qeverinë:**
   - Institucionet qeveritare të promovojnë dhe zbatojnë Rezolutën 1325;
   - Qeveria të hartojë Planin e veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, dhe të sigurohet buxheti për zbatimin e këtij Plani;
   - Të nxirret Ligji kundër dhunës në familje dhe Strategjia për parandalimin e dhunës në familje;
   - Të ngritët niveli i zbatimit të ligjeve që garantojnë barazinë gjinore;
   - Të ngritët numri i grave në pozita vendimmarrëse;
   - Të zbatohet Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër trafikimit me Qenie Njerëzore (2008-2011);
   - Të bëhet integrimi i perspektivës gjinore në strukturat shtetërore të sigurisë dhe të rritet pjesëmarrja e grave në mekanizmat e sigurisë në Republikën e Kosovës;
   - Të futet në kurrikulumet e trajnimit për pjesëtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës edhe Rezoluta 1325;
   - Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, për të gjithë pjesëtaret e institucioneve të sigurisë në Kosovë, përfshirë edhe FSK-në, të organizojë trajnime për barazinë gjinore, sigurinë dhe të drejtat njerëzore të grave;
   - Policët, prokurorët, gjyqtarët dhe punëtoret social të ndjekin trajnime të vazhdueshme për rastet e dhunës në familje, çështjen e antitrafikimit, për identifikimin e viktimës nga trafikimi si dhe në përgjithësi për çështjet gjinore.

2. **Rekomandimet për praninë ndërkombëtare në Kosovë:**
   - Institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë të promovojnë dhe zbatojnë Rezolutën 1325;
   - Të gjitha mekanizmat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, veçanerishtë EULEX-i, PCN, KFOR dhe OSBE, duhet të demonstrojnë zbatimin e Rezolutës 1325 në procedurat dhe praktikat e operacioneve të tyre;
   - Institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë të bashkëpunojnë me organizatat e grave në Kosovë;
   - Institucionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, para arritjes së stafit të tyre në Kosovë të sigurojnë trajnime me karakter gjinor.

3. **Rekomandimet për shoqërinë civile:**
   - Shoqëria civile të përkrahë dhe shtytë institucionet relevante në promovimin dhe zbatimin e Rezolutës 1325;
   - Shoqëria civile të bashkëpunojë me institucionet relevante, sidomos policinë dhe gjyqësinë, në parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave në baza gjinore;
   - OJQ-të të vazhdojnë promovimin e Rezolutës 1325 në vendet ku veprojnë;
   - Shoqëria civile (OJQ-të dhe sidomos mediet) të ndihmojnë në ngritjen e vetëdijes në popullatë për dukurinë e dhunës në baza gjinore, sidomos, dhunës në familje dhe trafikimi me qenie njerëzore.

SHTOJCA 1. REZOLUTA 1244

Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij të 4011-të, më 10 qershor 1999

Këshilli i Sigurimit,[310] **Duke** pasur parasysh parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë përgjegjësinë parësore të Këshillit të Sigurimit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare,

Duke iu rikthyer rezolutave të tij **1160** (1998) të datës 31 mars 1998, **1199** (1998) të datës 23 shtator 1998, **1203** (1998) të datës 24 tetor 1998 dhe **1239** (1999) të datës 14 maj 1999.

Duke shprehur keqardhje që kërkesat e këtyre rezolutave nuk u respektuan plotësisht.

I vendosur për të zgjidhur situatën e rëndë humanitare në Kosovë, Republika Federative e Jugosllavisë, si dhe për të garantuar një kthim të sigurt e të lirë të të gjithë refugjatëve dhe personave të shpërngulur në shtëpitë e tyre,

Duke dënuar aktet e dhunës kundër popullsisë së Kosovës si dhe të gjitha aktet terroriste nga cilado palë,

Duke iu rikthyer deklaratës së bërë nga Sekretari i Përgjithshëm më 9 prill 1999, në të cilën shprehet shqetësimi për tragjedinë humanitare që po zhvillohej në Kosovë,

Duke rikonfirmuar të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe të personave të shpërngulur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre në siguri,

Duke pasur parasysh juridiksionin dhe mandatin e Gjykatës Ndërkombëtare për Ish-Jugosllavinë,

Duke përshëndetur parimet e përgjithshme për një zgjidhje politike të krizës së Kosovës të miratuara më 6 maj 1999 (S/1999/516, aneksi 1 i kësaj rezolute), duke përshëndetur edhe pranimin që Republika Federative e Jugosllavisë u bëri parimeve të parashtruara në pikat nga 1 gjer më 9 të dokumentit të paraqitur në Beograd më 2 qershor 1999 (S/1999/649, aneksi 2 i kësaj rezolute) si dhe miratimin e këtij dokumenti nga Republika Federative e Jugosllavisë,

Duke rikonfirmuar zotimin e të gjitha Shteteve anëtare për sovranitetin dhe integritetin tokësor të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe të Shteteve të tjera të rajonit, siç përcaktohet në Aktin Final të Helsinkit dhe në aneksin 2,

Duke rikonfirmuar thirrjet e rezolutave të mëparshme për një autonomi substanciale dhe për një vetadministrim llërëplotë për Kosovën,

Duke përcaktuar se situata në rajon vazhdonte të përbënte një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

I vendosur për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e personelit ndërkombëtar si dhe zbatimin e përgjegjësive të të gjithë të interesuarve në bazë të rezolutës aktuale dhe duke vepruar në emër të këtyre qëllimeve në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB,

[310] http://www.unmikonline.org/press/reports/N9917289.pdf.

1. Vendos se zgjidhja politike për krizën e Kosovës duhet të mbështetet në parimet e përgjithshme të aneksit 1 si dhe në përpunimin e mëtejshëm të parimeve dhe të elementeve të tjera të detyrueshme në aneksin 2;

2. Mirëpret pranimin, nga ana e Republikës Federative të Jugosllavisë, të parimeve dhe të elementeve të tjera të detyrueshme që përmenden në paragrafin 1 më sipër dhe kërkon bashkëpunimin e plotë të Republikës Federative të Jugosllavisë për zbatimin e menjëhershëm të tyre;

3. Kërkon në veçanti që Republika Federative e Jugosllavisë t'i japë fund menjëherë dhe në mënyrë të verifikueshme dhunës dhe represionit në Kosovë dhe të fillojë tërheqjen graduale, të plotë e të verifikueshme, të të gjitha forcave ushtarake, policore e paraushtarake nga Kosova në bazë të një grafiku të shpejtë me të cilin do të sinkronizohet dislokimi i pranisë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë;

4. Konfirmon se një numër i miratuar forcash ushtarake e policore serbe e jugosllave do të lejohet të kthehet në Kosovë pas tërheqjes për të kryer funksionet në pajtim me aneksin 2;

5. Vendos për dislokimin e një pranie ndërkombëtare civile dhe të një pranie të sigurisë në Kosovë nën kujdesin e OKB-së me pajisje të përshtatshme dhe me personel të nevojshëm si dhe mirëpret pëlqimin e Republikës Federative të Jugosllavisë për këto prani;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që në konsultime me Këshillin e Sigurimit të caktojë një përfaqësues të posaçëm për të kontrolluar zbatimin e pranisë civile ndërkombëtare si dhe po Sekretarit të Përgjithshëm i kërkon që ta udhëzojë Përfaqësuesin e tij të Posaçëm të bashkëpunojë ngushtë me praninë ndërkombëtare të sigurisë për të siguruar që të dyja pranitë të operojnë në emër të qëllimeve të njëjta dhe në një mënyrë reciprokisht mbështetëse;

7. Autorizon Shtetet Anëtare dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare që të vendosin një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, siç përcaktohet në pikën 4 të aneksit 2, me të gjitha mjetet për të përmbushur përgjegjësitë e saj në bazë të paragrafit 9 më poshtë;

8. Konfirmon nevojën për një dislokim sa më të shpejtë të pranive të efektshme civile dhe të sigurisë në Kosovë dhe kërkon që palët të bashkëveprojnë plotësisht për dislokimin e tyre;

9. Vendos se prania ndërkombëtare e sigurisë që do të dislokohet e do të veprojë në Kosovë do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

(a) Të frenojë rifillimin e armiqësive, të ruajë, dhe, atje ku është e nevojshme, të imponojë zjarrpushimin, të sigurojë tërheqjen e forcave ushtarake, policore e paraushtarake të Republikës Federative të Jugosllavisë si dhe të parandalojë rikthimin e tyre, me përjashtim siç parashikohet në pikën 6 të aneksit 2;

(b) Të demilitarizojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupet e tjera të armatosura shqiptare kosovare, siç kërkohet në paragrafin 15 më poshtë;

(c) Të krijojë një mjedis të sigurt në të cilin refugjatët dhe personat e shpërngulur të mund të kthehen në shtëpi në siguri, në të cilin prania civile ndërkombëtare të mund të operojë, administrata e përkohshme të mund të vendoset dhe ndihma humanitare të mund të shpërndahet;

(d) Të garantojë sigurinë dhe rendin publik derisa përgjegjësinë për këtë detyrë të mund të marrë prania ndërkombëtare civile;

(e) Të mbikëqyrë çminimin derisa prania ndërkombëtare civile, kur të jetë e përshtatshme, të mund të marrë përgjegjësinë për kryerjen e kësaj detyre;

(f) Të mbështetë praninë ndërkombëtare civile dhe, kur të jetë e përshtatshme, të bashkërendojë ngushtë punën e saj me të;

(g) Të kryejë detyrat e monitorimit të kufirit në përputhje me kërkesat;

(h) Të sigurojë mbrojtjen dhe lirinë e lëvizjes për veten e saj, për praninë ndërkombëtare civile dhe për organizatat e tjera ndërkombëtare;

10. Të autorizojë Sekretarin e Përgjithshëm që me ndihmën e organizatave përkatëse ndërkombëtare të vendosë një prani ndërkombëtare civile në Kosovë për të siguruar një administrim të përkohshëm për Kosovën nën të cilin populli i Kosovës të mund të gëzojë një autonomi substanciale brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, prani që do të sigurojë një administrim kalimtar ndërkohë që edhe do të themelojë institucionet e përkohshme demokratike vetëqeverisëse si dhe do të mbikëqyrë zhvillimin e tyre për të krijuar kushtet për një jetë paqësore e normale për të gjithë banorët e Kosovës;

11. Vendos që përgjegjësitë kryesore të pranisë ndërkombëtare civile të përfshijnë:

(a) Derisa të arrihet një zgjidhje përfundimtare, të nxitë themelimin e një autonomie dhe vetëqeverisjeje substanciale në Kosovë duke pasur plotësisht parasysh aneksin 2 dhe marrëveshjen e Rambujesë (S/1999/648);

(b) Të kryejë funksionet themelore administrative civile përsa kohë që kjo do të jetë e nevojshme;

(c) Të organizojë dhe të mbikëqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome derisa të arrihet një zgjidhje politike, përfshirë edhe zhvillimin e zgjedhjeve;

(d) Ndërkohë që do të themelohen këto institucione do t'u transferojë atyre përgjegjësitë e saj administrative duke mbikëqyrur e mbështetur edhe konsolidimin e institucioneve të përkohshme vendore si dhe veprimtaritë e tjera paqendërtuese të Kosovës;

(e) Të lehtësojë procesin politik të projektuar për t'i caktuar Kosovës një status të ardhshëm duke pasur parasysh Marrëveshjen e Rambujesë (S/1999/648);

(f) Në stadin përfundimtar, të mbikëqyrë kalimin e autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës, në institucionet e ndërtuara në bazë të një zgjidhjeje politike;

(g) Të mbështetë rindërtimin e infrastrukturës kyçe si dhe rindërtimet e tjera në ekonomi;

(h) Në bashkërendim me organizatat ndërkombëtare humanitare, të mbështetë ndihmën humanitare dhe ndihmën e emergjencës të rasteve të fatkeqësisë;

(i) Të ruajë rendin civil, përfshirë vendosjen e forcave policore vendore, por ndërkohë rendi do të ruhet nëpërmjet dislokimit të personelit ndërkombëtar të policisë që do të shërbejë në Kosovë;

(j) Të mbrojë dhe të lartësojë të drejtat njerëzore;

(k) Të sigurojë kthimin e sigurt dhe të papenguar në shtëpitë e tyre në Kosovë të të gjithë refugjatëve dhe të personave të shpërngulur;

12. T'i japë rëndësi nevojës së bashkërendimit të operacioneve humanitare të emergjencës, kurse Republika Federale e Jugosllavisë të lejojë hyrjen pa pengesa në Kosovë të organizatave të ndihmës humanitare dhe të bashkëpunojë me këto organizata në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e shpejtë dhe e efektshme e ndihmave ndërkombëtare;

13. T'i nxitë të gjitha Shtetet Anëtare dhe organizatat ndërkombëtare që të kontribuojnë në rindërtimin ekonomik dhe shoqëror si dhe në kthimin e sigurt të refugjatëve dhe të personave të shpërngulur si dhe thekson, në këtë kontekst, rëndësinë për mbajtjen e një konference ndërkombëtare donatorësh, veçanërisht për qëllimin e përcaktuar në paragrafin 11 (g) më sipër në një datë mundësisht sa më të hershme;

14. Kërkon bashkëpunimin e plotë të të gjithë të interesuarve, përfshirë edhe atë të pranisë ndërkombëtare të sigurisë, me Gjykatën për Ish-Jugosllavinë;

15. Kërkon që UÇK-ja dhe grupet e tjera të armatosura shqiptare kosovare t'u japin fund menjëherë të gjitha aksioneve sulmuese dhe të zbatojnë kërkesat e çmilitarizimit, të cilat përcaktohen nga kreu i pranisë ndërkombëtare të sigurisë në konsultim me Përfaqësuesin e Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm;

16. Vendos se ndalimet e imponuara nga paragrafi 6 i rezolutës 1160 (1998) nuk do të zbatohen për armët dhe materialet që lidhen me to dhe që do të përdoren nga prania ndërkombëtare civile dhe nga ajo e sigurisë;

17. Mirëpret punën që është duke u zhvilluar nga Bashkimi Evropian dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare për të ndërtuar një metodologji tërësore për zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e rajonit të prekur nga kriza e Kosovës, përfshirë zbatimin e një Pakti Stabiliteti për Evropën Juglindore me një pjesëmarrje të gjerë me qëllim që të nxitet demokracia, prosperiteti ekonomik, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal;

18. Kërkon që të gjitha Shtetet e rajonit të bashkëpunojnë plotësisht për zbatimin e të gjitha aspekteve të rezolutës;

19. Vendos që prania ndërkombëtare civile dhe ajo e sigurisë të vendosen për një periudhë fillestare prej 12 muajsh për të vazhduar edhe më tej nëse Këshilli i Sigurimit nuk vendos ndryshe;

20. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që në intervale të rregullta të raportojë përpara Këshillit rreth zbatimit të kësaj rezolute, përfshirë edhe paraqitjen e raporteve të lidereshipëve të pranisë ndërkombëtare dhe të asaj të sigurisë, ku raportet e para do të paraqiten brenda 30 ditëve pas miratimit të kësaj rezolute;

21. Vendos që të qëndrojë aktivisht i angazhuar me këtë çështje.

Aneksi I

Deklarata e Kryetarit lidhur me vizionin përfundimtar të mbledhjes së Ministrave të Jashtëm të G8-ës e mbajtur në Qendrën Petersburg më 6 Maj 1999 Ministrat e Jashtëm të G8-ës miratuan parimet e përgjithshme të mëposhtme për zgjidhjen politike të krizës së Kosovës:

- Përfundim i menjëhershëm dhe i verifikueshëm i dhunës dhe i represionit në Kosovë;
- Tërheqje e forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake nga Kosova;
- Dislokim i një pranie të efektshme ndërkombëtare civile dhe i një pranie të sigurisë në Kosovë, të miratuara dhe të aprovuara nga Kombet e Bashkuara, të afta për të garantuar arritjen e objektivave të përbashkët;
- Vendosje e një administrimi të përkohshëm për Kosovën që do të përcaktohet nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës;
- Kthim i sigurt i të gjithë refugjatëve dhe të personave të shpërngulur dhe hyrje pa pengesa në Kosovë e organizatave të ndihmës humanitare;
- Një proces politik drejt arritjes së një marrëveshjeje për një kuadër politik të përkohshëm që do të sigurojë një vetëqeverisje substanciale për Kosovën duke marrë plotësisht parasysh marrëveshjen e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të integritetit tokësor qoftë të Republikës Federale të Jugosllavisë, qoftë të vendeve të tjera të rajonit, si dhe çmilitarizimin e UÇK-së;
- Një metodologji e gjithanshme për zhvillimin ekonomik dhe stabilizimin e krizës në rajon.

Aneksi 2

Marrëveshja që do të çonte drejt zgjidhjes së krizës së Kosovës duhet të arrihet mbi bazën e parimeve të mëposhtme:

1. Ndalim i menjëhershëm dhe i verifikueshëm i dhunës dhe i represionit në Kosovë,

2. Tërheqje e verifikueshme e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake nga Kosova në bazë të një grafiku të shpejtë,

3. Dislokim në Kosovë i një pranie të efektshme ndërkombëtare civile si dhe i një pranie të efektshme të sigurisë nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara që do të veprojnë mbi bazën e Kapitullit VII të Kartës, të afta për të garantuar arritjen e objektivave të përbashkët.

4. Prania ndërkombëtare e sigurisë me pjesëmarrjen substanciale të Organizatës së Paktit të Atlantikut të Veriut duhet të dislokohet mbi bazën e një komande dhe kontrolli të unifikuar, e autorizuar për të krijuar një mjedis të sigurt për të gjithë popullin e Kosovës si dhe për të lehtësuar kthimin e sigurt të të gjithë refugjatëve dhe të personave të shpërngulur në shtëpitë e tyre.

5. Vendosja e një administrimi të përkohshëm për Kosovën si pjesë e pranisë ndërkombëtare civile në bazë të të cilit populli i Kosovës të mund të gëzojë një autonomi substanciale brenda Republikës Federative të Jugosllavisë, autonomi që do të vendoset nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Gjatë kohës që do të vendoset dhe do të mbikëqyret krijimi i institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse, administrimi i përkohshëm do të sigurojë një

administrim kalimtar për të siguruar kushtet për një jetë normale dhe paqësore për të gjithë banorët e Kosovës.

6. Pas tërheqjes, një numër i miratuar forcash jugosllave dhe serbe do të lejohet të kthehet në Kosovë për të kryer funksionet e mëposhtme:

- Ndërlidhje me misionin ndërkombëtar civil dhe me praninë ndërkombëtare të sigurisë;
- Përcaktim/pastrim i zonave të minuara;
- Mbajtje e një pranie në qendrat trashëgimore serbe;
- Mbajtje e një pranie në kalimet kyçe në kufi.

7. Kthim i sigurt dhe i lirë i të gjithë refugjatëve dhe i personave të shpërngulur nën mbikëqyrjen e Zyrës së Komisariatit të Lartë të OKB për Refugjatët dhe hyrje e papenguar në Kosovë e organizatave të ndihmave humanitare.

8. Një proces politik drejt arritjes së një marrëveshjeje për një kuadër të përkohshëm politik që do të sigurojë vetëqeverisjen substanciale për Kosovën duke pasur parasysh plotësisht marrëveshjen e Rambujesë dhe parimet e sovranitetit dhe të integritetit tokësor qoftë të Republikës Federale të Jugosllavisë, qoftë atë të vendeve të tjera në rajon, si dhe çmilitarizimin e UÇK-së. Negociatat midis palëve për gjetjen e një zgjidhjeje nuk duhet të vonojnë ose të prishin vendosjen e institucioneve demokratike vetëqeverisëse.

9. Një metodologji e gjithanshme për zhvillimin ekonomik dhe për stabilizimin e rajonit pas krizës. Kjo do të përfshijë zbatimin e një pakti stabiliteti për Evropën Juglindore me një pjesëmarrje ndërkombëtare të gjerë me qëllim që të nxitet demokracia, prosperiteti ekonomik, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal.

10. Pezullimi i veprimtarive ushtarake do të kërkojë pranimin e parimeve të parashtruara më sipër plus pranimin e elementeve të tjera të domosdoshme të përcaktuara më parë, të cilat specifikohen në shënimin e mëposhtëm. Pas këtij pranimi duhet të arrihet menjëherë një marrëveshje ushtarako-teknike e cila, ndërmjet të tjerash, do të specifikojë modalitetet shtesë, përfshirë rolin dhe funksionet e personelit jugosllav/serb në Kosovë:

Tërheqja
- Procedurat për tërheqjen përfshijnë një grafik të detajuar për një tërheqje graduale si dhe përcaktimin e një zone tampon në Serbi, matanë së cilës duhet të tërhiqen forcat serbe.

Rikthimi i personelit
- Pajisjet që bashkëshoqërojnë personelet që do të rikthehen;
- Referenca e kushteve për përgjegjësitë e tyre funksionale;
- Grafiku kohor i rikthimit të tyre;
- Konturimi i zonave gjeografike për operacionet e tyre;
- Rregullat që qeverisin raportet e tyre me praninë ndërkombëtare të sigurisë dhe me misionin ndërkombëtar civil.

Elemente të tjera të nevojshme
- Një grafik i precizuar për tërheqje të shpejta, gjë që do të thotë, p.sh., shtatë ditë për një tërheqje totale, kurse armët kundërajrore duhet të tërhiqen deri në 25 kilometra jashtë një zone sigurie të ndërsjellët brenda 48 orëve;

- Rikthimi i personeleve për të katër funksionet e specifikuara më sipër do të bëhet nën mbikëqyrjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe do të jetë i kufizuar në një numër të vogël të miratuar (me qindra, jo mijëra);
- Pezullimi i veprimtarisë ushtarake do të kryhet pas fillimit të tërheqjeve të verifikueshme;
- Diskutimi dhe arritja e një marrëveshjeje ushtarako-teknike nuk duhet të zgjatet përtej kohës së caktuar për përfundimin e tërheqjeve.

SHTOJCA 2. UNSCR1325

Rezoluta 1325 (2000)[311]
E miratuar nga Këshilli i Sigurimit
në takimin e tij të 4213-të, më 31 tetor 2000

Këshilli i Sigurimit,
Duke rikujtuar rezolutat e tij: 1261 (1999) e 25 gushtit 1999, 1265 (1999) e 17 shtatorit 1999, 1296 (2000) e 19 prillit 2000 dhe 1314 (2000) e 11 gushtit 2000, si dhe deklaratat përkatëse të Presidentit të tij; duke rikujtuar gjithashtu deklaratën për shtyp të Presidentit me rastin e Ditës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Grave dhe të Paqes Ndërkombëtare (Dita Ndërkombëtare e Grave) më 8 Mars 2000 (SC/6816),

Duke rikujtuar gjithashtu zotimet e deklaratës së Pekinit dhe të Platformës për Veprim (A/52/231), si edhe zotimet e përfshira në dokumentin përfundimtar të Sesionit të Veçantë të njëzet e tretë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të titulluar "Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja për Shekullin e Njëzetë e Një" (A/S-23/10/Rev.1), në veçanti ato që kanë të bëjnë me gratë dhe konfliktin e armatosur,

Duke marrë në konsideratë qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe përgjegjësinë kryesore të Këshillit të Sigurimit, sipas Kartës, për mbështetjen e paqes ndërkombëtare dhe të sigurisë,

Duke shprehur shqetësimin se civilët, veçanërisht gratë dhe fëmijët, konsiderohen si shumica dërrmuese e të prekurve nga konflikti i armatosur, përfshirë këtu si refugjatët ashtu edhe të shpërngulurit brenda vendit, dhe faktin që gjithnjë e më tepër ata janë nën shënjestrën e luftëtarëve dhe të elementëve të armatosur, si dhe duke marrë parasysh pasojën e këtij ndikimi për një paqe të qëndrueshme dhe për pajtim,

Duke ripohuar rolin e rëndësishëm të grave në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, si dhe duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre të barabartë dhe përfshirjen e plotë në të gjitha përpjekjet për ruajtjen dhe çuarjen përpara të paqes dhe të sigurisë, si dhe nevojën për të rritur rolin e tyre në proceset vendimmarrëse, lidhur me parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve,

Duke ripohuar gjithashtu nevojën për të zbatuar plotësisht ligjet ndërkombëtare humanitare dhe ato të të drejtave të njeriut, të cilat mbrojnë të drejtat e grave dhe të vajzave gjatë dhe pas konflikteve,

Duke theksuar nevojën që të gjitha palët të bëjnë të mundur që programet për pastrimin nga minat dhe ato për ndërgjegjësimin për praninë e minave, të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave,

Duke pasur parasysh nevojën urgjente për të futur perspektivën gjinore në veprimet paqeruajtëse, dhe duke vëne theksin lidhur me këtë në Deklaratën Windhoek dhe në Planin e Namibisë për Veprim në Futjen e Perspektivës Gjinore në Veprimet Shumëpërmasëshe për Mbështetjen e Paqes (S/2000/693),

[311] http://www.peacewomen.org/un/sc/1325.html#Full

Duke njohur gjithashtu rëndësinë e këshillës së dhënë për shtyp nga Presidenti i tij më 8 mars 2000 për trajnimin e specializuar të të gjithë personelit paqeruajtës për mbrojtjen, nevojat e veçanta dhe të drejtat e grave dhe të fëmijëve në situatat e konfliktit,

Duke ditur se po të kuptohet ndikimi që konflikti i armatosur ka tek gratë dhe vajzat, atëherë kjo do të nxisë marrëveshjet institucionale që të sigurojnë mbrojtjen e grave dhe të vajzave si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në procesin e paqes, të cilat nga ana e tyre mund të kontribuojnë dukshëm në ruajtjen e paqes ndërkombëtare dhe të sigurimit,

Duke vënë re nevojën për të konsoliduar të dhënat për ndikimin e konfliktit të armatosur tek gratë dhe vajzat:

1. Nxit Shtetet Anëtare, që të sigurojnë një përfaqësim më të madh të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe në mekanizmat për parandalimin, drejtimin dhe zgjidhjen e konfliktit;

2. Inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm që të zbatojë planin e tij strategjik të veprimit (A/49/587), duke kërkuar një rritje të pjesëmarrjes së grave në nivelet vendimmarrëse për zgjidhjen e konfliktit dhe proceset e paqes;

3. Nxit Sekretarin e Përgjithshëm që të caktojë më shumë gra si përfaqësuese të posaçme dhe të kërkojë që të kryejnë punë të mira në emrin e tij, dhe lidhur me këtë u bën thirrje Shteteve Anëtare që të sigurojë kandidatë për Sekretarin e Përgjithshëm, për përfshirje në një listë qendrore, e cila ripërtërihet rregullisht;

4. Nxit më tej Sekretarin e përgjithshëm, që të përpiqet që të zgjerojë rolin dhe kontributin e grave në veprimet e kryera në bazë dhe në mënyrë të veçantë mes vëzhguesve ushtarakë, policëve civilë personelit të të drejtave të njeriut dhe atyre humanitare;

5. Shpreh gatishmërinë e tij për të përfshirë perspektivën gjinore në veprimet paqeruajtëse dhe nxit Sekretarin e përgjithshëm që të sigurojë, që atje ku është e mundur, veprimet në bazë të përfshijnë edhe një element gjinor;

6. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm që t'u sigurojë Shteteve Anëtare udhëzues trajnimi dhe materiale për mbrojtjen, të drejtat dhe nevojat e veçanta të grave, si edhe për rëndësinë e përfshirjes së grave në të gjitha masat paqeruajtëse dhe paqendërtuese, fton Shtetet Anëtare që të përfshijnë të gjithë këto elemente si dhe trajnime për ndërgjegjësimin për HIV/AIDS, në programet e tyre kombëtare të trajnimit për personelin policor civil dhe ushtarak, në përgatitje për t'u punësuar. Dhe i kërkon më tej Sekretarit të Përgjithshëm që të sigurojë që edhe personeli civil i veprimeve paqeruajtëse të marrë një trajnim të ngjashëm;

7. Nxit Shtetet Anëtare që të rrisin mbështetjen e tyre financiare vullnetare, teknike dhe logjistike për trajnime me karakter gjinor, përfshirë edhe ato të ndërmarra nga fondet dhe programet përkatëse, inter alia, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët, dhe nga Zyra e Komisionarit të Lartë për refugjatët dhe nga organizma të tjerë përkatës;

8. U bën thirrje të gjithë organizmave të përfshirë, që kur zhvillojnë bisedime dhe zbatojnë marrëveshjet për paqen, të miratojnë një perspektivë gjinore, duke përfshirë, inter alia:

(a) Nevojat e veçanta të grave dhe vajzave gjatë riatdhesimit dhe për riaftësimin, riintegrimin dhe rindërtimin pas konfliktit;

(b) masa që mbështesin nismat lokale të grave për paqen dhe proceset vendase për zgjidhjen e konfliktit, dhe që përfshin gratë në të gjitha mekanizmat zbatues të marrëveshjeve për paqen;

(c) Masa që sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të vajzave dhe grave, veçanërisht me ato që lidhen me kushtetutën, sistemin zgjedhor, policinë dhe gjykatësit;

9. U bën thirrje të gjitha palëve në konfliktin e armatosur që të respektojnë plotësisht ligjin ndërkombëtar, të zbatueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e grave dhe të vajzave, duke i trajtuar ato veçanërisht si civilë, si dhe detyrimet e zbatueshme për ta, nën Konventën e Gjenevës të vitit 1949 dhe të Protokolleve Shtesë të vitit 1977, Konventa e Refugjatit e vitit 1951dhe për më tepër Protokollin e vitit 1967, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit kundër Grave, të vitit 1979 si dhe Protokollin fakultativ të vitit 1999 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989 dhe dy Protokole Fakultative të 25 majit 200 dhe të mbajë në mendje kushtet përkatëse të statutit të Romës të Gjykatës Ndërkombëtar të Krimeve;

10. Iu bën thirrje të gjitha palëve të përfshira në konfliktin e armatosur që të marrin masa të veçanta për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, veçanërisht nga përdhunimi dhe format e tjera të abuzimit seksual, dhe të gjitha llojeve të tjera të dhunës në situatën e një konflikti të armatosur;

11. Thekson përgjegjësinë e të gjitha Shteteve që t'u japin fund pandëshkueshmërisë dhe të ndëshkojnë ata që janë përgjegjës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës, përfshirë këtu edhe ato që janë të lidhura me dhunën seksuale dhe dhunë të llojeve të tjera mbi gratë dhe vajzat dhe lidhur me këtë vë theksin në nevojën për të përjashtuar këto krime, atje ku është e mundur nga kushtet për amnisti;

12. Iu bën thirrje të gjitha palëve të konfliktit të armatosur që të respektojnë civilët si dhe kampet dhe ngulimet e refugjatëve me karakter humanitar dhe të marrin parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave, të përfshira në synimet e tyre, dhe rikujton rezolutat e tij 1208 (1998) të 19 Nëntorit 1998 dhe 1296 (2000) të 19 prillit 2000;

13. Inkurajon të gjitha ata që përfshihen në planin për çarmatim, çmobilizim dhe riintegrim që të konsiderojë nevojat e ndryshme të ish-luftëtarëve meshkuj dhe femra dhe të marrë në konsideratë nevojat e familjarëve të tyre;

14. Ripohon gatishmërinë e tij, kur masat janë marrë nën Artikullin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që të japë vlerësimin e tyre për ndikimin e tyre të mundshme mbi popullsinë civile, duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të grave dhe vajzave, në mënyrë që të kihen parasysh përjashtime humanitare atje ku duhet,

15. Shpreh gatishmërinë e tij, për të siguruar që misionet e Këshillit të Sigurimit të marrin parasysh vlerësimet gjinore dhe të drejtat e grave, të marra prej konsultimeve me grupet lokale dhe ndërkombëtare të grave;

16. Fton Sekretarin e Përgjithshëm që të përfundojë një studim mbi ndikimin e konfliktit të armatosur mbi gratë dhe vajzat, rolin e grave në ndërtimin e paqes dhe përmasat gjinore të

proceseve të paqes dhe të zgjidhjes së konfliktit, dhe fton më tej atë që t'i paraqesë një raport Këshillit të Sigurimit mbi rezultatet e këtij studimi dhe ta vërë atë në dispozicion të të gjitha Shteteve Anëtare dhe të Kombeve të Bashkuara;

17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, atje ku është e përshtatshme, që të përfshijë në raportin e tij për Këshillin e Sigurimit, përparimin në drejtimet bazë gjinore në të gjitha misionet paqeruajtëse dhe në të gjitha aspektet e tjera që kanë të bëjnë me gratë dhe vajzat.

18. Vendos që të vazhdojë të merret aktivisht me këtë çështje.

SHTOJCA 3. INICIATIVAT DREJT ZBATIMIT TË REZOLUTËS 1325 NË KOSOVË (2001-2007)

1. Në qershor të vitit 2001, një delegacion i Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara erdhi në Kosovë. Përfaqësuesit e UNMIK-ut të cilët përgatitnin agjendën e delegacionit thanë se delegacioni nuk ka kohë për tu takuar me gratë Kosovare. Aktivistet theksuan se RKSOKB 1325 u jep atyre të drejtën e takimit me delegacionin. Ambasadori Anwarul K. Chowdhury, i cili po e udhëhiqte këtë delegacion u pajtua që të takohet me gratë në ora 21.30 pasi që të kenë përfunduar të gjitha takimet tjera të delegacionit. [312]

2. Në dhjetor të vitit 2002, një delegacion i Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara vizitoi Kosovën. Pasi që UNMIK-u nuk informoi dhe ftoi gratë lokale në këtë takim, gratë Kosovare avokuan dhe arritën të sigurojnë një takim pas orarit të rregullt të punës. Aktivistet filluan takimin duke diskutuar çështjet që lidhen me statusin final politik të Kosovës. Ambasadori i OKB-së ndërhyri, "Statusi është një çështje për partitë politike. Le të flasim për çështje të grave. Për shembull, le të flasim për Rezolutën 1325." Gratë Kosovare mbetën të befasuara nga mungesa evidente e dijes së ambasadorit lidhur me RKSOKB 1325, pasi që sipas saj gratë duhet të jenë të përfshira në procesin e negocimit të statusit final politik të Kosovës. Ato pyetën, "A nuk mendoni se statusi është një çështje e cila ndikon tek gratë? Kjo është një çështje e deklaruar drejtpërdrejt në Rezolutën 1325." [313]

3. Në nëntor të vitit 2003, aktivistet nga Kosova të nxitura dhe përkrahura nga UNIFEM-i, iu bashkuan iniciativës rajonale për avokim për zbatimin e Rezolutës.

4. Në shkurt të vitit 2004, u krijua Grupi Punues Rajonal që përbëhej nga dy përfaqësues të të gjitha shteteve. Si rezultat, ekipi i UNIFEM-it nga Kosova inicioi veprime avokuese që kishin për qëllim ngritjen e vetëdijes publike lidhur me Rezolutën 1325 në tërë rajonin përmes grupeve të grave nga Kosova, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi dhe Shqipëria.

5. Në tetor të vitit 2004 aktivistet nga rajoni u takuan në Sarajevë për të mbajtur një punëtori e cila pati për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe ofrimin e informatave mbi Rezolutën 1324 për aktivistet e regjionit. Kjo punëtori u mbajt falë përkrahjes së UNIFEM-it, Kvinna till Kvinna dhe Zene Zenama që i kushtohej diskutimit dhe analizës së Rezolutës nga ana e femrave në OJQ dhe qeveri. Në fokus ishte analiza historike dhe teknike e Rezolutës; shembuj nga iniciativat globale për të promovuar dhe monitoruar zbatimin e saj; shembuj të çështjeve kombëtare dhe regjionale që kanë të bëjnë me Rezolutën; dhe mënyrat që mund të përdorur për të punuar rreth tyre. Feministë dhe aktiviste nga të drejtat e njeriut dhe grave dhe paqes nga Suedia, SHBA, Republika Ceke, Kosova, Kroacia, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina morën pjesë në këtë konferencë.

6. Pas punëtorisë së Sarajevës, OJQ-të vazhduan të avokojnë për zbatimin dhe ngritjen e vetëdijes lidhur me Rezolutën 1325 nëpër rrjetet e tyre. U arrit marrëveshja për të mbajtur një Punëtori tjetër.

[312] Building Peace Empowering Women: Gender Strategies to make UN Security Council Resolution 1325 work, Vienna 2006, p. 28.
[313] Ibid.

7. Në prill të vitit 2005, në Maqedoni u mbajt një punëtori, e sponsoruar nga UNIFEM-i. Punëtoria duhej të ishte për nga natyra praktike dhe jo teorike, dhe të ofronte mundësi për të zhvilluar Planin preliminar të Veprimit për implementim. Pjesëmarrëset nga Maqedonia që kishin qenë aktive në zhvillimin e rrjeteve të tyre që nga tetori i vitit 2004 gjithashtu ishin ftuar të marrin pjesë si vëzhgues.

8. Gjatë takimit me të Deleguarin Special të OKB-së, Ambasadorin Kai Aide në vitin 2005, aktivistet filluan takimin duke diskutuar mbi çështjen e përfshirjes së grave në bisedimet të cilat do të përcaktojnë statusin final të Kosovës. Ambasadori Kai Eide u përgjigj me shaka duke thënë "Mos flisni me mua si burra." Aktivistet lokale mbetën të tronditura dhe u përgjigjën duke theksuar se RKSOKB 1325 u siguron atyre të drejtën e të biseduarit mbi statusin final politik të Kosovës.[314]

9. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), UNIFEM-i, KFOR-i, Policia e UNMIK-ut dhe Rrjeti i Grupeve të Grave i Kosovës iniciuan një bashkëpunim drejt avancimit të zbatimit të Rezolutës 1325. Më specifikisht UNIFEM-i dhe RRGGK përkrahën njësitë e porsaformuara për çështje gjinore në SHPK dhe TMK me trajnime, këmbim të informatave dhe aktivitete bashkëpunuese me qëllim të adresimit të rolit të grave në vendimmarrje, trafikim dhe dhunë në familje. Në përgjithësi, iniciativa kishte për qëllim të rrisë nivelin e komunikimit mes femrave dhe policisë dhe sektorit të sigurisë.

10. Organizata joqeveritare suedeze Kvinna till Kvinna (KtK) ka përkrahur krijimin e rrjetit dhe aktivitetet e grupeve të grave të Kosovës drejt avancimit të zbatimit të RKSOKB 1325. KtK gjithashtu ka avokuar për përfshirjen e grave në bisedimet për statusin final të Kosovës, duke përpiluar dy letra dhe duke i dërguar ato tek vendimmarrës së nivelit të lartë. E para, e datuar më 8 korrik 2005, i është adresuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përhershëm (PSSP) në Kosovë, z. Soren Jessen-Petersen. Letra e dytë, e datuar më 16 janar 2006 i është adresuar të Deleguarit Special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Kofi Annan, PSSP-së Soren Jessen-Petersen, dhe Ministres të Punëve të Jashtme të Suedisë, znj. Laila Freivalds.

11. Në vitin 2005 RTV 21 ka përgatitur dokumentarin mbi Rezolutën 1325 i cili është promovuar dhe shfaqur në të gjitha mediet e rajonit. RTV 21 poashtu ka punuar dokumentar tjetër lidhur me Rezolutën 1325 ne bashkëpunim me ARTE TV.

12. Në shkurt të vitit 2006, pasi që kishte lexuar mbi iniciativat e aktivisteve lokale drejt përfshirjes së grave në bisedimet për statusin final të Kosovës në buletinin informativ të RRGGK, të quajtur Zëri i Grave të Kosovës, Shevolution (nga Mbretëria e Bashkuar) filloi bashkëpunimin me RRGGK, duke avokuar në Parlamentin Evropian për përfshirjen e grave në ekipin negociator për bisedimet për statusin final, që ka të bëjë me të ardhmen e Kosovës. Advocacy Project (SHBA) gjithashtu mësoi lidhur me iniciativat lokale të fokusuara në zbatimin e RKSOKB 1325 përmes buletinit informativ të RRGGK, dhe pasi që intervistuan disa përfaqësues të RRGGK-së, ata botuan një tregim në buletinin e tyre informativ mbi tentativat e Kosovarëve për sigurimin e përfaqësimit të grave në bisedimet mbi statusin final.

[314] Po aty.

13. Në shkurt 2006, Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) organizoi një tryezë të rrumbullakët mbi "Rolin e medieve dhe shoqërisë civile në avancimin e pozitës së gruas", në të cilën morën pjesë përfaqësues të Kuvendit, OJQ-ve, ministrive dhe medieve. Në tryezën e rrumbullakët gjithashtu u ngritën çështjet e RKSOKB 1325 dhe grave në pozita vendimmarrëse. Më se dhjetë media Kosovare e përcollën këtë ngjarje.

14. Më 3 mars 2006, Gratë Kosovare u takuan me Përfaqësuesin Special të OKB-së për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari dhe theksuan nevojën e përfshirjes së grave në bisedimet mbi negociatat rreth statusit final të Kosovës. Gratë Kosovare avokuan që ky takim të mbahet gjatë takimit me zyrtarët e lartë të Departamentit të Misioneve Paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (DPKO) në New York.

15. Më 5 mars 2006, RRGGK nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Gratë në të Zeza – Serbi, në mënyrë që të monitorojnë procesin negociator lidhur me statusin final të Kosovës, për të siguruar se zërat e grave merren parasysh gjatë negociatave. Iniciativa e tyre e përbashkët është publikuar në mediet Serbe dhe Kosovare.

16. Në javën që i parapriu 8 marsit 2006, përfaqësues të RRGGK dhe Lobit të Grave Kosovare (LGK) u paraqitën në më se pesëmbëdhjetë media elektronike dhe të shtypura (p.sh. emisione televizive, artikuj lajmesh) me audiencë që përfshinë tërë Kosovën, me ç"rast ngritën vetëdijen e qytetarëve lidhur me RKSOKB 1325 dhe rëndësinë që ajo ka për përfshirjen e një numri më të madh të grave në vendim-marrje, posaçërisht gjatë negociatave lidhur me statusin final politik të Kosovës

17. Më 8 mars 2006, RRGGK dhe LGK organizuan një demonstratë para teatrit kombëtar në Prishtinë. Këngëtarë dhe aktorë të njohur Kosovarë u paraqitën me këngë dhe skeçe të shkruara enkas për këtë ngjarje, të cilat fokusoheshin në RKSOKB 1325 dhe në rëndësinë e përfshirjes së grave në bisedime të cilat merren me statusin përfundimtar të Kosovës. Pjesëmarrësve iu shpërndanë dyqind ekzemplarë të materialeve të shtypura lidhur me RKSOKB 1325. Tri stacionet kombëtare televizive që transmetojnë në tërë Kosovën transmetuan reportazhe mbi këtë demonstratë në lajmet e tyre të mbrëmjes. Pas kësaj ngjarje, pjesëmarrësit varën një pamflet i cili shkruante "Rezoluta 1325 na garanton të drejtën e pjesëmarrjes në bisedimet për statusin final", jashtë ndërtesës së parlamentit, në qendër të Prishtinës, ku vazhdon të qëndrojë në mënyrë që të shihet nga të gjithë qytetarët dhe politikanët.

18. Më 8 mars 2006, RTV 21 emitoi një program 10-minutash gjatë lajmeve kryesore, i cili dokumentonte demonstratat dhe ngjarjet e organizuara nga gratë anë e mbanë botës më 8 mars, përmes të cilave tentohej të arrihet një përfshirje më e madhe e grave në vendimmarrje. RTV21 gjithashtu emitoi një program special 30- minutash lidhur me demonstratën e RRGGK dhe LGK, duke theksuar se RKSOKB 1325 u garanton grave pjesëmarrjen në bisedimet mbi statusin final.

19. Më 8 mars 2006, aktivistet Kosovare dhe organizatat lokale dërguan letra të tek vendimmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë, përmes të cilave kërkohej përfshirja e grave në ekipin që negocion për statusin final të Kosovës, siç parashihet me RKSOKB 1325. Letra i janë dërguar: të Deleguarit Special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, PSSP Soren Jessen-Petersen, Presidentit Fatmir Sejdiu, Kryeministrit Agim Çeku, Komandantit të KFOR-it Giuseppe Valotto, ekipit negociator, si dhe kontakt grupit të pesë zyrave të huaja në Kosovë. Kjo letër gjithashtu është lexuar gjatë mbajtjes së demonstratës së sipërpërmendur.

20. Më 10 mars 2006, Qendra Burimore dhe Trajnuese për Avokim (ATRC) bashkëpunoi me Qendrën për Trajnime dhe Studime Gjinore për të organizuar një diskutim publik, gjatë të cilit përfaqësuesit e shoqërisë civile debatuan lidhur me çështjen e pjesëmarrjes së grave në negociatat për statusin final të Kosovës.

21. Më 22 mars 2006, ATRC ka organizuar një debat tjetër lidhur me temën e sfidave dhe opozitës gjatë bisedimeve mbi statusin final. Pothuajse gjysma e takimit u fokusua në përfshirjen e grave në bisedimet për statusin pasi që kjo çështje ngrihej pandërprerë nga aktivistet e pranishme aty. Përfundimisht, avokimi i aktivisteve Kosovare u tregua i suksesshëm pasi që folësi kryesor – Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), z. Hashim Thaçi, njëkohësisht edhe anëtar i grupit negociator, premtoi publikisht që një grua do të marrë pjesë në ekipin negociator. Kjo ngjarje gjithashtu u përcoll nga mediet.

22. Në qershor të vitit 2007, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) organizoi një tryezë të rrumbullakët në të cilën ishin ftuar aktiviste kosovare dhe pikat kontaktuese të OKB-së, përfshirë përfaqësuesit e UNIFEM-it.Në qershor dhe korrik të vitit 2007, RRGGK mbajti takime me trupat e KFOR-it, duke ua prezantuar atyre Rezolutën 1325.

23. Në vitin 2007, RTV 21 ka përgatitur dhe shfaqur një dokumentar lidhur me Paqen dhe Sigurinë.

24. Në vitin 2007, RTV 21 ka përgatitur filmin dokumentar mbi Koalicionin e Grave për paqe "Gratë për Paqe" i cili është shfaqe ne RTV21, OKB dhe ne shume konferenca ndërkombëtare dhe rajonale.

SHTOJCA 3. PROJEKTPLANI I PUNËS PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE PËR REZOLUTËN 1325

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
shkurt 2008, Prishtinë, Kosovë

Hyrje

Ky plan i punës është hartuar në konsultim me ekspertë të çështjeve gjinore nga sektorë të ndryshëm në Kosovë, gjatë tri punëtorive në dhjetor të vitit 2007 dhe gjatë një punëtorie tjetër përcjellëse në shkurt të vitit 2008. Hapat specifik që janë identifikuar në plan të punës bazohen në rekomandimet e bëra në raportin e RRGGK-së për zbatimin e Rezolutës 1325. RRGGK shpreson që institucionet dhe organizatat gjegjëse do ta shfrytëzojnë këtë dokument si udhëzues në përpjekjet e tyre të mëtejme drejt implementimit të Rezolutës 1325 në Kosovë.

Hapat e mëtejmë

Plani i punës identifikon rezultatet dhe outputet afatgjata që cilat kontribuojnë në arritjen e këtyre rezultateve gjatë tri viteve vijuese (2008-2010). Aktivitetet që mund të kontribuojnë në arritjen e këtyre outputeve gjithashtu janë sugjeruar në këtë dokument. Ekipi i lartpërmendur i ekspertëve ka identifikuar institucionet që do të duhej, sipas mandatit të tyre apo për shkak të përvojës që posedojnë, të marrin udhëheqjen në zbatimin e aktiviteteve gjegjëse. Grupi gjithashtu ka identifikuar *disa* organizata dhe institucione të cilat do të mund të ndihmonin në zbatim.

Plani i propozuar i punës: 2008-2010

Rezultati I. Implementimi i mekanizmave ekzistues për çështje gjinore në ligj dhe në politika të të gjitha niveleve

Outputi	Aktivitetet	Përgjegjës	Ndihmuar nga	Data e fillimit	Data e përfundimit	Resurset
1. *Ngritja* e nivelit të implementimit të mekanizmave ekzistues të barazisë	1.1 Trajnimi profesional për ABGJ, për të shtjelluar çdo vendim, politik apo akt nga perspektiva gjinore, obligim ky që ABGJ-së i përcaktohet me ligj. *Tregues:* Kapaciteti i ngritur i ABGJ-së për të shtjelluar *më shumë* vendime, politika dhe akte, për tu siguruar se ato përmbajnë një perspektivë gjinore.	Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe institucionet tjera relevante	OJQ të grave, ekspertë të legjislacionit gjinor ndihmojnë në vlerësimin e të gjitha ligjeve nga perspektiva gjinore			

gjinore.	1.2 Përcaktimi i procedurave të qarta operative / përgjegjësive për ABGJ dhe ZQM sa i përket shtjellimit të gjitha vendimeve, politikave apo akteve nga perspektiva gjinore. *Tregues:* Udhëzime të qarta që përcaktojnë mënyrën e bashkëpunimit të këtyre dy organeve. 1.3 Avokimi tek ABGJ për themelimin e një grupi vendimmarrës brenda ABGJ për të orientuar strategjitë e ABGJ dhe për të identifikuar zbrazëtirat në funksionimin e ABGJ përkitazi me ligjin. *Tregues:* 1.4 Monitorimi i implementimit të mekanizmave ekzistues të barazisë gjinore (OJQ-ve të grave) *Tregues:*					
	1.5 Krijimi i një baze të të dhënave dhe shfrytëzimi i saj për monitorimin e të gjitha vendimeve, politikave apo akteve nga perspektiva gjinore dhe për të rekomanduar veprimet përkatëse për implementim *Tregues:* Më shumë vendime, politika dhe akte përmbajnë një perspektivë gjinore.	OJQ të grave, KMDLNJ Ombudsperson i Institucionet e Kosovës	Ekspertë të legjislacionit gjinor			
	1.6 Hartimi i një raporti hulumtues të orientuar nga avokimi që vlerëson dhe monitoron mungesën e vullnetit politik për të implementuar legjislacionin dhe politikat ekzistuese mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore politikisht, materialisht dhe në	OJQ; grupi i formuar ad-hoc (ekspertë, OJQ-të që do të monitorojnë				UNDP

	aspektin social, i cili si konkluzion do të ofronte rekomandime specifike (në kombinim me bazën e të dhënave – raporti do të hartohej bazuar në bazën e të dhënave). *Tregues:* Ekzistenca e raportit, ngritja e nivelit të të kuptuarit të mungesës së vullnetit politik për të implementuar.	dhe formulojnë rekomandimet)				
	1.7 Fushata avokimi për të implementuar dispozitat e Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore (përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar me së paku 40%) në të gjitha nivelet e IPVQ-ve, dhe rregullimi i kësaj çështje me ligj. *Tregues*: Implementimi më i mirë i Ligjit për Barazi Gjinore.	OJQ, partitë politike, institucionet qeveritare, QKSGJ				
	1.8 Zhvillimi dhe implementimi i një programi të ri trajnimi me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe të kuptuarit të dispozitave të Rezolutës 1325 mes administratorëve civil dhe politik, përfshirë edhe mënyrat se si ata më mirë mund të implementojnë Rezolutën1325. *Tregues:* Administratorët politik dhe civil janë më të vetëdijshëm lidhur me mënyrën në të cilën ata mund ta implementojnë Rezolutën 1325.	ABGJ, ZQM, OJQ të grave, IKAP??				
	1.9 Fushatë në media për të ngritur vetëdijen dhe të kuptuarit e dispozitave të Rezolutës 1325 mes administratorëve politik dhe civil *Tregues*: administratorët dhe qytetarët janë më të vetëdijshëm mbi dispozitat e Rezolutës 1325 dhe mënyrës në të cilat ata mund t'i implementojnë më tej ato.	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës				

	1.10 Krijimi i mekanizmit që siguron konsultime të rregullta mes organeve kryesore ndërkombëtare, përfshirë BE dhe OKB dhe grupet e shoqërisë civile, lidhur me çështje që paraqesin brenga të përbashkëta, siç përcaktohet me Rezolutën 1325. *Tregues:* Ngritja e mekanizmit dhe nivelit të komunikimit mes organeve ndërkombëtare, përfshirë BE dhe OKB dhe grupeve të shoqërisë civile në të gjitha çështjet që paraqesin brengë të përbashkët.	OJQ, OKB, BE	Ambasadat			
	1.11 Avokim tek ministritë dhe institucionet që brenda fushës së përgjegjësive të tyre të ndajnë fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për 1) implementimin e dispozitave të Rezolutës 1325 dhe instrumenteve relevante për të drejtat njerëzore të grave, dhe 2) aktivitetet që ngrisin vetëdijen në sektorin gjegjës mbi dispozitat e Rezolutës 1325 dhe instrumenteve relevante për të drejtat njerëzore të grave. *Tregues:* Ministritë dhe institucionet ngrisin nivelin e fondeve për implementimin e 1) një apo më shumë dispozitave të Rezolutës 1325 dhe/ose instrumenteve mbi të drejtat njerëzore të grave, dhe 2) së paku një aktiviteti që ngrit vetëdijen brenda sektorit mbi dispozitat e Rezolutës 1325 dhe instrumenteve relevante mbi të drejtat njerëzore të grave.	ABGJ në koordinim me Qeverinë, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	OJQ të grave			

2. Përmirësimi në sferën e barazisë gjinore, për të reflektuar standardet ndërkombëtare dhe situatën aktuale në Kosovë.	2.1 Analizimi, propozimi i rekomandimeve dhe avokimi për ndryshime ndaj legjislacionit ekzistues mbi barazinë gjinore, ashtu që ai edhe më tepër të pasqyrojë standardet e BE, CEDAW dhe standardet tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi barazinë gjinore. *Tregues:* Legjislacioni mbi barazinë gjinore pasqyron më tej standardet e BE, CEDAW dhe standardet tjera të të drejtave të njeriut mbi barazinë gjinore.	Udhëheq ABGJ, Komisioni përkatës i Kuvendit të Kosovës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore	Specialistë të drejtësisë që janë të trajnuar në hartim legjislativ nga perspektiva gjinore, OJQ-të e grave ndihmojnë me avokim			
	2.2 Analizimi, propozimi i rekomandimeve dhe avokimi për ndryshime ndaj legjislacionit ekzistues mbi barazinë gjinore, ashtu që ai edhe më tepër të pasqyrojë situatën aktuale në Kosovë. *Tregues:* Legjislacioni mbi barazinë gjinore edhe *më tej i adoptohet* gjendjes aktuale në Kosovë.	Udhëheqin ABGJ dhe Zyra për Përkrahje Ligjore, Komisioni Kuvendar për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, pikat e kontaktit për çështje gjinore nëpër ministri	Specialistë të drejtësisë që janë të trajnuar në hartim legjislativ nga perspektiva gjinore dhe OJQ-të e grave			
3. Kapaciteti i shoqërisë civile për dhe mekanizmave aktualë gjinorë për të monitoruar implementim	3.1 Monitorimi i qeverisë, ABGJ, institucioneve kosovare dhe ndërkombëtare sa i përket implementimit të Rezolutës 1325, dhe hartimi i raportit vjetor përkatës. *Tregues*: Hartimi i raportit vjetor mbi implementimin e Rezolutës 1325.	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Shoqëria Civile, ABGJ	Aktivistet, UNIFEM, OSBE, dhe organizata tjera lokale e ndërkombëtare			
	3.2 Trajnim për institucionet qeveritare lidhur me monitorimin e implementimit të të drejtave njerëzore të grave dhe	OJQ-të e grave, IKAP, ABGJ	Aktivistet, UNIFEM, OSBE, dhe			

in e mekanizmave dhe ligjeve të barazisë gjinore shënon *ngritje*.	mekanizmave e ligjeve mbi të barazinë gjinore. *Tregues:* Aftësia e Kryeministrit dhe Kabinetit Qeveritar që të punojnë drejt monitorimit të implementimit të të drejtave njerëzore të grave dhe mekanizmave e ligjeve të të drejtave të njeriut shënon rritje.		organizata tjera lokale e ndërkombëtare			
	3.3 Përcaktimi dhe shfrytëzimi i treguesve përmes të cilëve shoqëria civile do të monitorojë implementimin e Rezolutës 1325. 3.4 Trajnimi i përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe ZKGJ mbi monitorimin e implementimit të Rezolutës 1325 në nivel komunal 3.5 Përpilimi i raportit dyvjetor mbi Rezolutën 1325, duke u bazuar në rezultatet e monitorimit 3.6 Fushatë avokimi e shoqërisë civile, bazuar në rezultatet e raportit. *Tregues*: Shoqëria civile është në gjendje të monitorojë implementimin e Rezolutës 1325, dhe kjo dëshmohet në raportet e monitorimit.	UNIFEM				UNIFEM
	3.7 Krijimi i grupit për monitorimin dhe sigurimin e implementimit të CEDAW, Platformës së Pekinit, MDG-ve, Rezolutës 1325 dhe dokumentit të partneritetit evropian. *Tregues*: Të gjitha agjencitë ndërkombëtare, përfshirë misionin e ri të BE-së, rrisin nivelin e implementimit duke siguruar që aktivitetet e tyre janë në pajtim me, dhe fuqizojnë edhe më tej, implementimin e CEDAW, Platformës së	Grupi Ad-Hoc	UNIFEM, OJQ të grave			UNDP, UNKT, UNFPA,

	Pekinit, MDG-ve, Rezolutës 1325 dhe dokumentin e partneritetit evropian.					
4. Perspektiva gjinore shënon *ngritje* në raportet e sigurisë dhe raportet mbi të drejtat e njeriut në IPVQ.	4.1 Takime koordinuese mes institucioneve relevante (Komisionit Parlamentar për Siguri, Ministrisë së Punëve të Brendshme, ZQM-së, Zyrës së Kryeministrit, Sekretariatit për Siguri) dhe eksperteve. *Tregues*: Raportet e institucioneve relevante mbi sigurinë përmbajnë perspektiva gjinore, si dhe përcaktojnë të arriturat apo pengesat në implementimin e të drejtave njerëzore të grave.	ABGJ,	Organizata të grave, ekspertë, organizata ndërkombëtare (UNDP, UNIFEM)			UNIFEM UNDP, OSBE

Rezultati II. Rritja e nivelit të angazhimit publik dhe politik të grave.

Outputi	**Aktiviteti**	**Përgjegjës**	**Ndihmuar nga**	**Data e fillimit**	**Data e përfundimit**	**Resurset**
1. Monitorimi i punës së deputeteve femra në nivelin komunal dhe kombëtar dhe angazhimi i deputeteve me qytetarët dhe OJQ-të *është rritur*.	1.1 Prodhimi i raportit të monitorimit për të informuar qytetarët dhe deputetët mbi mënyrën që deputetët i kanë përmbushur nevojat e qytetarëve dhe OJQ-ve. *Tregues:* Ekziston njohuri më e madhe mbi atë se si deputetët kanë përmbushur apo kanë dështuar të përmbushin prioritetet e qytetarëve.	RrGGK Grupi punues	OJQ-të anëtare të RrGGK-së			Zyra Britanike UNDP, UNIFEM?, NDI

2	Përfshirja e qytetareve femra në politikë dhe vendimmarrje *është rritur*.	2.1 Takime të rregullta tremujore në mes të deputeteve femra, Grupit Joformal të Grave dhe OJQ-ve të grave *Tregues:* Deputetet e grave përdorin inpute nga takimet me OJQ-të për të hartuar dhe përmirësuar legjislacionin që ka të bëj me çështjet e grave.	Deputetet femra, Grupi joformal i grave, RrGGK	OJQ-të e grave			UNIFEM
		2.2 Takimet e rregullta, tryeza të rrumbullakëta dhe konsultime mbi çështjet që prekin gratë, ndërmjet (Komisionit parlamentar për siguri, Ministrisë së brendshme, Forca e veprimit për gjini, ZQM, Zyra e Kryeministrit, Sekretariati për siguri) dhe OJQ-të e femrave të përfshira në aktivitete të ndërtimit të paqes *Tregues*: bashkëpunimi i institucioneve relevante dhe përkrahja e OJQ-ve të femrave të përfshira në aktivitetet e ndërtimit të paqes është rritur.	(ABGJ)	OJQ-të e grave			UNDP

3	Angazhimi i politikanëve femra në politikë, vendimmarrja politike dhe hartimi i politikave *është rritur*	3.1 Fushatë e avokimit që përfshin deputete femra dhe OJQ-e femrave / aktiviste për *së paku një* ndryshim brenda partive politike mbi çështjet me interes të përbashkët (p.sh. përzgjedhja transparente e kandidatit; alokimi i barabartë i resurseve në mes të kandidatëve; përfaqësimi i femrave në të gjitha strukturat e partisë). *Tregues:* Avokimi i suksesshëm për *së paku një* ndryshim brenda partive politike në çështjet me interes të përbashkët	Grupi joformal i grave dhe organizatat për të drejta të femrave	Organizatat ndërkombëtare si UNIFEM, NDI			
		3.2 Fushatat e avokimit bazuar në zbulimet e raportit vjetor të monitorimit (1.1). *Tregues:* Deputetet femra me sukses "kanë nxitur angazhimin" në *së paku një çështje* të identifikuar nga qytetarët si prioritet.	RrGGK	anëtarë të RrGGK-së, grupe të qytetarëve			
		3.3 Seminar edukativ për deputetet femra mbi shtytjen për politika/lobim brenda qeverisë *Tregues*: Aftësitë e deputeteve për lobim për politika brenda qeverisë janë rritur, siç është dëshmuar me lobim efektiv për politika.		Ekspertë			

Rezultati III. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në popullatën pakicë, në të njëjtën kohë duke përmirësuar qasjen e tyre në mallrat dhe shërbimet themelore dhe zvogëluar varfërinë.

Outputi	Aktiviteti	Përgjegjës	Ndihmuar nga	Data e fillimit	Data e fundit	Resurset
1. Kapacitetet e qeverive komunale dhe kombëtare për të përmirësuar shërbimet për popullatën rurale dhe minoritare, posaçërisht për femrat, *është rritur*.	1.1 Organizimi i takimeve në mes të deputeteve dhe zyrtarëve të ZKGj për të siguruar se ata janë duke funksionuar në të gjitha komunat në Kosovë, në veçanti aty ku ato tani nuk ekzistojnë, në pajtim me ligjin. *Tregues:* ZKGj të ekzistojnë në të gjitha komunat dhe funksionimi i tyre është përmirësuar.	ABGJ, Grupi Joformal i Grave dhe RrGGK.	Zyrtarë komunalë gjinorë (ZKGj), deputete femra, deputete komunale			
	1.2 Takime të deputeteve, ZKGj-ve dhe deputetë komunalë me femra në zona rurale, përfshirë të gjitha pakicat, ku politikanët mësojnë mbi nevojat e tyre dhe diskutojnë zgjidhjet e mundshme (organizuar nga OJQ të grave) *Tregues:* Autoritetet më të vetëdijshme për nevojat kyçe dhe zgjidhjet e problemeve me të cilat përballen femrat në zonat rurale, pas vizitave.	RrGGK dhe OJQ-të anëtare në nivelin lokal				
	1.3 Takime dhe fushata të avokimit që shënjestrojnë qeverinë kombëtare për avokim për ndryshime të politikave që pozitivisht prekin popullatat rurale dhe pakicë *Tregues:* Së paku një politikë e ndryshuar për përfitim të popullatës rurale dhe/apo pakicë.	RrGGK dhe OJQ-të e grave	Presion nga agjencitë ndërkombëtare në evokim (UNICEF, UNIFEM, UNFPA, UNDP, UNHCR)			

	1.4 Monitorim i vazhdueshëm i hartimit të politikave me implikime sociale, ekonomike dhe politike në nivel komunal dhe kombëtar për të siguruar se politikat konsiderojnë nevojat e posaçme të femrave në vende rurale dhe në hartimin e politikave, si dhe personat me nevoja të veçanta. *Tregues*: Autoritetet komunale dhe kombëtare të vetëdijshme për nevojat e caktuara të femrave nga vendet rurale dhe të popullatës pakicë gjatë hartimit të politikave, dhe politikat pasqyrojnë këtë.	ZKGj, ABGJ,				
	1.5 Takime avokimi me kryetarë të komunave për t'i edukuar ata mbi përgjegjësitë ligjore të ZKGj-ve. Bazuar në ligjin *Tregues*: Kapaciteti i ZKGj-ve është rritur, siç dëshmohet nga aftësia e tyre për të kryer hulumtime. 1.6 Hulumtim duke përdorur aftësi trajnimi për studimin e arsyeve të braktisjes shkollore të vajzave. *Tregues:* Raporti me gjetjet dhe rekomandimet ekziston.	Asociacioni i Komunave, grupi *Ad-Hoc* ABGJ	Trajnues të kualifikuar mbi metodat e hulumtimit, intervistave të ndjeshme, përpilimit të anketave			
	1.7 Fushatë avokimi bazuar në zbulimet e hulumtimit që kanë për cak qeveritë komunale dhe/apo kombëtare për avokim për rekomandimet që do të zbatohen (p.sh. rekomandime nëse duhet të ndërtohen 80 shkolla të reja). *Tregues:* Së paku 2 rekomandime nga raporti janë zbatuar.	ZKGj-të dhe OJQ-të lokale	RrGGK			

	1.8 Trajnimet për vetëdijesim gjinor që ndërton kapacitetin dhe mekanizmat e qeverive lokale dhe qendrore për t'iu përgjigjur nevojave të femrave, përfshirë nevojën e tyre për një mjedis të sigurt, janë zhvilluar dhe ofruar. *Tregues:* kapaciteti i qeverisë lokale dhe qendrore për t'iu përgjigjur nevojave të femrave, përfshirë nevojën e tyre për një mjedis të sigurt, është rritur.	ABGJ				UNDP

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

305-055.2(496.51)(047)

Raporti mbi monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë / [Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës]. - Botimi 2. - Prishtinë : Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2009. - 120 f. ; 30 cm.

ISBN 978-9951-8757-5-2

Raport për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Kanë kaluar nëntë vite që kur Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka adaptuar Rezolutën 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Rezoluta i jep rëndësi përfshirjes të perspektivës gjinore në ndërtimin e paqes dhe veprimet paqeruajtëse. Në Rezolutën 1325 të Kombeve të Bashkuara Sekretari Gjeneral është i obliguar t'u sigurojë trajnime, doracakë dhe materiale për mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave të grave në instancë paqeruajtëse dhe paqendërtuese. Duhet të sigurohet që personeli ushtarak dhe civil i cili do të zbarkojë, të kryejë trajnim të ofruar nga anëtarët e shtetit.

Pavarësisht nga ekzistenca e rëndësishme e kësaj rezolute, gratë përreth globit vazhdojnë të luftojnë për të drejtat e tyre, për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje përgjatë dhe pas proceseve të konfliktit, po ashtu edhe në procesin paqeruajtës. Gratë në Kosovë nuk kanë përjashtime. Derisa Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe forcat paqeruajtëse kanë ndërmarrë hapa simbolik për zbatimin e Rezolutës, ky raport e argumenton që në shumicën e rasteve ata kanë dështuar në zbatimin e kësaj Rezolute.

Anëtarët e shoqërisë civile në Kosovë, kanë shfrytëzuar mundësitë të cilat i ofron Rezoluta 1325, ku avokimi është përdorur si një mjet inkurajimi, lobimi, promovimi i pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet e jetës publike. Organizatat e grave kosovare kanë kontribuar në zbatimin e Rezolutës 1325.

Si pjesë e përpjekjeve për zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës me përkrahjen e UNDEF-it dhe UNIFEM-it, kanë realizuar këtë raport për monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 të KSKB-së në Kosovë, me qëllim që avokimi për çështje gjinore të arrijë në nivel kombëtar.

Ky raport analizon të dhënat kryesore të seksioneve kyçe të Rezolutës 1325 që obligon: 1) Pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje; 2) Perspektivën Gjinore, trajnimi i personelit ushtarak dhe policor; 3) Mbrojtjen dhe Respektimin e të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave; dhe 4) Kyçjen e perspektivës gjinore në raportimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
+381 (0) 38 245 850
info@womensnetwork.org
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8
Prishtinë, Kosovë
www.womensnetwork.org

ISBN 978-9951-8757-5-2